

Viti XXI - Nr.221 • Tetor 2009 • Shawwal/Dhul-Qi'dah 1430 h • Çmimi 50 den

# ere HËNA

Revistë kulturore informative islame

[www.bim.org.mk](http://www.bim.org.mk)  
[www.henaere.bim.org.mk](http://www.henaere.bim.org.mk)




**Haxhhi  
dhe Umre**

Faqe 19



**Mos dëmtoni  
imazhin e Islamit me  
ekstremizëm**

Faqe 32



**Kurbani-Sakrifica**

Faqe 48

# HAXHI, rizgjim i klasës intelektuale

Abaz Islami

Shikuar në bazë të prizmit Islam, haxhi është një nga parimet fundamentale të besimit Islam, duke përisatur mbi këtë obligim madhorë në aspektin sociologjik dhe fetarë ndër të tjera na kujton se roli i saj nuk është vetëm një kusht prej kushteve të fesë por edhe shumë më tepër se ajo! Fillimisht duhet pranuar se për nga karakteri i realizimit është obligim detyrues që besimtari të kryej nëse ka kushte sëpaku një herë në jetë. Dallim esencial në mes haxhit dhe obligimeve tjera fundamentale për nga natyra e obligueshmërisë është në atë se kërkohet nga besimtari që të kryhen brenda ditës, javës apo muajit, haxhi është obligim për besimtarët që kanë mundësi të kryejnë një herë në jetë. Parim që luan rol të pakompenzuar në edukimin shpirtëror dhe trupor të individit, i pakundërthent në aspektin e obligueshmërisë së tyre për çështjen individuale dhe shoqërore.

Të gjitha obligimet fetare islame përveç që kanë domethënie apo karakter të adhurimit, në vete ngërthejnë filozofi të gjërë dhe specifike. Edhe pse haxhi ka madhështi të shumtë, mbi të gjitha madhështia e saj është në aspektin e riorganizimit të shoqërisë myslimane, edukimin e tyre shpirtëror, rizgjimim e klasës intelektuale, nxheshjen e rradhëve, këmbimin e ideve, mendimeve dhe opinioneve, reformimin e gjeneratave të ardhshme, etj. Islami, në esencë është fe që thërret gjithnjë në konsolidim, rizgjim, rikooperim ndërshoqëror dhe ndërfitar të popujve.

## RIORGANIZIM I SHOQËRISË MYSLIMANE

Jashtëzakonshmëria e Haxhit dhe vlera e realizimit të këtij obligimi që njëherit është bërë obligim për kryerje në vitin e nëntë sipas kalendarit Hixhrij, All-llahu i lartë-

madhëruar për të qartësuar edhe më shumë domethënien e këtij postulati shpall një Kaptinë (sure) të veçantë në Kur'an duke e emërtuar me emrin Kaptina e Haxhit (Suret ul Haxh). Realizimi i saj bëhet një herë në jetë, në kohë të caktuar dhe në vende të caktuara që nuk i ngjanë obligimeve tjera fetare. E kemi të qartë se madhështia e Haxhit vërehet edhe në atë se pikërisht në këtë vend të shenjtë nga gjithë globi tubohen besimtarë të konfesionit Islam. All-llahu Fuqplotë në librin e shenjtë Kur'anin Famëllartë thotë:

**“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.”** (Suret ul Haxh: 27)

Shumë nga shkenctarët mysliman u ndalën në studimin dhe hulumtimin më të thellë të këtij ajeti kur'anor nga i cili burojnë mesazhe dhe urtësi. Nga kjo fjalë Hyjnore mësojmë për një element shumë me rëndësi dhe me peshë! Një pyetje që shumë individ e parashtrajnë: si mund të renditet apo të organizohet i gjithë njerëzimi që arrijnë nga gjithë skajet e botës dhe nga destinacione të shumtë, kur dihet se thirrësi prej shtëpisë së shenjtë mund t'i thërrasë vetëm kryesit e këtij postulati që gjenden brenda aty.

Madhështia e haxhit mund të haste edhe në atë drejtim kur është në pyetje kryerja e saj, ngase që nga periudha e Muhammedit a.s e deri më tani edhe pse është bërë evoliumi i shoqërive, përsëri kryerja e saj bëhet në të njëjtin vend, me të njëjtat norma dhe dispozita.

Element i tjetër që bënë të impresionojë haxhi është edhe urtësia e të ftuarit për kryerjen e këtij obligimi, ku shumë thirrës të Islamit arrijnë t'i bindin ithtarët e fesë islame t'i përgjigjen asaj thirrje që doli nga shtëpia e shenjtë, thirrje të cilën mund ta kuptojmë nga këto ajete kuranore kur Allahu xh.sh. e urdhëroi Ibrahimin a.s. që të thirrë njerëz për në haxh:

**“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin...”** Ai (Ibrahimi a.s.) i tha: **“O Zot! E çfarë vlefte mund të ketë zëri im që ta njohtoj hapësirën?”** Allahu xh.sh. iu përgjigj: **“Për ty është që të thërrasish e ta paraqesësh thirrjen, kush të dëgjojë le të dëgjojë...”**

Haxhi u mundëson të gjithë besimtarëve mysliman të botës tubimin në një vend dhe në një kohë për t'u njohur mes vete, për të këmbyer ide, njohuri shkencore, për të krijuar marrëdhënie të reja të bashkëpunimit, të njihen me gjendjen sociale mes vete dhe për të fuqizuar kooperimin ndërvël-lazëror.

Segment tjetër është se arrinë të bënë afrimin dhe unitetin e muslimanëve, ngase një numër i madhë i tyre jetojnë dhe zhvillojnë fenë në shoqëri multikulturore dhe multietnike.

## PËRMBYLLJA E FJALËS HYJNORE

Ky obligim qartazi na jep definicionin më të përkryer lidhur me fenomenet e ndryshme aktuale, mbi vlerat njerëzore, për kooperimin e civilizimeve dhe në të kundërtën mos respektimi i ndërsjellt mund të çon deri tek përplasje e qytetërimeve- një idenë që është shfaqur nga Hantigtoni. Momente ku ngritet vetëdija e shoqërisë, me këtë rast të gjithë solidarizohen, ndërsa barabarësia është prezente në mesin e tyre dhe si dukuri ndikojnë pozitivisht. Meqë, njeriu është një krijesë që mund të bënë përzierjen e rrugës së drejtë dhe asaj që mund ta çon në humnerë, nga ajo që prezantohet gjatë kësaj periudhe ngritë vlerën e porosisë së Zotit që ka të bëjë me të ftuarit në rrugën e drejtë e të sigurt dhe se vetëm një rrugë e till eliminon të gjitha parregullsitë njerëzore.

Individi atë lloj të natyrës që shpesh ndjen lodhje shpirtërore dhe meqë ka nevojë për një

“

*“Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.”* (Suret ul Haxh: 27)

mbikëqyrës që do të kontrollojë atë dhe në një mënyrë do t'ia shëron plagët, Ai, All-llahu Fuqplotë bërë obligueshmërinë e haxhit si një nga elementet për rizgjim të klasës intelektuale të shoqërisë myslimane. Pikërisht nga ky vend duhet të dalin ide, hartuar projekte të reja për të ngritë dhe integruar shoqërinë Islame. Gjithashtu nga aty duhet të gjinden mënyra dhe rrugë të reja si të zgjidhet problemi i myslimanëve në të gjitha anët e botës gjithandej ku ata janë të shqetësuar. Çështja e popullit të Palestinës duhet të merr fund, ngase edhe ata duhet të jetojnë ashtu siç jetojnë popujt tjerë. Gjatë realizimit të Haxhit, mendimtarët dhe ideologët Islam të sjellin alternativ që të qetësohet gjendja kaotike e popullit Irakian. Nga ai vend duhet të përcjelljen mesazhe botës për të paralajmëruar se Ne myslimanët kemi po aq kapacitet që të rimëkëmbin dhe të rizgjojme gjeneratat e reja. Në saje të saj Allahu i Lartëmadhëruar në një ajet Kuranor thotë:

**“Ky (Kur'an) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatuar mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me të mendimtarët.”**(Suretu Sad: 29)

Meqë shoqëria islame po përjeton rramje dhe ngritje, ky mesazh i latëthënuar është edhe një arsye më shumë për të kuptuar se roli i intelektualëve të botës islame është tejet i madhë dhe determinon që të gjejnë fushëveprim dhe të veprojnë në instanca të pacaktuara shoqërore dhe shtetërore.

Prej këtij akti shumdimensional njerëzor mund të konstatojmë dhe të vlerësojmë se haxhi llogaritet pikënisje për një rizgjim mbarëshoqëror Islam!



# TË PËRGGATITUR PËR KRYERJEN E HAXHIT

Haxhi - kushti pestë i Fesë Islame, i cili kryhet në vendet e shenjta islame, është ibadet madhështor, të cilin Allahu xh.sh. e bëri obligim të domosdoshëm për çdo besimtar, edhe atë së paku një herë në jetë, natyrisht për ata që kanë mundësi. Allahu xh.sh. në Kur`an thotë: “Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është bërë obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo...”

Ashtu si ibadetet tjera, të cilat janë pjesë e shtyllave apo kushteve të Islamit, edhe Haxhi ka veçoritë dhe karakteristikat e tij, siç janë: realizimi i tij një herë në vit, në të njëjtin vend dhe kohë për të gjithë myslimanët e botës. Pra, Haxhi është ibadet apo lutje, i cili ua mundëson të gjithë myslimanëve të botës tubimin në një vend dhe në një kohë për t’iu nënshtruar bashkërisht Krijuesit të tyre, pavarësisht se nga cili vend kanë ardhur, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike apo racore etj. Njëkohësisht, ky tubim shfrytëzohet edhe për afrimin dhe njohjen e besimtarëve anekënd rruzullit tokësor. Kjo pra është madhështia e këtij ibadeti.

Marrë parasysh udhëtimin për në vendet e shenjta, dhe gjithçka që është e lidhur me udhëtimin dhe me vendosjen e haxhive, ky ibadet, për dallim nga ibadetet tjera, kërkon një qasje më të madhe përgatitore. Prandaj, lidhur me këtë angazhohen shumë subjekte kompetente, si ato që kanë cilësinë e nikoqirit, po ashtu edhe ata që janë bartës të organizimeve për kryerjen e këtij obligimi.

Bashkësia Fetare Islame e RM-së, si institucion i vetëm përgjegjës dhe kompetent për të organizuar jetën fetaro-islame, pra edhe të Haxhit, edhe sivjet i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që besimtarët e interesuar të vendit tonë, në mënyrë sa më të mirë ta realizojnë Haxhin, në kushtet e atjeshme klimatike si dhe në kushtet e këtij tubimi, në të cilin prezantojnë me miliona njerëz.

Në fund, të gjithë haxhilerëve ju urojmë haxh të pranuar dhe falje të mëkateve, duke ua kujtuar një thënie të Muhamedit a.s. lidhur me haxhin: “Kush e kryen haxhin dhe nuk u nënshtrohet më epsheve të shfrenuara, atij i fshihen mëkatet dhe bëhet i pastër si në atë ditë kur e lindë nëna e tij”.

REVISTË MUJORE  
INFORMATIVE  
KULTURORE ISLAME



Botues:  
Rijaseti i BFI në RM



*Redaksia:*  
Abaz Islami  
Abaz Jahja  
Skender Buzaku  
Ibrahim Idrizi  
Qufli Osmani  
Shaban Sulejmani  
Ismet Osmani  
Driton Dikena  
Agron Vojnika



*Bashkëpunëtor:*  
Agim Mehmeti  
Valbona Zunçe  
Rejhan Neziri



Redaktori teknik:  
Halil Berisha



Telefonat e redaksisë:  
02 3117 410; 02 3117 412



www.bim.org.mk  
e-mail: bim@bim.org.mk  
www.henaere.bim.org.mk  
e-mail: hena@bim.org.mk



Dorëshkrimet dhe fotografitë  
nuk kthehen



8

BFI FILLOI TË  
NDAN  
CERTIFIKATËN  
HALLALL

QABEJA,  
SHTËPIA E  
SHENJTË-  
VËSHTRIM HIS-  
TORIK



25



INDIFERENTIZMI  
INTELEKTUAL  
RREZIK I MADHË  
SHOQËROR

30



## TË SHKRUASH HISTORINË ME AVERSION

33

## MUNGESA E VULLNETIT POLITIK, PENGESË PËR DENACIONALIZIM



43



## DEPRESIONI DHE FEJA

37

Uka Komerc –  
prodhuesit e produkteve të  
mishit Hallall ... 6

BFI investon në arsimimin e  
femrës muslimane ... 10

Qendër Islame në Rijekë të  
Kroacisë ... 12

Gurthemel xhamie në  
Dollogozhdë të Strugës ... 13

Gurthemel xhamie në Norovë  
të Prilepit ... 14

Zv.Ministri për Çështje Fetare  
të Arabisë Saudite për vizitë në  
BFI ... 14

KOHË PA EMËR ... 14

Vetëkënaqësia Akademike dhe  
“Enciklopedia Shqiptare” ... 15

Raporti i Brukselit për të  
drejtat dhe liritë fetare në  
Maqedoni ... 18

Haxhxi dhe Umre ... 19

H A X H I ... 28

Mos dëmtoni imazhin e Islamit  
me ekstremizëm ... 32

KUR’ANI- SHKRIMI,  
GJUHA DHE PËRKTHIMET  
E PARA ... 35

Tokën ua morën, tani ua nxjer-  
rin organet... ... 39

E PO, KU SHKOJMË?!... ... 40

Format e muzikës fetare (1) ...  
42

PROMINENCA AKLIMA-  
TIZUESE E SISTEMIT ISLAM  
DHE MODELET POLITIKE  
TË AKROPOLIT  
EUROPERENDIMORË (6) ...  
44

Triniteti dhe  
vërtetësia e tij (3) ... 46

Kurbani-Sakrifica . 48

# Uka Komerc – prodhuesit e produkteve të mishit Hallall

Nga Agron VOJNIKA

Duke u nisur nga fakti se prej tani e në të ardhmen, Bashkësia Fetare Islame e RM-së do të jetë Autoriteti i vetëm i cili do të bëjë ndarjen e Certifikatave për Kualitet Hallall, e me çrast për këtë qëllim ka angazhuar një Agjenci të specializuar për të kryer inspektimin profesional në këtë lëmi, nuk mund të mos përmendim fabrikën e profesionalizuar për përpunimin e mishit dhe prodhimin e produkteve të mishit Uka Komerc, e cila njëherit është e para që ka aplikuar dhe përmbush kushtet për këtë Certifikatë.

Që nga hapja e kësaj kompanie në vitin 1991, shumë gjenerata të reja janë rritur me produktet e kësaj fabrike dhe tani, së fundi është shndërruar në një brend të kërkuar dhe para së gjithash, të sigurtë për konsumatorët. Produktet e kësaj kompanie, të cilat kanë një asortiment të gjerë, si suxhuku, salçiqet, sallamet e ndryshme, apo mishrat e thatë, prodhohen sipas standardeve më bashkëkohore dhe më të sigurta. Vetë fakti se kjo fabrikë ishte e para që në Maqedoni e aplikoi HACCP standardin, flet qartë se vërtetë kemi të bëjmë me një kompani serioze, produktet e të cilës janë të sigurta dhe të garantuara.

Çfarë ushqimesh përdornim në të kaluarën.

Para se në vendin tonë të lejohej biznesi privat, shumë prodhime që shiteshin në treg, ishin të pakontrolluara dhe në të shumtën e rasteve nuk dihej përbërja e produktit. Për shembull në ligjin e vjetër të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, thuhej, se nëse një produkt përbëhet prej mbi 60 përqind të një lloji mishi, atëherë ai do produkt do të emërohet sipas përbërësit kryesor. Për shembull, nëse një sallam kishte mbi 60 përqind mish viçi atëherë quhej sallam viçi. Por, për ato 40 përqind të tjera që mbeteshin, askush nuk tregonte saktë se çfarë përmbajnë.

Sidoqoftë, ashtu siç ishte sistemi komunist, që nuk kishte respekt për religionin, e në veçanti për fenë Islame, ashtu sillleshin edhe prodhuesit e asaj kohe, duke mos treguar ndonjë lloj respekt të veçantë për konsumatorët muslimanë. Shumëkush, duke mos pasur mundësi për zgjedhje, zgjidhnin që të abstenonin nga ushqimet e tilla.

Me ardhjen e demokracisë, u krijua edhe mundësia për të zgjedhur. Njerëzit filluan ti qasen biznesit privat. Kështu ishte edhe rasti me vëllezërit e familjes Abazi nga Saraji, të cilët themeluan kompaninë e prodhimit të mishit Uka Komerc.

## KUSH ËSHTË “UKA KOMERC”

Pasi në Maqedoni filloi biznesi privat, katër vëllezërit H. Ademi, H. Qemali, H. Jusufi dhe H. Musa, tërë pasurinë e tyre e orientuan për të filluar me biznesin privat. Fillimisht hapën një shitore ushqimore, e para e atij lloji në komunën e Sarajit.

“Ishte ëndërr për ne që të hapim një shitore e cila do të shesë produktet më themelore, siç janë: vaji, sheqeri, mielli e të tjera”, thotë H. Musa, duke shtuar më tej se: “Në vitin 1987 e hapëm shitoren ushqimore, e më pas në vitin 1989 hapëm një restorant me kuzhinë popullore. Në atë restorant përdornim shumë mish. E që në atë moment filloi edhe ideja për të punuar me mish. Për ti plotësuar nevojat e kuzhinës, hapëm një mishtore, e cila edhe bënte shitjen e mishit, por edhe furnizonte restorantin. Kështu që shumë shpejt u krijua një zinxhir shitoresh. Më pas ngritëm një fermë në të cilën kultivonim kafshë të shëndosha për therje. Më pas, duke parë se kërkesat gjithnjë po bëheshin më të mëdhaja, hapëm edhe tre mishtore të tjera në: Nerez, lagjen Xhon Kenedi dhe në lagjen Gjorçe Petrov. Por duke parë se nga të gjitha këto mishtoret mbeteshin shumë mbetje si copa mishi, fillimisht filluam me to të prodhojmë suxhuk. Në fillim

hapëm një punëtori jo më të madhe se 40 metra katrorë, në të cilën prodhohim suxhuk kualitativ të shtëpisë. Kjo ndodhi diku në vitet 1991-92”, thotë h. Musa. Kjo punëtori e cila furnizonte mishtoret me suxhuk, së shpejti do të bëhej shumë e vogël, për nevojat e popullatës në Maqedoni. Tani konsumatori vetëm se kishte një alternativë që të zgjedh prodhimet që do ti konsumojë.

Pas një kohe të shkurtër, kur filloi të rritej edhe interesi për prodhimet e vëllezërve Abazi, ata u mbledhën që të katërt sëbashku dhe diskutuan se a to merreshin në të ardhmen me biznesin e mishit apo do të vazhdonin me diç tjetër.

Pas kësaj bisede, ata vendosën që një hapësirë që e kishin në shtëpi, rreth 400 metra katrorë ta përdornin si punëtori për biznesin në të cilin kishin filluar të investojnë. Ata e regjistruan firmën e tyre Uka Komerc. “Uka është emri i të parit të fisit tonë, dhe për këtë arsye vendosëm që firmën tonë ta emërtojmë ashtu” thotë H. Ademi.

Në vitin 1996, morën edhe një hap më të madh, me ç’rast të gjitha resurset, i fokusuan në drejtim të ndërtimit të një objekti madhështor, në të cilin do të prodhoheshin produkte sipas standardeve evropiane, e njëkohësisht të garantuara për konsumatorët muslimanë. Po atë vit filloi ndërtimi i godinës aktuale në të cilën sot prodhohen shumë nga produktet e kësaj kompanie me makineritë ndër më modernet në Evropë.

Në mesin e kodrave të Sarajit, në zonën më ekologjike të kësaj komune, nga rruga në hyrje të Shkupit që nga larg mund të vërehet një oazë e gjelbërt, prej 4000 metra katrorë, me park të regulluar e zbukuruar mirë në mesin e së cilës duket një ndërtesë gjigande, me fasadë të rregulluar sipas stilit perëndimor. Në hyrje të ndërtesës është shatërvani i madh i rrethuar me një kopsht me lule dhe disa tavolina të rregulluara me shije, të cilat shërbejnë si pushimore për punëtorët, apo për mysafirët. Në çdo dhjetë metra të

ndërtesës, shihen kurthet speciale kundër minjve dhe mizave, të vendosur nga një firmë e specializuar që bën pastrimin, deratizimin dhe dezinfektim non-stop të objektit. Për këtë arsye, në një vend ku në rend të parë është pastërtia, nuk është për të çuditur fakti se që nga formimi i kësaj kompanie nuk është regjistruar asnjë rast i helmimit me ushqim. Si rezultat i kësaj pune solide dhe të organizuar mirë, kompania Uka Komerc, ka reparte në Saraj të Shkupit, në Kosovë – Elez Han dhe në Austri – Vjenë.

## ÇKA DUHET TË DIHET PËR USHQIMIN

“Është shumë me rëndësi kush e prodhon produktin” thotë H. Ademi, duke shtuar më tej: “Nëse dikush që e prodhon mishin, i frikohet Allahut, atëherë ai do të ketë shumë kujdes se çfarë produkti ofron në treg. Vetë fakti se në familjen tonë mbretëron një përkushtim i madh ndaj Allahut Fuqiplotë, jemi të detyruar që çdo prodhim tonin ta kontrollojmë dhe të kemi një kujdes të madh gjatë përdorimit të melmesave dhe emulgatorëve të ndryshëm. Nuk lamë aspak vend për dyshime. Për këtë arsye kemi angazhuar një ekip teknologësh të cilët e verifikojnë dhe inspektojnë çdo material që futet në fabrikë”.

Aktualisht në ambientet e kësaj fabrike një zyrë është gjithmonë e rezervuar për inspektorin i cili në çdo moment, 24 orë të ditës, shtatë ditë në javë, ka mundësi të bëjë kontrollin e prodhimeve.

Në kohën kur kjo fabrikë filloi me prodhimin profesional të sallameve, angazhoi teknologë të shumtë të industrisë së ushqimit nga të gjitha anët e Evropës.

“Kemi vizituar shumë seminare, apo sajame të ndryshme të industrisë së ushqimit, me qëllim që të njoftohemi me të rejat e kësaj lëmie dhe me makineritë më moderne që përdoren sot në Evropë. Si rezultat i kësaj, kemi marrë edhe makineritë më bashkëkohore me të cilat bëjmë



*“Është shumë me rëndësi kush e prodhon produktin” thotë H. Ademi, duke shtuar më tej: “Nëse dikush që e prodhon mishin, i frikohet Allahut, atëherë ai do të ketë shumë kujdes se çfarë produkti ofron në treg. Vetë fakti se në familjen tonë mbretëron një përkushtim i madh ndaj Allahut Fuqiptotë, jemi të detyruar që çdo prodhim tonin ta kontrollojmë dhe të kemi një kujdes të madh gjatë përdorimit të melmesave dhe emulatorëve të ndryshëm*

prodhimin e produkteve tona”, thotë H. Musa. “Gjithashtu kemi angazhuar shumë teknologë evropiane të cilët na këshilluan që të arrinim standardet evropiane të prodhimit. Në vitin 2004-2005 ishim të parët në Maqedoni që morëm certifikatën HACCP (hasap). Një vit të tërë angazhuam një teknolog nga Vjena e Austrisë, i cili disa vite me radhë merr medaljet e arta në sferën e prodhimeve të mishit. Ai prodhon ekskluzivisht për tregun në Dubai.

Këtë vit, reparti i Sarajit, ka aplikuar për tu regjistruar në BE nëpërmjet komisionit Evropian, dhe drejtuesit e këtij reparti kanë shpresë të madhe se së shpejti do të arrijnë qëllimin e tyre. Tregues më i mirë i cili i bën këta pronarë të besojnë në këtë gjë, është se testimet të cilat janë bërë gjatë 10 vitet e fundit kanë dalë superlative dhe shpesh kompania e tyre është marrë si shembull për HACCP standardin në vend dhe në rajon.

Fabrika e Uka Komerc shpesh herë i ndihmon edhe studentët e fakultetit bujqësor dhe të

veterinarisë pranë Universitetit Kirili dhe Metodi si dhe studentët e Universitetit Shtetëror të Tetovës, të cilët vijnë dhe bëjnë praktikën, pikërisht në këtë fabrikë moderne. Gjithashtu për të dëshmuar transparencën e tyre, drejtuesit e fabrikës u kanë mundësuar shkollave nga mbarë vendi, që ti sjellin nxënësit e tyre ta vizitojnë fabrikën dhe të njoftohen me prodhimet e kësaj fabrike nga më afër.

#### Zhvillimi ekonomik i rajonit

H. Ademi ka plane që në të ardhmen ta zgjerojë biznesin, duke krijuar mundësi që në të të përfshihen edhe banorët e komunës së Sarajit. Puna e tij dhe vëllezërve të tij, bashkë me familjet e tyre, ka dhënë një kontribut të madh në kohën e krizës ekonomike në të cilën po kalon vendi jonë. Mbi 100 punëtorë të cilët janë të punësuar në këtë firmë, sigurojnë të ardhurat e tyre, pikërisht nga kjo industri, e cila shumë shpejt po shtrihet në

tregjet e Maqedonisë, Kosovës, Shqipërisë dhe rajonit.

E në shumë raste, kjo kompani tregohet edhe zemërgjerë, duke i ndihmuar skamnorët dhe njerëzit në nevojë. Por ajo që vlen të theksohet mbi të gjitha, është ndihma e tyre që i bëjnë Medreses Isa Beu, tek e cila për çdo vit kanë donuar ndihma në ushqime për nxënësit e kësaj Medreseje.

“E kemi për detyrë ta ndihmojmë Medresenë. Ajo është Medreseja e jonë. Pra e çdo muslimani. Prandaj çdo musliman që ka mundësi e ka për detyrë ta ndihmon këtë Medrese dhe djemtë e vajzat tona që mësojnë aty, sepse në fund të fundit po nuk e ndihmuam ne - muslimanët, nuk ka kush ta ndihmojë atë”, thotë Haxhi Ademi.

Gjatë bisedës me të punësuarit e Medresesë por edhe me nxënësit, ata i shprehin falënderim të madh Kompanisë e cila mendon gjithmonë për ta dhe i luten Zotit të Madhërisëm që ti shpërblen me gjitha të mirat nga thesari i Tij i pashtershëm.



# BFI filloi të ndan certifikatën Hallall

**Agron Vojnika**

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, më në fund do të mund të japë Hallall Certifikatë për produktet të cilat përdoren në tregun Brenda Maqedonisë si dhe për produktet të cilat prodhohen në Maqedoni dhe distribuohen në mbarë Botën.

Të martën më datë 26 tetor, BFI e Maqedonisë, e përfaqësuar nga Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi, gjegjësisht e angazhoi Agjencinë profesionale për dhënie e Certifikatave të kualitetit Hallall, nga Bosnja e Hercegovina. Në emër të Agjencisë për dhënie e Certifikatave Hallall Kualitet, marrëveshjen e nënshkroi Drejtori i agjencisë prof. Amir Sakiç.

Duke ecur me trendet botërore të industrisë së ushqimit, por edhe industrive të tjera ku certifikata Hallall mund të aplikohet, Bashkësia Fetare Islame ka vendosur themelet e vënies së një standardi të ri për mbrojtjen e konsumatorit vendas, e posaçërisht konsumatorëve muslimanë në vend.

Gjatë një prezantimi që u bë për mediumet në ambientet e Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame, në këtë konferencë për shtyp, u tha se sipas statistikës botërore, në Botë ekzistojnë rreth 1 miliardë e 800 milionë muslimanë, por e veçantë është se mbi 3 miliardë konsumatorë përdorin produkte me certifikatën Hallall. Drejtori i sektorit për edukim, Valdet Peshtaliç, gjatë prezantimit të tij për mediumet dha një shembull interesant në këtë aspekt. “Në Britaninë e Madhe, ekzistojnë mbi 6 milion konsumatorë të ushqimeve të certifikuara me Hallall kualitet, ndërsa në atë shtet ka jo më tepër se 2 milion muslimanë”.

“Ushqimet të cilat posedojnë Certifikatën Hallall kualitet, janë të lejuara për përdorimin e popullatës muslimane. Dhënia e kësaj certifikate nënkupton procedurën, e cila e vërteton gjithë materialet e përdorura në prodhimin e produkteve, procesin e përpunimit dhe qasjen e firmës për prodhimin e ushqimeve me certifikatë halla, janë të garantuara sipas të gjitha standardeve të parashikuara

## ÇKA ËSHTË HALLALL CERTIFIKATA

Ushqimet të cilat posedojnë Certifikatën Hallall kualitet, janë të lejuara për përdorimin e popullatës muslimane. Dhënia e kësaj certifikate nënkupton procedurën, e cila e vërteton gjithë materialet e përdorura në prodhimin e produkteve, procesin e përpunimit dhe qasjen e firmës për prodhimin e ushqimeve me certifikatë halla, janë të garantuara sipas të gjitha standardeve të parashikuara.

Dhënie e certifikatave ndaj

një firme e bën Bashkësisë Fetare Islame e RM-së në bashkëpunim me Agjencinë për Dhënie e Certifikatave Hallall Kualitet. Përgatitja e firmës për certifikatën Hallall e kryejnë konsultantë – këshilltarë të autorizuar për dhënie e certifikatës në fjalë “për Maqedoni është e autorizuar Aleksandra Markovska nga FOOD Consulting nga Shkupi”. Firmat të cilat me sukses i kryejnë të gjitha kërkesat për prodhimin e produkteve hallall kanë të drejtën të aplikojnë dhe të marrin këtë Certifikatë, e cila në Maqedoni ndahet ekskluzivisht nga Bashkësia Fetare Islame dhe Agjencioni në fjalë.



Certifikata Hallall është një biletë e posaçme për hyrjen në tregun Botëror të produkteve Hallall, vlera e së cilës është mbi 850 miliardë dollarë amerikanë. Tregu botëror i produkteve hallall është një nga tregjet që rriten me një ritëm më të lartë në Botë, me një tendencë për ngritje në të hyrat prej 30 përqind e vazhdon edhe më tej.

Hallalli u kthye në një trend global ndërsa produktet hallall konsumohen si nga muslimanët ashtu edhe nga jo-muslimanët, sepse hallallin e konsiderojnë si një produkt i shëndoshë, i sigurt, si dhe produkt me shumë kontrolle shtesë.



## CILAT PRODUKTE MUND TË MARRIN CERTIFIKATËN HALLALL

Hallall certifikatën mund ta marrin prodhimet nga industria ushqimore, farmaceutike, kozmetike, produktet për higjienën personale, mjetet për përdorim të përditshëm siç janë garniturat, veshmbathja, këpucët, si dhe shërbimet siç janë dhënia e shërbimeve bankare, turistike, e shumë sfera të tjera.

Për shembull në industrinë ushqimore, këtë certifikatë mund ta marrin prodhimet siç janë pijet freskuese, ushqimet e drithërave, brumëra të ndryshme, përpunimi i frutave, industria e përpunimit të mishit, patatina të ndryshme (snack prodhime) e të tjera.

Në sferën e farmaceutikës bëjnë pjesë produkte të cilat përdoren si barëra të ndryshme si dhe mjete të tjera ndihmëse.

Për sa i përket prodhimeve të kozmetikës, këtu bëjnë pjesë kremra të ndryshe, të kuq për buzë, parfume të ndryshme, e tjerë. Ndërsa për sa u përket prodhimeve të përdorimit të përditshëm nënkuptohet përdorimi i garniturave të ndryshme të cilat përdorin lëkurën me prejardhje shtazore. Gjithashtu këtu bëjnë pjesë edhe veshjet të cilat janë të bëra nga lëkura e kafshëve të lejuara.

## VËRTETIMI I PRODUKTEVE

Të dhënat për produktet vërtetohen nëpërmjet bisedës me prodhuesit, shqyrtimin e dokumentacionit dhe inspektimin e ambientit në të cilin prodhohet produkti i cili kërkon Certifikatën Hallall. Të gjitha hollësitë nga marrja e materialeve primare e deri në prodhimin final shqyrtohen hollësisht nga njerëz të specializuar të sferave të ndryshme, ndërsa investigimi i tyre bëhet vazhdimisht. Informatat që meren nga firmat gjatë bisedave, duhet të vërtetohen me gjendjen faktike të ambientit të prodhimit si dhe nga burime të tjera të pavarura, siç është inspektimi në vend i ambientit të prodhimit dhe inspektimi i të gjitha derivateve një nga një. Prodhimi final që do të mer këtë



Certifikatë nuk përmban në vete asnjë materie e cila është e ndaluar për përdorimin e muslimanëve. Gjatë procesit të prodhimit duhet në përpikshmëri të përmbahen të gjitha standardet për Hallall, me të cilën ndalohen të gjitha materiet që janë të ndaluara për muslimanët si dhe shumë e rëndësishme higjiena dhe kushtet në të cilin krhet përpunimi. Në industrinë e mishit, përveç të gjitha standardeve, kafshët apo shpezët që përdoren duhet të theren sipas rregullave

të sheriatit, pra atë detyrë ta kryen person mysliman dhe ta bëjë therjen në Eemër të Allahut të plotfuqishëm.

Pra me një fjalë me Hallall Standardin është e vërtetuar se çka është e lejuar dhe e ndaluar për përdorimin e muslimanëve. Si certifikohet dhe vërtetohet aplikimi i këtyre standardeve. Si bëhet therja e kafshëve dhe shpezëve. Cili është statusi i aditivëve që përdoren gjatë prodhimit të produktit i cili do të mer Hallall Certifikatën.



## CILAT FIRMA E PËRDORIN KËTË CERTIFIKATË

Të gjitha firmat prodhuese më me repute në botë dhe në rajon, janë posedues të kësaj certifikate. Ndër to do të përmendim disa: Nestle, McDonalds, KFC, Krash, Vindia, Argeta, Perutina Ptuj, Vispak dhe shumë të tjera që njihen mirë edhe nga konsumatorët e Maqedonisë.

Duke pasur parasysh potencialet natyrore dhe klimatike, si dhe zhvillimin solid të industrisë ushqimore në Maqedoni, ekzistojnë kushte të mira për prodhimin e produkteve hallall të cilat do të mund të plasohen në tregun vendas si dhe në tregun global. Kjo nënkupton edhe investimin shtesë, por edhe punësime të reja, të cilat njëherit janë edhe shumë të rëndësishme për ekonominë dhe zhvillimin e vendit. Kjo mund të vërtetohet njëherit shumë mirë sepse tregu botëror hallall nuk është prekur aspak nga recesioni i krizës financiare gjatë dy viteve të fundit.

HAPET GODINA E RE E PARALELES SË SHTRIRË PËR VAJZA E MEDRESES ISA BEU

# BFI investon në arsimimin e femrës muslimane

Të shtunën më datë 31 Tetor 2009, pas një punë pesë vjeçare të Paraleles së Shtrirë të vajzave të Medreses Isa Beu në Tetovë, u lëshua në përdorim godina e re, e cila gjeneratave të reja do tu mundëson kushte më të volitshme për ndjekjen e procesit edukativo-arsimor. Ashtu siç theksoi Kreu i Bashkësisë Fetare Islame të RM, H. Sulejman ef. Rexhepi, kjo ndërtesë në vitet në vijim do të shërbejë për arsimimin e nënave të ardhshme të Kombit.

Në praninë e mysafirëve të shumtë, si nga vendi, ashtu edhe nga jashtë dhe prezencën e shumtë të medimeve, nxënëset e kësaj Paraleleje kishin përgatitur një program të begatë. Të pranishëm ishin përfaqësues të Kishës Ortodokse Maqedonase, përfaqësues të Mbretërisë së Arabisë Saudite, përfaqësues të përfaqësive diplomatike në vend, të Komunës së Tetovës, muftij nga gjitha muftinitë e Bashkësisë Fetare Islame, hoxhallarë, prindër, nxënës, e dashamirë të shumtë të Islamit.

Fillimisht programi u hap me leximin e asheres, e më pas profesor Bahri Aliu mbajti një fjalim mbi ecurinë e punës së Medreses – Paraleles në Tetovë. Më pas fjalën e rastit e mori Drejtori i Medreses Isa Beu, profesor Ibrahim Idrizi, i cili foli për sfidat e kësaj medrese dhe për planet që ka kjo medrese në të ardhmen.

Muftiu i Muftinisë së Tetovës, pasi i përshëndeti të pranishmit, u falënderua tek të gjithë që kanë dhënë kontributin për hapjen e kësaj paraleleje. Ai nga zemra falënderoi Reis ul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi për gjithë përkrahje që e ka dhënë gjatë formimit të Medreses, si dhe investitorin z. Ozkan Goksal, i cili ekskluzivisht ka bërë të mundur që me mjete financiare të bëhet ndërtimi i godinës së re. Mufti Alifikri Esati, gjithashtu Falënderoi edhe ish-Kryetarin e Komunës së Tetovës, z. Hazbi Lika, për gjithë ndihmën që ia ka dhënë Muftinisë së Tetovës gjatë



kohës kur ai ishte kryetar, si dhe Kryetarin aktual të Komunës së Tetovës, z. Sadi Bexheti, për ndihmën dhe përkrahjen e tij ndaj këtij institucioni.

Më tej fjalën e rastit e mori investitori-donatori, z. Oskan Goksal, i me emocione të mëdha shpjegoi se si lindi ideja për ta ndihmuar ndërtimin e një shkolle të tillë. Ai gjithashtu shprehu kënaqësinë që ndodhej në mesin e një ambienti, ku ishin të pranishëm përfaqësues të gjitha gjeneratave. Z. Oskan gjithashtu Falënderoi Reis ul Ulemanë dhe Muftiun e Tetovës të cilët ia mundësuan atij që të kontribuon me një vepër të tillë, për krijim dhe pasurimin e Vakëfit në Rumeli – Maqedoni.

Më pas, fjalën e rastit e mori Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili të pranishmëve iu drejtua në tre gjuhë, shqip, maqedonisht dhe arabisht. Ai i përshëndeti mysafirët e pranishëm, nga gjitha viset e vendit, përfaqësuesit e KOM-it, dhe përfaqësuesit e Mbretërisë së Arabisë Saudite, të cilët në këtë manifestim erdhën si mysafirë të Reis ul Ulemasë. Kreu i BFI-së foli rreth rëndësisë së arsimimit të gjeneratave të reja dhe posaçërisht rëndësisë së arsimimit të femrës muslimane në vend.

Pas përfundimit të fjalimit (i cili vijon më poshtë), të pranishmit u drejtuan kah hyrja e godinës, me ç'rast Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi bashkë me donatorin z. Oskan Goksal prenë shiritin e hapjes së kësaj godine, me ç'rast e shpallën të hapur këtë objekt në të cilin do të arsimohen "Nënat e ardhshme të Kombit", ashtu siç theksoi H. Sulejmani, në fillim të fjalimit të tij.

Pasi mysafirët vizituan ambientet e godinës dhe njoftuan më nga afër me kushtet e krijuara në këtë Paralele, bënë faljen e Namazit në xhaminë e Abarati Teqesë, ku edhe u shtrua një drekë për të gjithë të pranishmit.

Në vazhdim vijon fjalimi që e mbajti Reis ul Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi para të pranishmëve.

Përshëndetje të nderuar mysafirë, të respektuar Muftij dhe punëtorë e bashkëpunëtorë të Bashkësisë Fetare Islame, Drejtor i Medreses Isa Beu dhe profesorë e nxënës të këtij institucioni.

Më lejoni që fillimisht në emrin tim personal dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë tu përshëndes me përshëndetjen absolute Islame Eselamu Alejkum...

Vërtetë është një kënaqësi e veçantë që sot ndodhemi në këtë objekt, të përfunduar të Medreses – Paraleles së Shtrirë për vajza, ku në vitet në vijim do të arsimohen nënat e ardhshme të Kombit

Për shumë nga ju, janë të njohura sakrificat me të cilat janë përballur punëtorët e Bashkësisë Fetare Islame bashkë me besimtarët tanë nga vendi e nga jashtë, për të vendosur themelet e diturisë nën këtë nënqiell. Investimi në diturinë është edhe investim për ardhmërinë.

Ashtu siç na mëson Kur'ani i Pavdekshëm, Islami të gjithëve na fton në dituri, se vetëm të ditur mund tu bëjmë ballë sfida të këtij shekulli.

Në këtë relacion jo-rastësisht Allahu Fuqplotë Muhamedin a.s. ia rekomandoi një dua parimore:

Thuaj (o Muhamed) O zot ma shto diturinë.

Dhe jorastësisht ajetet e para Kuranore ishin:

“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi, Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur ! Lexo, se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (El- Alek: 1-5)

Kërkimi i diturisë është detyrë e çdo muslimani. Prandaj falë besimit të palëkundur në Allahun Fuqplotë dhe sakrificave e angazhimeve të brezave tanë, ne po krijojmë hapësirë dhe mundësi që kjo dituri të përçohet nga brezi në brez.

Islami është feja përmes së cilës njerëzimi pranon udhëzimet përfundimtare nga Krijuesi i gjithësisë, duke e aftësuar për mëkëmbës të tij në tokë. Kur'ani i Pavdekshëm vlerëson lartë jetën njerëzore dhe insiston në civilizimin duke bërë thirrje në dituri.



Jo rastësisht fjala dituri dhe të tillat që kanë të bëjnë me të, në Kur'anin e Pavdekshëm hasen mbi 780 herë. Ajetet e para me të cilat filloi shpallja e Kur'anit ishin pikërisht mbi rëndësinë e leximit, penës dhe diturisë:

Kur'ani i Pavdekshëm thotë se ata që dinë, nuk janë njëllor me ata që nuk dinë:

“...Thuaj:”A janë njëllor ata që dinë me ata që nuk dinë...?” (Ez-Zumer:9)

Në këtë drejtim kemi edhe hadithe të shumta, ndër të cilat është edhe kjo:

“Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr.”

Apo “Ngjyra e pendës së dijetarit do të peshohet me gjakun e dëshmorëve në Ditën e Ringjalljes; dhe pastaj, ngjyra e pendës së dijetarëve do të parapëlqehet më shumë se gjaku i dëshmorëve.”

Sipas fesë islame, respektivisht Kur'anit dhe Sunetit të

Muhamedit a.s. rëndësia e shkencës dhe diturisë është e përhershme. Duhet theksuar se me gjithë rëndësinë që ka mësimi i shkencës dhe i teknologjisë, ato nuk konsiderohen të mjaftueshme në vetvete dhe muslimanët duhet, përveç se të ngrënë standardin e tyre në fushat materiale dhe shkencore, të kenë besim të fortë dhe të ndjekin parimet fetare për të përmbushur qëllimet e tyre.

Muslimanët duhet të përgatiten dhe të pajisen në çdo drejtim dhe meqë sot, shkencat eksperimentuese luajnë një rol themelor në çdo aspekt të jetës materiale, fuqizimi i kësaj përmase të politikës islame është domosdoshmëri. Prandaj Bashkësia Fetare Islame, me gjitha mundësitë e saja që i ka, po përpunon të krijoj qendra për të edukuar dhe arsimuar brezat e rinj.

Për këtë u jemi mirënjohës të gjithë njerëzve dhe besimtarëve

me vullnet të mirë. E sidomos për këtë objekt në të cilin po e inaugurojmë sot, i jam mirënjohës dhe falënderuar në emrin ti personal dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame, bamirësit - donatorit OSKAN GOKSAL, i cili me investimin e tij ekskluziv, ka kontributin në ndërtimin e kësaj ndërtese.

Sipas parimeve Islame, Ky është investimi më i çmueshëm që mund ta bëjë një njeri dhe vetëm Zoti mund ta shpërblen një vepër të tillë me shpërblimet e tij më të çmuara që i ka Madhëria e Tij... Ndërsa ne i lutemi Allahut të plotfuqishëm, ta rruan donatorin OSKAN GOKSAL, ti jep shëndet atij dhe familjes së tij dhe dhëntë Zoti që edhe në të ardhmen të jep kontribut në investime të ngjashme të cilat njëherit janë edhe më të çmueshmet. Në jetën e amshueshme allahu e shpërbleftë me xhenet

Dhe kur jemi te rëndësia e diturisë, dua të theksoj se në këtë përpjekje, edhe Medreseja Isa Beu, me hapjen e kësaj paraleleje, po vendos themelet e njohurive themelore të Islamit dhe e përgatit femrën muslimane për edukimin superior.

Më lejoni që me këtë rast tu përkujtoj një fjalë të urtë të popullit, e cila thotë: “Dora që e përkund djepin, e edukon edhe Kombin”.

Në këtë solemnitet nuk duhet ti harrojmë as mësimet e Muhammedit a.s. i cili ka thënë:

“Dituria është pasuria e humbur e një besimtari; prandaj, kërkojeni atë edhe po të jetë në duart e politeistëve.”

“Besimtari është gjithmonë në kërkim të urtësisë, kudo që ta gjejë atë, ajo është e tij, sepse ai e meriton ta ketë atë me shumë se kushdo tjetër.”

Më lejoni që krejt në fund ta shpalli të hapur këtë Paralele të re të Medresesë dhe në emrin e të gjithëve të pranishmëve këtu, nxënëseve që do të marrin diturinë nga këto banka, tu dëshiroj sa më tepër suksese, në mësim, në hulumtime të mirëfillta, me qëllim që të pajisen me sa më tepër dituri që në të ardhmen të bëhen shtyllë e fortë e familjeve tona. Gjithashtu i lus edhe profesoret e nderuara që njohuritë e tyre ti ndajnë bashkë me nxënëset dhe gjithmonë të jenë pranë tyre kur të kenë nevojë, me qëllim që ky vit shkollor të jetë sa më i suksesshëm dhe i bereqetshëm.

Zoti ju shpërbleftë dhe qofshi të bekuar.

(A.V.)



# Qendër Islame në Rijekë të Kroacisë

Nga 02 deri 04 Tetorë 2009 në Rijekë të Kroacisë me ftesë të Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kroacisë, h. Shefko ef. Omerbashiç ishte për vizitë delegacioni i BFI në krye me Reis ul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi. Më 03.10.2009 u hodhë gurthemel për ndërtimin e Qendrës Islame në qytetin e Rijekës, në këtë solemnitat morrën pjesë mbi 7000 vizitorë, rreth 350 personalitete, në mesin e të cilëve Kryetari i R. së Kroacisë, z. Stipe Mesiq, Ministri i Kulturës së Kroacisë, Prefekti i Rijekës dhe Zagrebit, Ministri i Vakufit të Katarit, Aïmad Abdulla Al-Marri, Kryetari i BFI, Reis ul Ulema, Haxhi Sulejman ef. Rexhepi i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI, Afrim ef. Tahiri dhe H. Jakup Selimovski.



Gjithashtu vlenë theksohet se në këtë ceremoni gurthemeli kishte të pranishëm hoxxhallarë nga Kroacia, Kryetari i Bashkësisë Islame të Bosnës dhe Hercegovinës, Mustafa Ceriq, teolog nga Sllovenija, Mali i Zi, Myftiu i Kosovës,



## Medreseja Isa-Beu me suksese të reja në garat Kur'anore në Zagreb

Me rastin e përvjetorit të 22-të të ekzistimit të xhamisë së Zagrebit, prej 22-24.10.2009 u mbajtën po në këtë xhami garat Kur'anore e që tani ka karakter tradicional.

Pjesëmarrësit në këto gara, që vinin nga të gjitha vendet duke nisur prej Anglisë, Finlandës në veri e deri në Bullgari dhe Maqedoni e Greqi në jug, që d.t.th pjesëmarrës ishin afër 78 garues nga 19 vende të Europës. Këshilli Organizues, myftiu i Zagrebit, Shefko Omerbashiç, përpara përfaqësuesve të Bashkësisë Fetare të Kroacisë, përfaqësuesve të korreve diplomatike të akredituara në Zagreb, përfaqësuesve të autoriteteve të qytetit të Zagrebit, mysafirëve të shumtë si dhe xhematit të shumtë të xhamisë së Zagrebit, garat e këtij viti i shpalli të hapura.

Edhe garat e këtij viti u mbajtën nën organizim të Meshihatit të Bashkësisë Islame të Kroacisë, Organizatës botërore të mësimin të Kur'anit përmendësh dhe Qendrës Islame në Zagreb.

Garat në vijim u mbajtën në këto pesë kategori:

- 1-Tilavet,
- 2-Tilavet nga nxënësit e Medreseve,
- 3-Hifz të 5 Xhuzave,

4-Hifz të 15 Xhuzave dhe  
5-Hifz të tërë Kur'anit.

Pas leximit të asheres, auditoriumit iu drejtua kryeimami i xhamisë hzf Alil Azizi i cili i kujtoi të pranishmit se xhamia e Zagrebit është bërë edhe më e njohur përmes organizimit të garave Kur'anore. Pas tij fjalën e pati përfaqësuesi i Organizatës Botërore për Hifz nga Arabia Saudite Halid Abdullah.

Ditën e xhuma dhe të shtunë, garuesit morrën pjesë sipas planit të parapregaditur të cilët i ka notuar komisioni shtatë antarësh i përbërë nga: Hfz.dr.Fadil Fazlic-kryetar dhe antarët: Halid Abdallah (Saudi), hzf.Alil Azizi (Kroaci), hzf.Mensur Malkic (Bosnjë), hzf. Bajram Ajeti (Maqedoni), Selman Okumush (Turqi) dhe hzf. Ferid el Hassan (Francë).

Të shtunën pas pjesëmarrjes së garuesit të fundit, në vijim derisa komisioni përgatitëj për shpalljen e fituesve, u mbajt edhe një mevlud i madh me të gjithë garuesit duke lexuar pjesë kur'anore, ilahije dhe citate të ndryshme.

Komisioni i garave së kryetarit të saj hzf.dr. Fadil Fazlic filloi shpalljen e fituesve të këtyre garave: nxënësi i vitit të katërt nga

Medresesë Isa-Beu-Shkup, hzf. Besir Limani në kategorinë e Medreseve zuri vendin e dytë. Ndërsa, në kategorinë "hifz 15 xhuza", hzf. Idriz Osmani, garuesi i Medresesë Isa-Beu, paralelja e djemve, Shtipit e zuri vendin e tretë.

Momente gëzimi dhe emocioneve vëreheshin në sytë e bashkatdhetarëve tanë të cilët veprojnë në Kroaci dhe që kishin ardhë ti ndjekin këto ngjarje.

Vijuan edhe vendet tjera të cilat për kuriozitet të lexuesve do ti përmendim të përgjithësuar në mënyrë telegrafike si vijon:

Kategoria:Tilavet-Medrese:

1. Xhenis Mulic,nxënës i medresesë Behram-beu në Tuzël-Bosnjë,
2. Besir Limani nxënës i medresesë Isa Beu në Shkup dhe Nejra Muhtari,nxënëse e medresesë"Dr. Ahmed Smajlović".Zagreb,dhe
3. Ammar Efendić,nxënës i medresesë Gazi Husrev- Sarajevë dhe Sabahudin Hašić,nxënës i Medresesë në Cazin-Bosnjë.

Kategoria:Tilavet-përgjithshëm:

1. Ibrahim Boughalab-Holandë,
2. Orhan Ademi-Preshevë,
3. Muhammed Abdullah Karabacak- edukator në internatin turk Sylejmanije në Zagreb.



Naim ef. Tërnavë, politikan, intelektual si dhe qytetarë të shumtë. Gurthemelin e kësaj Qendre Islame e filloi Ministri i Vakufit të Katarit, Aimad Abdulla Al-Marri.

Me këtë rast Reis ul Ulema i BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi vizitoi xhematet tona në Kroaci atë të Rijekës pastaj edhe të Zagrebit. Gjatë takimit të tyre Reis ul Ulema i njoftoi hollësisht për veprimtarinë e BFI, aktivitetet e këtij institucioni, thellimi i bashkëpunimit me Qendrat Islame në Diasporë duke filluar nga ato në Europë, Amerikë e deri tek ata në Kanada dhe Australi.

Kategoria: Hifz:

1. Omar Hasani Aswat-Angli, 12 vjeç ka mësuar Kur'anin;

2. Muhamed Al-Issati-Holandë;

3. Hfz. Alen Kehić –Bosnjë.

Kategoria:Hifz-15 xhuza:

1. Ait Menssour Muhamed-Francë;

2. Naffe Al-Isati –Rotterdam;

3. Idriz Osmani-Medreseja Isa-Beu, paralelja e Shtipit.

Kategoria:Hifz-5 Xhuza:

1. Ilias Bischri-Finlandë,

2. S a b a h u d i n Jerebičanin- Medreseja Isa Beg-Novi Pazar,

3. Safeta Xhondić-Fakulteti i shkencave islame-Novi Pazar.

Në fund të gjithë të pranishmive iu drejtua edhe njëherë myftiu i Zagrebit, Shefko Omerbashiq i cili iu lut Allahut për çdo të mirë dhe falënderoi të gjithë e në veçanti organizatorët duke u ndarë me dëshirë që edhe vitin e ardhshëm të takohen përsëri kështu kur xhamia e Zagrebit të festojë pranverën e 23-të të themelimit të saj.

# Gurthemel xhamie në Dollogozhdë të Strugës



Më 11 Tetorë 2009 në Dollogozhdë të Strugës u hodhë gurthemel për ndërtim të xhamisë së re. Në këtë solemnitet morrën pjesë Kryetari i BFI, Reis ul Ulema, Haxhi Sulejman ef. Rexhepi i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI, Afrim ef. Tairi, Myftiu i Myftinisë së Strugës, Ferat ef. Polisi, Myftiu i Myftinisë së Kërçovës, Murat ef. Huseini, Prefekti i qytetit të Strugës, z. Ramiz Merko, Koordinator i Ohrit, Afrim ef. Xhelili si dhe qytetarë të shumtë.

Fillimisht, të pranishmive iu drejtua Myftiu i Strugës, Ferat Polisi i cili në emër të Reis ul Ulemasë së BFI, H. Sulejman ef. Rexhepi dhe në emër të myftinisë përshëndeti pjesëmarrësit në këtë gurthemel. Ai vlerësoi punën e xhematit të Dollogozhdës duke theksuar se kjo vepër në vete ngërthen shumëçka, më çrast ne tregojmë vullnetin tonë të lartë për të kontribuar për Islam dhe ngritjen e vetëdijes fetare tek masa e gjërë. Me vepra të kësaj natyre do të vazhdojmë edhe më tej në të ardhmen”.

Ndërsa, Kryetari i BFI, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi mbajti fjalë rasti i cili theksoi se: “ Ne jemi shoqëri( ummet) që gjithmonë kemi ofruar gjëra pozitive për shoqërinë në të cilat kemi vepruar. Veprat tona kanë lënë gjurmë në të kaluarën në aspektin pozitiv dhe si të tilla kanë luajtur rol tejet të rëndësishëm në ngritjen e personalitetit të njeriut.

Islami ka kontribuar deri në skajshmëri me plotë përkushtim për të ndërtuar njeriun me vlera dhe për ta shndëruar atë në një individ të çmuar dhe të dobishëm për shoqërinë. Sot për të gjithë ne kjo është një ditë e veçantë, përmes kësaj vepre të madhe, a njëherit me qëllim të pastër do të hedhim këtë gurthemel xhamie që drita e Allahut xh.sh të kaplojë të gjithë ne dhe ajo të rezaton edhe tek gjeneratat e ardhshme të këtij populli( ummeti, shoqërie)”.

“Me ngritjen e tempujve të shenjtë ne tregojmë kulturën tonë fetare dhe besimin e lartë që kemi në Allahun xh.sh. Ndërtimi i xhamive konsiderohet vepër madhështore në Islam, ngase me ngritjen( themelimin) e tyre dhe objekteve tjera fetare islame në mënyrë të përpiktë kultivohet dhe mbrohet Islami dhe se Ne do të rezistojmë gjithmonë për të mbrojtë traditë dhe kulturën tonë të pastër autoktone në këto hapësira”- tha mes tjerash Kryetari i BFI-së. Ai shtoi se xhamitë kanë luajtur rol të rëndësishëm dhe të veçantë gjatë tërë historisë, përmes tyre është mbrojtur popullata jonë nga elementi më i rezikshëm që mund t'i ndodhë një populli siç është asimilimi. Roli që ka luajtur xhamia ndër shekuj ka qenë në shumë aspekte si në atë fetar po edhe në atë kombëtar...”

Gjithashtu edhe prefekti i Strugës, z. Ramiz Merko përshëndeti aktivitetin e qytetarëve, a njëherit tha se: “Me Reis ul Ulemanë e BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi po ndërtojmë xhami gjithandej, me çka vërtetoi fjalët e kreut të BFI se përmes xhamive është mbrojtë feja dhe kombi, tradita dhe kultura shqiptare, historia dhe vepra shumëshkëllore e shqiptarëve si popull autokton në këto troje”- tha Merko.

Në gurthemel u therë një kurban, duanë e së cilës e bëri Imami i fshatit, ashere u lexua nga Sekretari i përgjithshëm i BFI, Afrim ef. Tairi, ndërsa duanë e gurthemelit të kësaj xhamie e realizoi koordinatori i Ohrit, Afrim ef. Xhelili. Në fund të këtij solemniteti u realizua një koktej i përbashkët në shenjë shënimi të ndërtimit të xhamisë së fshatit Dollogozhdë të Strugës.

# Hapje solemne të xhamisë në Norovë të Prilepit

Më 25 Tetorë 2009 në fshatin Norovë të Prilepit u bë hapja solemne e xhamisë. Në këtë solemnitet morri pjesë Kryetari i BFI, Reis ul Ulema, Haxhi Sulejman ef. Rexhepi i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI, Afrim ef. Tairi. Gjithashtu në këtë ceremoni pjesëmarrës ishin Myftiu i Myftinisë së Kërçovës, Murat ef. Huseini, Koordinator i Myftinisë së Manastirit, Pllumb Veliu, si dhe qytetarë të shumtë. Kryetari i BFI, Reis ul Ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi mbajti fjalë rasti i cili theksoi se: "Ne jemi kreator të modelit më të lartë të ndërtimit të vlerave njerëzore, Islami është fe që gjithnjë përcjell

mesazhe inkurajuese dhe me vlerë, ngase parim elementar i njeriut është të ofron mundësi dhe gjëra pozitive për shoqërinë. Myslimanët gjithmonë kanë ofruar mundësi dhe alternativa për një botë më ndryshe"-tha mes tjerash Reis ul Ulema. Ai gjithashtu me këtë rast citoi një fjalë të Allahut xh.sh, nga libri i shenjtë Kurani, ku Allahu i Plotëfuqishëm në Suren Saff ajeti 8 thotë: "**Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, po Allahu e plotëson (e përhap) dritën e Vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët**". Andaj, dështimet janë të nduarnduarta të atyre që bëjnë përpjekje për të dëmtuar, shuar apo eliminuar

kulturën, trashigiminë dhe gjurmët që ka lënë Islami ndërshekuj. Veprat e myslimanëve kanë luajtur rol tejet të rëndësishëm në prosperimin e shoqërisë njerëzore. Sot, përmes kësaj veprë po tregojmë pjekurinë tonë fetare, kulturore dhe shpirtërore të ndërtuar në bazë të mësimëve të pastërta Islame. Tani, me një qëllim të pastër do të lëshojmë në përdorim këtë shtëpi të Allahut që drita e të Plotëfuqishmit të kaplojë të gjithë ne dhe ajo të rezaton edhe tek ardhmëria e këtij populli ( ummeti, shoqërie)". Këtë solemnitet e begatuan nxënësit që ndiqnin mësimet fetare tek Imami i fshatit me këndimet fetare, recitale dhe pjesë nga Kurani famëlartë.

## Zv.Ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite për vizitë në BFI

Më 24.10.2009, Abdulaziz bin Abdullah LA-Ammar, zv. Ministër për Çështje Fetare nga Mbretëria e Arabisë Saudite vizitoi Bashkësisë Fetare Islame në R.M. Me këtë rast Sekretari i përgjithshëm i BFI, H. Afrim ef. Tairi ishte nikoqir i zv.Ministrit, Abdullah La-Ammar. Ai i dëshiroi mirëseardhje dhe njëherit shprehi falënderime për respektin që tregoi për të vizituar institucion. Ai e njoftoi me veprimtarinë e BFI-së, mbi organizimin dhe zhvillimin e jetës Fetare Islame në Maqedoni. Gjithashtu e njoftoi për veprimtarinë e BFI dhe sukseset e arritura deri më tani, por i bindur se e ardhmja do të jetë edhe më e frytshme! Gjithashtu Sek. i Përgj. e njoftoi Zv. Ministrin, La-Ammar për institucionet edukativo- shkencore të BFI, Medresenë Isa-Beu dhe Fakultetin e Shkencave Islame. Ai mes tjerash tha se



këto institucione tani më janë brend për këtë shoqëri dhe më gjërë, të cilat kanë krijuar traditë dhe përvojë. Ndërsa në anën tjetër zv. Ministri për Çështje Fetare, Abdullah LA-Amma e përgëzoi Afrim ef. Tairin për sukseset e arritura të BFI në shumë aspekte, me çrast shprehi gatishmëri që bashkëpunimi të thellohet edhe më shumë mes Ministrisë në fjalë dhe BFI.

Meqë ai ishte për herë të parë në R. e Maqedonisë, mbeti i kënaqur me atë që dëgjoi për institucionin e vetëm të lartë fetar në R.M. Në fund zv. Abdullah LA-Ammar shprehi falënderime për mikëpritjen që iu bë nga Afrim ef. Tairi, ai shprehi se të gjithë ne duhet kontribuar që ummeti Islam të ketë një të ardhme edhe më të begatshme dhe më të suksesshme.

### VITRINA E LIBRIT



Vehbi Ibrahim - Xhigoli  
Kohë pa emër

## KOHË PA EMËR

"Kohë pa emër" është titulli i librit poetik të autorit tanimë të njohur për lexuesin e këtij nënqielli, Vehbi Ibrahim - Xhigoli nga Shkupi. Si në librin e tij të parë "Shtigjeve madhore", (botuar në 2005), ashtu edhe në këtë përmbledhje poetike të radhës, përmes vargjeve të përpiluara me një kujdes të madhë, Poeti jep mesazhet e tij lexuesit, duke dashur që atë ta zgjojë nga gafletit dhe nga gjumi syhapur.

Përmbledhja në fjalë është e ndarë në tre kapituj; në të parin përmes meditimit poetik, autori thurrë vargje për fatin e popullit të vet; në të dytin poeti poezi u përkushton figurave që ai ka respekt të madhë dhe në tretin poeti këshillon lexuesin me një urtësi të veçantë, duke kërkuar nga ai që të largohet nga veprat e këqija dhe të merr rrugën e drejtë.

Shikuar në tërësi, poezitë e Vehbi Ibrahimit-Xhigoli kanë një frymë fetaro-islame, të cilat karakterizohen me një urtësi të veçantë, gjë e cila bënë që kjo vepër të ketë një vlerë të madhe dhe si e tillë të kërkohet nga lexuesit.

Q. Osmani

# Vetëkënaqësia Akadematike dhe “Enciklopedia Shqiptare”

*“Është i patjetërsueshëm roli i Reis ul Ulemasë së atëhershëm H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili jo vetëm që hapi zemrën dhe ambientet e Medresesë për katër ditë rresht, por pa përkrahjen e tij si financiare ashtu edhe morale, kjo vepër asnjëherë nuk do ta shihte dritën e bardhë” - tha z. Dervishi.*

Nga Agron VOJNIKA

Akademikët ia bënë qejfin vetes. Dhe jo vetëm aq. Ata ia detektuan edhe Botës mbarë se ku është burimi i defekteve në mosdurimin ndëretnik si dhe faktin shumë të rëndësishëm, se kush i ushqen të rinjtë maqedonas me “helmin” e nacionalizmit të prapshtë. Në ditë të sotme të jesh nacionalist nuk është asgjë e keqe, sepse do të thotë ta duash kombin tënd, por nacionalizmi i prapshtë që këtu po kultivohet, nënkupton ta duash kombin tënd dhe të tjerët ti paraqesësh sa më keq. Për këtë shkak, në Maqedoni

kemi dy të vërteta, atë të ASHAM-it dhe të gjitha të tjerat. Akademia e Shkencës dhe Arteve të Maqedonisë, me Enciklopedinë e Maqedonase edhe një herë dëshmoi se është e prirur që të gjitha resurset dhe paratë që i ndahen nga populli ti përdorën në bërjen e vetëkënaqësisë.

Investimi në të kaluarën imagjinare, i kësaj Akademie, është një tregues i qartë se ora e atyre “akademikëve” në krye me Bllazhe Ristevskin, ka kohë që është ndalur dhe se ajo orë nuk mund të shërbejë më për të treguar kohën e së ardhmes të këtij vendi. Me akademi të tillë, jo që aspak

nuk mund të krenohen maqedonasit, por thënë troç ata duhet të turpërohen nga gjellët e djegura të këtij/tyre individëve.

Si pasojë e reagimeve të pafund të komunitetit shqiptar anëmbanë, si dhe reagimeve të shumta nga të gjitha popujt që jetojnë në Maqedoni dhe fqinjët tanë, përveç serbëve, u vendos që Enciklopedia të tërhiqej nga shpërndarja.

Por për të qenë fatkeqësia më e madhe, “heroi” Bllazhe Ristevski, duke luajtur rrolin e plakut të butë dhe shumë të mençur - vunderkingut, paraqitet në shumë medime me qëndrime të theksuara nacional-

iste dhe shpjegon se e vërteta është ashtu siç e ka shkruar ai. Në paraqitjen e tij të fundit në emisionin e “Nasha TV” (Jadi burrek so Janko), ai më në fund e shpalosi edhe qëllimin jetësor të tij, pra, të bëjë të pamundurën që një herë e përgjithmonë ta zhduk tezën se shqiptarët janë autoktonë në Maqedoni.

Me deklaratat e tija, se gjoja paska marrë të dhëna nga disa libra të shkruara dhe se gjoja shqiptarët dihet kur paskan ardhur në Maqedoni, Bllazhja edhe një herë hodhi patatet e nxehta tek duart e historianëve shqiptarë. Atëherë, nëse Bllazhja paska bërë



studimin e tij bazuar në ato disa shkrime të selektuara, edhe shqiptarët atëherë mund të sillen me papërgjegjësi si ai, dhe të bëjnë një Enciklopedi të bazuar në regjistrimin e fundit të bërë nga Perandoria Osmane (pak para Luftës së Parë Botërore) në të cilin nuk është i regjistruar asnjë maqedonas, madje termi maqedonas as që përmendet. Por a do të thotë kjo se maqedonasit e sotëm, nuk kanë ekzistuar deri atëherë dhe na paskan ardhur në Maqedoni pas luftës së Parë Botërore, apo edhe më keq, pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur Titoja u dha shtet (Republikë)?

Por jo, ne shqiptarët parapëlqejmë që ti njohim të tjerët ashtu siç janë me të gjitha namet dhe nishanet. Të paktën këtë e kemi vërtetuar gjithmonë dhe do të vazhdojmë ta vërtetojmë edhe në të ardhmen, duke e njohur shtetin dhe popullin maqedonas, gjuhën e tyre dhe kishën e tyre,tribute të cilat shumë nga fqinjët tanë nuk ua njohin fare, apo ua mohojnë tërësisht. Madje edhe qëllimi i këtij artikulli nuk ka të bëjë aspak me fyerjen ndaj fqinjëve tanë maqedonas, por përkundrazi, tu kujtoj të gjithëve se nëse Bllazhja mundet, mundemi edhe ne, e atëherë hendeku ndërretnik jo që nuk do të mbyllet asnjëherë, por do të thellohej deri në fund. Në këto kohëra, Maqedonia aspak nuk ka nevojë për një gjë të tillë. Shqiptarët jo vetëm që e kanë të qartë se janë pasardhësit e Ilirëve por edhe e kanë dëshmuar botërisht këtë gjë. Prandaj tezat se shqiptarët kanë ardhur në shekullin 16, ashtu siç paraqiten në Enciklopedinë e sajuar për "vetëkënaqësinë" e Bllazhes me shokë, janë të pabaza edhe atëherë kur ai përpiqet që ti paraqet shqiptarët të ardhur bashkë me Islamin në Maqedoni. Tërë Bota e din se Ilirët në këto troje kanë qenë edhe para Krishtit por edhe shumë më herët se kombi i z. Bllazhes, dhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jeto-

jnë në harmoni me të gjithë fqinjët, kushdo që janë ata.

### SHQIPTARËT E KANË VËRTETUAR AUTONOMINË E TYRE

Duke u frymëzuar nga teza e Akademik Bllazhe Ristevskit, se shqiptarët asesi nuk janë autoktonë në RM, më kujtohet se në vitin 1994, nga një grup intelektualësh shqiptarë (emra të njohur) u botua një libër i kuq: "Shqiptarët e Maqedonisë" dhe asokohe ishte shumë aktual. Fillimisht në vitin 1991 u mbajt një simpozium katër ditor, i cili theu akullin dhe nxori nga gjumi historianët shqiptarë, e më pas në vitin 1994, të gjitha veprat shkencore u përmbledhën dhe u botuan në një vepër të vetme. Si libri i parë që fliste për autoktoninë e shqiptarëve në Maqedoni, i botuar në gjuhën shqipe dhe angleze, nxiti shumë reageime të errëta të nëntokës shtetërore të Maqedonisë së asaj kohe. Pushteti i atëherëshëm bëri çmos që ai libër asnjëherë të mos e shohë dritën. Por falë vullnetit të palëkundur të atyre patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë, ai libër u botua për të dëshmuar sot kundër gënjeshtërave të Bllazhes.

Ky libër u botua nga Meshihati (sot Rijaseti) i Bashkësisë Islame në RM, dhe si pjesëtarë të redaksisë nuk mund të mos i përmendim emrat e njohur si: Prof. Dr. Masar Kodra, Prof. Dr. Kristaq Prifti, Dr. Ani Thomai, Dr. Muzafer Korkuti, Prof. Dr. Remzi Nesimi, Dr. Ali Vishko, Bahri Aliu dhe Mr. Ramadan Sinani. Ndërsa këshilli botues i kësaj vepre madhështore udhëhiqej nga H. Sulejman ef. Rexhepi si Kryetar dhe anëtarëve Prof. Dr. Masar Kodra, Prof. Dr. Remzi Nesimi, Dr. Ali Vishko, Dr. Xheladin Murati, Bahri Aliu, Prof. Dr. Fadil Sulejmani, Mr. Vehbi Xhemaili, Vehbi Bexheti, Qerim Arifi, Gjylimsere Kasapi dhe Xhemil Daci.

Të gjitha referatat e botuara në atë libër janë studime

të mirëfillta e të argumentuara në mënyrë shkencore dhe pretendojnë të japin një histori të plotë opinionit të gjerë shoqëror dhe shkencor, në lidhje çështjet e jetës shpirtërore e të kulturës materiale të popullit shqiptar të Maqedonisë, që nga kohërat e lashta e deri në ditët tona. Një theks i veçantë u vihet gjetjeve arkeologjike dhe të dhënave historike si dhe gjuhës dhe kulturës së lashtë ilire dhe arbërore në trevat e Ohrit, në Pelagoninë e lashtë, në zonën e Shkupit e vise të tjera që përbëjnë një dëshmi të palëkundshme të autoktonisë së popullit shqiptar të Maqedonisë së sotme, si pasardhëse e ilirëve dhe të lidhjeve të saj me kulturën ilire të viseve perëndimore bregdetare e me popujt e tjerë fqinj.

### KUSH U MUNDUA TA PENGONTE LIBRIN "SHQIPTARËT E MAQEDONISË"

Kur Bllazhe Ristevski me gjuhë të butë përpiqet të aktrojë sinqeritet "të madh" e thotë se nuk është anti-shqiptar, shumë kush mund ti besojë atij në fjalë, por me veprat e tij Bllazhja e ka dëshmuar dhe akoma po e dëshmon se ka qenë dhe mbetet Gogoli për gjithçka që është shqiptare në këtë vend.

Kryetari i këshillit botues të librit "Shqiptarët e Maqedonisë" Sulejman Rexhepi që në atë kohë ishte Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame, i cili edhe aktualisht është në postin e njëjtë, kujton ato ditë të mbushura plot me ankth.

"Kujtoj ato ditë kur po bënim përgatitjet që kjo vepër të dalë në dritë. Ai ishte libri i parë i këtij lloji që dëshmonte për autoktoninë e shqiptarëve të Maqedonisë dhe tërë punimet ishin të natyrës shkencore. Por nga ana e Qeverisë së Maqedonisë të asaj kohe, me të cilën udhëhiqte Kryeministri Nikolla Kljusev, u bë çmos

që me çdo kusht të pengohet dhe ndalohet botimi i kësaj vepre. Sapo Qeveria e Ekspertëve, që ishte kryekëput Qeveri politike, mori vesh për këtë libër, i aktivizoi të gjitha instancat shtetërore, që ta bllokojnë botimin e këtij libri. Ky libër kishte për qëllim që ti bashkëngjitet Enciklopedisë Islame në Institutin e Enciklopedisë Islame në Stamboll, por për shkak se kreu i atij instituti u keqinformua dhe u gënjye se gjoja, ky libër qenka kryekëput anti periudhës Osmane, teksti i tij u kthye në vendlindje. Madje kujtoj një medium i gjuhës shqipe, i cili ishte servil i qeverisë, pat dalë me një titull spektakolar: "Mbeti shara në gozhdë".

Por falë vullnetit tonë të pathyeshëm dhe rezistencës pa kompromis, me peripeci marramendëse, kjo vepër u botua në vendin tonë dhe sot shërben si një argument ndaj të gjitha të pavërtetave të thëna dhe atyre që do të thuheshin në të ardhmen.

Qeveria e atëherëshme për ta shprehë mllefën e madh pas botimit të veprës, nxitën disa individë - instrumente të tyre, të pakicave fetare në Maqedoni, kryesisht turq dhe boshnjakë dhe të cilët punonin në gazetatat e gjuhës turke Birluk dhe Zaman, që të më akuzojnë për gjoja racizëm dhe nacionalizëm, si dhe akuza absurde të tipit: Me paret e vitrave është botuar libri shqip. Kjo nuk ishte e vërtetë, pasi miku im Sherif nga Reçica e Vogël e Tetovës dhe disa të tjerë, e financuan tërësisht botimin e këtij libri. Kur këto akuza nuk dhanë efekt, atëherë u tentua që ta destabilizojnë tërësisht Bashkësinë Fetare. Por edhe atëherë dështuan. Duke mos pasur rrugëdalje tjetër, më ftuan në bisedë informative", kujton Sulejman Rexhepi

### BLLAZHE NË ROLIN E POLICIT

"Ishte pikërisht z. Bllazhe Ristevski i cili më mori në pyetje", thotë z. Rexhepi

duke shtuar më tej: “Ai në atëkohë mbante postin e zv-Kryeministrit të Qeverisë dhe Kryetar i komisionit për çështje fetare. Me të kisha një dialog shumë të ashpër, sepse pikërisht ishte prekur nga pjesa ku e kemi shkruar se jemi popull autokton në Maqedoni. Sapo hyra në zyrë më pyeti me fjalët: Çfarë nënkuptoni ju me fjalën Autokton?, ndërsa unë ju përgjigja se ju jeni vetë akademik dhe dukeni njeri i shkolluar, prandaj këtë pyetje do ta marr si provokim, e nuk do tu përgjigjem, sepse ju e dini mirë këtë përgjigje. Ai me një ton tepër nervoz, mu drejtua me pyetjen: ‘Ç’kërkoni ju shqiptarët në Maqedoni?’. I thashë se shqiptarët parimisht kërkojnë status të barabartë si popull me popullin maqedonas. Ndërsa Bllazhja mjaft i skuqur në fytyrë mu përgjigj me fjalët: ‘A bën tu bësh selam shqiptarëve se ata janë pakicë dhe duhet të pajtohen me atë status, përndryshe nuk kanë vend këtu dhe duhet ti bëjnë çare vetes’.

Po mirë i thashë unë atëherë, unë nuk jam ai që mund tu bëj selam sepse nuk kam mandat për këtë punë, por pasi që ti kërkon prej meje një gjë të tillë, atëherë unë kam më tepër të drejtë të kërkoj prej teje si nënkryetar i Qeverisë, a bën ti tu bësh selam maqedonasve se shqiptarët statusin e pakicës më tutje nuk e durojnë dhe nëse nuk realizohet përcaktimi dhe kërkesave të popullit shqiptar për barazi me maqedonasit, atëherë shqiptarët do të kërkojnë opsion tjetër, e ai është lëvizja për rikthim të Shqipërisë etnike dhe në moment kur të realizohet projekti i Shqipërisë etnike, atëherë është mirë ta paramendoni statusin tuaj ku mbeteni. Por unë kam bindje se atëherë ju përfundimisht do të përfundoni në tendencat e historisë tuaj. Por për atë nuk do të jenë fajtorë shqiptarët por ju, sepse ju me qëndrimet tuaja politike diskriminuese do ta detyroni popullin shqiptar të

kapet për një projekt të tillë. Pas këtyre fjalëve e lëshova tavolinën dhe nisa të dal. Atëherë ai u çua dhe mu afrua, më tha se ka një lutje për mua. ‘Ju lus që me çështje politike, ju personalisht nuk është mirë të merreni dhe mund ti shihni thjesht vetëm punët fetare’.

Unë ju përgjigja se: jam shumë i vetëdijshëm se çka duhet të punoj dhe veproj dhe për çka kam përgjegjësi, por ju më detyruar që lirisht mund të them se prej sot në mënyrë ekskluzive do të merrem me politikë. Dola nga zyra dhe prej atëherë me atë nuk kam pasur asnjë kontakt me të”, thotë Sulejman Rexhepi.

### SIMPOZIUMI QË NGRI-TI NË KËMBË KOMBIN

Nga ana tjetër edhe Dr. Doc. Nebi Dervishi – Kryetar i Shoqatës së Historianëve Shqiptarë në Maqedoni dhe ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës, për librin Shqiptarët e Maqedonisë, vlerëson se është libri i parë voluminoz i këtij lloji si dhe manual jo vetëm për historianët por edhe për linguistët, pasi që ky libër ndërthur në vete tema të ndryshme të cilat e vërtetojnë autoktoninë e shqiptarëve të Maqedonisë.

“Unë kisha fatin të jem pjesëmarrës në atë simpozium që u mbajt katër ditë me radhë si mysafir i ftuar personalisht nga profesori im i respektuar Dr. Masar Kodra dhe dua të theksoje të gjitha punimet që u lexuan në këtë simpozium, ishin të bazuara dhe argumentuara në mënyrë studimore dhe shkencore të cilat hedhin dritë mbi aspektet më të rëndësishme të historisë politike, etnike e kulturore të popullsisë shqiptare në trevat e tyre amtare. Më pas këto punime u përmbledhën dhe në redaktimin e Prof. Dr. Kristaq Priftit dhe Prof. Dr. Masar Kodrës dhe të tjerëve, u përmbledhën dhe u botuan në një vepër të vetme voluminoze, e cila jo vetëm atëherë, por edhe sot

na shërben si një manual i vërtetë historik dhe linguishtik”, thotë z. Dervishi, i cili më tej shton: “Është i patjetërsueshëm roli i Reis ul Ulemasë së atëhershëm H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili jo vetëm që hapi zemrën dhe ambientet e Medresesë për katër ditë rresht, por pa përkrahjen e tij si financiare ashtu edhe morale, kjo vepër asnjëherë nuk do ta shihte dritën e bardhë”.

Dr. Doc. Nebi Dervishi gjithashtu kujton edhe peripecitë nëpër të cilat kaloi botimi i kësaj vepre.

“Me vetë faktin se ky ishte simpoziumi i parë pas ardhjen së sistemit pluralist në vendin tonë, disa qarqe shprehën frikën e tyre dhe reagues menjëherë për të vënë stërkëmbëzat e tyre. Vetë fakti se në këtë vepër u trajtuan argumente nga sferat e arkeologjisë, antropologjisë, gjuhës, etnologjisë dhe trashëgimisë kulturore të shqiptarëve, nga periudha të ndryshme kohore, duke u nisur nga lashtësia e deri më sot, ishte një pengesë për ata që përpiqeshin ti paraqitnin shqiptarët ndryshe, apo si ardhacakë. Vetë fakti që fliste se kishat dhe manastiret e ndërtaura në kohërat e mesjetës në Maqedoninë Perëndimore janë edhe shqiptare, sepse para se të islami të vinte në Ballkan, ne shqiptarët kemi qenë të krishterë, bëri që në atë kohë të vihen në lëvizje shumë qarqe për ta penguar këtë gjë. Madje në libër janë trajtuar edhe argumente të cilat flasin qartë se para se Islami të vinte në Ballkan, shqiptarët rritet e tyre fetare i kanë kryer pikërisht nëpër ato kisha e manastire. Dikujt nuk i pëlqen kjo gjë dhe përpiqet ti fsheh këto të vërteta. Rasti më i fundit është edhe djegia e Manastirit Mbigur, në të cilin nuk u dogj material me vlerë prej pesë milion euro, por u dogj material vlera e të cilit nuk mund të përcaktohet me para. Shumë libra që kanë vërtetuar historinë e popullit të rajonit të Dibrës, kanë shkruar në pak-

thim me atë zjarr”, shpreh shqetësimin z. Dervishi

### ME KOKË TË FTOHTË

Edhe përkundër gjitha atyre ofendimeve si në baza nacionale ashtu edhe në ato fetare, shqiptarët bëjnë mirë që tërësisht ta injorojnë këtë Enciklopedi, se fundja, pikërisht shqiptarët nuk kanë pse të frikohen apo turpërohen për identitetin e tyre. Madje më mirë thënë kjo enciklopedi sado me qëllime të errëta, i kishte anët pozitive. Ashtu siç pat reaguuar fillimisht z. Arbër Xhaferi, kur tha se: “Asnjë politikan apo individ nuk do të mund ti bashkonte shqiptarët më tepër sesa i bashkoi Enciklopedia Maqedonase”, shqiptarët duhet të jenë krenarë dhe të mos lejojnë që të nervozohen me broçkullat dhe gënjeshtat që i kanë shkruar disa individë, për ti kënaqur epshet e tyre.

Por një fakt i patjetërsueshëm është se kjo Enciklopedi e vetëkënaqësisë së akademikëve maqedonas, dukshëm po i lëkund themelet e brishtë të bashkëjetesës sonë. Sikur duket për herë të parë që nga viti 2001, politikanët, intelektualët dhe populli shqiptar janë më të bashkuar se kurrë në qëndrimin e tyre, për tu bërë ballë të pavërtetave dhe fabrikimeve të qëllimshme që janë botuar në atë libër të kotë.

Në këto momente, vlen të theksohet edhe përkrahja dhe kritikata që vijnë edhe nga disa intelektualë me vullnet të mirë nga pala maqedonase, të cilët në të shumtën e rasteve vlerësojnë se një Enciklopedia e tillë, e cila diskualifikon bashkatdhetarët, nuk i duhet Maqedonisë në këto momente. Nga ana tjetër, ajo ka po të njëjtin efekt edhe në qarqet e marrëdhënies diplomatike me fqinjët tanë dhe njëherit mund të shndërrohet si një izolues për Maqedoninë, në aspiratat euro-atlantike.

## ANALIZË

# Raporti i Brukselit për të drejtat dhe liritë fetare në Maqedoni

*Raporti i 14 Tetorit i cili u publikua nga ana e Brukselit për përparimin e Maqedonisë në drejtim të përmbushjes së standardeve dhe aspiratave për integrimin e vendit drejt Unionit European, qartazi shihet se bënë fjalë edhe për pozitën e Bashkësisë Fetare Islame në R.M, të drejtat dhe liritë fetare, të drejtat pronësore etj.*

*Raporti në fjalë qartazi flet për pronat e Bashkësisë Fetare Islame në R.M të cilat në mënyra dhe forma të ndryshme janë marrur nga pushteti i atëhershëm Jugosllavo-komunist në mënyrë të paligjshme, dhe të njëjtat këtij sistemi i kanë shërbyer gati pesëdhjetë vite, të njëjtat po vazhdojnë që të mbahen peng nga një system tjetër të ashtuquajtur demokratik?!*

## Skender Buzaku

Vendi ynë si një shtet i cili mëton që t'i bashkangjitet familjes së Unionit European është duke u përballuar me shumë pengesa të cilat shumë rëndë është duke i tejkaluar.

Duke patur parasysh se Brukseli është qendër e cila në mënyrë të përpiktë i përcjell dhe analizon ngjarjet dhe zhvillimet në Maqedoni, mund të themi se edhe kësaj rradhe kjo qendër na solli një raport i ashtuquajtur pozitiv por kuptohet me shumë vërejtje dhe sugjerime serioze të cilat vendi ynë duhet të njëjtat t'i plotësojë në kohë të duhur, sepse në të kundërtën mund të sanksionohet në ngecjen për anëtarësimin në Nato dhe Unionin European.

Një shtet si Maqedonia me një popullatë të vogël, me ekonomi të dobët dhe me një papunësi të lartë e që assesi të lirohet nga frustrimet politike dhe pragmatike me qëllim që t'i bashkangjitet një projekti dobiprurës për ngritje të ekonomisë dhe mënjanimin të shkallës së papunësisë dhe varfërisë.

Raporti i Brukselit i cili u publikua për përparimin e Maqedonisë në drejtim të përmbushjes së objektivave për anëtarësimin e saj në Unionin European ishte i përcjellur me shumë vërejtje dhe rekomandime të cilat politika ditore nganjëherë të njëjtat i shmangë, kurse ndonjëherë me të atillat nuk guxon që të ballafaqohet nga frika e humbjes së influencës të populli dhe simpatizantët e tyre politik.

## Çështja e kthimit të pronave Institucionit të BFI-së në R.M

Raporti i 14 Tetorit i cili u publikua nga ana e Brukselit për përparimin e Maqedonisë në drejtim të përmbushjes së standardeve dhe aspiratave për integrimin e vendit drejt Unionit European, qartazi shihet se bënë fjalë edhe për pozitën e Bashkësisë Fetare Islame në R.M, të drejtat dhe liritë fetare, të drejtat pronësore etj.

Raporti në fjalë qartazi flet për pronat e Bashkësisë Fetare Islame në R.M të cilat në mënyra dhe forma të ndryshme janë marrur nga pushteti i atëhershëm Jugosllavo-komunist në mënyrë të paligjshme, dhe të njëjtat ky sistem i ka shfrytëzuar gati pesëdhjetë vite, e që të njëjtat po vazhdojnë që të mbahen peng nga një sistem tjetër i ashtuquajtur demokratik?!

Por, edhe përkundër faktit se në Maqedoni u bë ndryshimi i një sistemi njëpartiak dhe legjitimiteti i popullit kaloi te sistemi shumëpartiak e demokratik, shumë aspekte të të drejtave të lirive fetare, trashëgimoro-kulturore si dhe çështja e kthimit të pronave të Bashkësisë Fetare Islame në R.M është duke ecur me hapa shumë të ngadalshëm dhe me pak suksese.

Përkundër asaj se para shumë viteve është sjellur ligji për denacionalizimin dhe kompenzimin e pronave të cilat në mënyrë të paligjshme ishin zaptuar dhe uzurpuar nga pushteti i atëhershëm Jugosllav, ky ligj

është implementuar dhe aprovuar shumë pak nga qarqet e shtetit tonë.

Si duket, shumica e institucioneve të cilat tani janë duke vepruar këto dy dekada në vendin tone, ende nuk po kanë mundësi që të çlirohen nga paragjykimet dhe ngarkimet e sistemit të kalueshëm i cili me çdo kusht ka tentuar që të rrënojë dhe shlyej çdo gjë që ka qenë në favor të Bashkësisë Fetare Islame në R.M dhe muslimanëve të këtyre trojeve në përgjithësi.


Nga ana tjetër, qarqet shtetërore kanë formuar disa komisione të cilat kanë marrë përsipër që të shpejtojnë dhe intensifikojnë këtë process të kthimit të pronave mirëpo vendimet e tyre përfundimtare në të shumtën e rasteve stagnojnë dhe kthehen përsëri në rishqyrtim për arsye të ankesës së avokatit të shtetit.

Mirëpo është për t'u habitur sepse nga ana e avokatit të shtetit këto ankesa bëhen pa argumente dhe fakte të verifikuara, sepse për të njëjta nuk ka asnjë fakt apo dokumentacion i cili do të tregonte të kundërtën.

## ÇKA NUK ËSHTË THEKSUAR NË RAPORT:

Në raportin e Brukselit që ka të bëjë për Maqedoninë nuk janë theksuar disa elemente mjaft të rëndësishme të cilat kanë vlerë jetike e primare në respektimin e lirive dhe të drejtave fetare në Maqedoni.

çështja që ka të bëjë me ndërtimin dhe rindërtimin e



xhamive nëpër vende dhe pjesë ku myslimanët e vendit janë pakicë, në raste të shumta nga faktorë dhe subjekte të ndryshme është penguar, mirëpo duhet të jetë e qartë një gjë që një shtet siç është Maqedonia duhet që me seriozitet të plotë ti zgjidh këto probleme sepse duhet patjetër të ruhet harmonia dhe kohezioni shoqëror

Pasiqë Maqedonia ëshyë shtet multifetar dhe multi-kulturor, ky element ashtu siç është i paraparë në Kushtetutën e shtetit duhet të implementohet dhe jetësohet edhe në jetën e përditshme.

Prandaj duke u bazuar në këto realitete dhe të dhëna nëse dëshirojmë që të shkojmë përpara duhet që ne si shtet i vogël t'i respektojmë dhe kultivojmë këto vlera të ndryshme, sepse respektimi dhe kultivimi i vlerave të përbashkëta na bënë që më mirë të komunikojmë dhe të njihe mi ndërmjet

**P.S Si përfaqësues i Bashkësisë Fetare Islame në këshillin nacional për eurointegrime pranë Parlamentit të Maqedonisë çdo herë kam prezentuar kërkesat dhe nevojat të cilat ka Institucioni i Bashkësisë Fetare Islame në R.M dhe myslimanët e vendit, për të cilat janë alarmuar Institucionet dhe subjektet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit.**

**Andaj, jam i kënaqur që ca prej këtyre vërejtjeve janë të përfshira në Raportin e Brukselit, kurse ca të tjera shpresoj që të përfshihen në të ardhmen.**

**Është shumë e qartë se pa përmbushjen e këtyre objektivave primare, Maqedonia do të ketë ngecje të mëdha drejt integritimit në NATO dhe Unionin Europian.**

**Autori është Sekretar i Muftinisë së Shkupit dhe përfaqësues i Bashkësisë Fetare Islame në R.M në Këshillin nacional për Eurointegrime pranë Parlamentit të Maqedonisë**

# HAXHXHI DHE UMRE



Nga leximi i ajeteve Kur'anore vërejmë se Haxhxhi është obligim i domosdoshëm dhe një nga shtyllat – shartet e fesë së pastër islame. Pejngamberi a.s. ka thënë: “Islami është ngritur në pesë shtylla: në dëshmi se nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, dhe se Muhamedi a.s. është i dërguari i All-llahut, falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i ramazanit, dhe vizita e shtëpisë (haxhxhi) në qabe”. Ne në vazhdim do të flasim vetëm për rregullat që kanë të bëjnë me Haxhxhin. Kur`ani fisnik thotë: “Dhe thirr ndër njerëz për haxhxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.” (El Haxhxh, 27)

Shumë dijetarë i bënë një të thellë studiues këtij ajeti kur'anor, i cili tregon për fshehtësitë e Allahut në universin e Tij. Nga ky ajet, gjithashtu mësojmë për një element shumë me rëndësi! Shtrohet pyetja: si mund të renditet apo të organizohet i

gjithë njerëzimi për të arritur nga të gjitha anët dhe rrugët e largëta, kur dihet se thirrësi prej Qabes mund t'i thërrasë vetëm haxhilerët që gjenden brenda aty. Është e vërtetë se ata asnjëherë nuk e kanë prishur rendin e haxhit, asnjëherë nuk kanë shprehur pakënaqësi, porse gjithmonë kanë qenë të kënaqur. Është imani-besimi i fortë e i paluhatshëm (në Allahun xh.sh.) që ua shndrit rrugën të gjithëve atyre që arrijnë aty dhe gjatë qëndrimit të tyre në atë vend të shenjtë. Nëse mundësitë e njerit janë të kufizuara, fuqia e Allahut është e pakufishme. Nëse zëri i thirrësit është i dobët, apo mund të dëgjohet jo më larg se një kilometër, atëherë nuk kemi se ç' të bëjmë tjetër veçse t' i pranojmë gjërat që mund të ndodhin vetëm prej Allahut Fuqiptotë, i Cili vendos çdo gjë që dëshiron në këtë botë me vullnetin e Tij të paskajshëm. Këtë më së miri e sqaron momenti kur Allahu xh.sh. e urdhëroi Ibrahimin a.s. që t'i

thirr njerëzit për në haxh: “Dhe thirr ndër njerëz për haxhin...” Ai (Ibrahimi a.s.) i tha: “O Zot! E çfarë vlefte mund të ketë zëri im që ta njohtë hapësirën?” Allahu xh.sh. iu përgjigj: “Për ty është që të thërrasësh e ta paraqesësh thirrjen, kush të dëgjojë le të dëgjojë...” Allahu xh.sh. e urdhëroi Ibrahimin a.s. që t' i thërrasë njerëzit për në haxh nga shkaku se zëri mund të depërtojë edhe deri tek ata që janë të verbër apo që nuk dinë të lexojnë. Ndaj, telbija mbeti si simbol dhe pjesë e haxhit, përmes të cilit haxhilerët thirren me zë: “LEBEJKE ALL-LLAHUME LEBEJK. LEBEJKE LA SHERIKE LEKE LEB-BEJK. INNEL HAMDE VE NIAMETE LEKE VEL MULKU LA SHERIKE LEKE”. Me këtë pos që i bëhet lutje Allahut xh.sh. në të njëjtën kohë i përgjigjemi edhe thirrjes së Tij, duke thënë: “Lebejke” që do të thotë “të përgjigjem...” Përveç përgjigjes sonë për në haxh, gjithashtu hyjmë edhe në zbatimin e shumë rregullave që i

përmbledh haxhi në esencën e vet, për të cilat do të flasim në vazhdim. Mirëpo, i nderuari haxhi! Ta kesh parasysh se i gjithë haxhi përbën një edukatë të brumosur e të farkuar në kullën e imanit-besimit në një Zot të Plotfuqishëm. Pra, udhëtimi për në haxh, për atë që ka mundësi është shprehje e besimit të thellë e të paluhatshtëm në një Zot. Po ashtu, ky obligim, apo, kjo shtyllë e pestë e islamit, i nxitë myslimanët kudo në botë që të jenë punëtorë të palodhshëm dhe që me përpjekjet dhe mundin e tyre të shkojnë në vendin e tyre të shenjtë për ta pastruar shpirtin i cili ka nevojë për pastrim dhe ushqim. Vizita e Shtëpisë së Shenjtë, pra, Qabes, është me të vërtetë një ushqim i plotë shpirtëror.

Dhe në fund, shpëtimi, bekimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi ju! Me nderime! autori - El bhji El Huli

### **Haxhi dhe Umreja mes kuptimit gjuhësor (terminologjik) dhe kuptimit në Sheriat (etimologjik)**

1. Fjala HAXH do të thotë qëllim, synim. Në këtë rast, qëllim apo synim është të vizituarit e Qabes, Shtëpinë e pastër të Allahut xh.sh. të cilën e bekoj Ai dhe e bëri obligim vizitën e saj.

2. Ndërkaq, fjala UMRE do të thotë vizitë - pra vizitë Qabes me qëllim të afrimit tek Zoti Fuqplotë.

Vlen të theksohet se që të dyja, edhe Haxhi edhe Umreja kanë dallim njëra prej tjetrës dhe bartin karakteristika për të cilat do t' ju njoftojmë në vazhdim.

### **RREGULLAT E HAXHIT DHE TË UMRES**

Haxhi është obligim i domosdoshëm, i argumentuar me ajete kur'anore e me hadithe të Pejgamberit a.s.

a) Argument i Kur'anit Famëlartë është ajeti ku Allahu xh.sh. urdhëron: "Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është bërë obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo". Nga ky ajete kuptohet se Allahu xh.sh. haxhin e beri obligim që për hir të Tij besimtarët të cilët posedojnë pasuri të shkojnë në Qabe, pa kursyer, ngase Krijuesi Fuqplotë është Ai që i dhuroi njeriut të mira të panumërta

materiale e shpirtërore.

b) Si argument nga suneti i Pejgamberit a.s. mund të shërbejë hadithi që e transmeton Ibni Abasi e që thotë: "Gjatë një fjalimi të vet Resulullahu s.a.v.s. mes tjerash tha: "O ju njerëz, haxhi është caktuar për ju, e ju veproni ashtu, shkoni në haxh." Në ndërkohë u ngrit Akrea, djali i Habisit dhe e pyeti: "A për çdo vit, o i Dërguari i Allahut?" Pejgamberi a.s. iu përgjigj: "Nëse ju them po, do t' ju obligoj, e nëse ju obligoj, nuk do të veproni ashtu e as që do të keni mundësi përherë. Haxhi duhet të bëhet njëherë, e ai që e përsërit disa herë, e bën këtë nga dëshira dhe vullneti i tij." Po të sqarohet siç duhet porosia e Pejgamberit a.s., mund të konstatohet se i Dërguari i Allahut xh.sh. na e bën me dije se "haxhi është bërë farz".

2. Po ashtu, në bazë të ligjëratës së Pejgamberit a.s. të cilin e transmeton Ibni Abasi, argumentohet se haxhi, respektivisht vizita e Qabes, nuk është obligim të bëhet më shumë se një herë dhe, ai që e viziton më shumë se një herë, këtë e bënë nga dëshira e vet.

3. Kur bëhet fjala për Umren, një grup dietarësh islam e vlerësuan atë si punë të lavdëruar, pra mustehab, e kursesi farz. Lidhur me këtë Ebu Hurejra r.a. transmeton një hadith të Pejgamberit a.s. ku thuhet: "Ka thënë Pejgamberi i Allahut: "Haxhi në kohë të caktuar është farz, ndërsa umreja është vullnet." Njëri nga të pranishmit iu drejtua: "O i Dërguari i Allahut, na trego për umren, është apo nuk është obligim!" E Pejgamberi a.s. iu përgjigj: "Jo, por kush e kryen umren është gjë e mirë për të." Siç shihet edhe nga ky hadith, umreja nuk është obligim, farz, por kryerja e umres e afron besimtarin tek Allahu xh.sh. dhe pa dyshim është më mirë të afrohem tek Krijuesi se sa ta lëmë anash umren. Pra, më i lavdëruar është vullneti i mirë dhe dëshira se sa përtacia dhe kopracia. Një grup tjetër dietarësh islam, e konsideron umren, në një mënyrë, si farz, duke marrë për mbështetje hadithin të cilin e bart gojarisht i biri i Abdullahut, Xhabiri, që thotë: "Ka thënë Pejgamberi a.s.: "Haxhi dhe umreja janë dy farze." Po ashtu, transmetohet prej Aishes r.a. e cila e paska pyetur Pejgamberin a.s.: "O i

Dërguari i Allahut, a kërkohet nga femra xhihadi?" Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Po, edhe nga ato kërkohet xhihadi, pa vrasje e dyluftim, e kjo është shkuarja në haxh dhe në umre." Duhet theksuar këtu se, edhe fëmija i cili ka arritur moshën e pjekurisë dhe ka vetëdije të plotë, e si i këtillë dëshiron të shkojë në haxh për hir të Allahut xh.sh., atëherë ai e ka obligim që vërtet të shkojë e ta kryej këtë obligim

4. Ndër obligimet tjera që parashtrihen për kryerjen e haxhit është edhe kjo që del nga porosia e Pejgamberit a.s. i cili porositi që duhet shpejtuar në kryerjen e Haxhit.

### **PËR KEND ËSHTË HAXHI OBLIGIM**

1. Haxhi është obligim për çdo mysliman që është i pjekur në moshë dhe i mençur (psikikisht i aftë), e nuk është obligim për jomyslimanin, as për fëmijët, e as për të rinjtë që ende nuk kanë hyrë në pubertet, siç nuk është obligim as për atë që psikikisht nuk është i aftë. Kjo konfirmohet edhe në këtë hadith të Pejgamberit a.s.: "Është ngritur lapsi për tri kategori njerëzish: "Për atë që është në gjumë për derisa të zgjohet, për fëmijën derisa të rritet e të hyjë në moshën e pjekurisë dhe për atë që në një periudhë është i sëmurë psikikisht përderisa t' i rikthehet vetëdija."

2. Mirëpo për kryerjen e këtij

obligimi kushtëzohet që personi të ketë edhe kushte materiale. Këtë e vërteton edhe ajeti kur'anor i cili thotë: "Për hir të Allahut vizita e shtëpisë (Qabes) për njerëzit është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo." Dietarët islam kur e zbërthyen këtë ajet kur'anor konstatojnë se termi "mundësi udhëtimi" i dedikohet atyre që kanë mundësi t' i përballojnë harxhimet e udhëtimit. Kur e pyetën Pejgamberin a.s. për fjalën "ES SEBILL" që në përkthim do të thotë "mundësi udhëtimi", iu përgjigj duke u sqaruar se fjala është për tepicën dhe prehjen.

Nga kjo nënkuptohet se këtu fjala është për ata që nuk jetojnë as në Meke e as në rrethinë e që posedojnë pasuri për t' i përballuar rrugës deri në haxh dhe, po ashtu, prej pasurisë që ka një pjesë të saj ia lë familjes e cila duhet të mos ndjejë mungesë ushqimi përderisa të kthehet ai prej haxhit. Pra kjo që u tha këtu është kusht i domosdoshëm për atë i cili shpreh dëshirë për ta zbatuar urdhrin e Allahut xh.sh. , porse që nuk është vendas i Mekes por i vendeve të largëta. Ndërsa sa i përket banorëve të Mekës e të rrethinës, meqë e kanë mundësinë e udhëtimit për çdo moment, ky kusht për ta nuk mund të vijë në konsiderim. Sa po kalon koha aq më tepër shkenca po përparon e po përsoset e me këtë edhe mjetet e komunikacionit po modernizohen, kështu që sot udhëtimi për në Shtëpinë e Zotit



xh.sh. po bëhet i mundshëm përmes lloj-lloj mjeteve, të pajisura, veç tjerash, edhe me ushqime të ndryshme e të freskëta. Kjo po mundëson që në rrugë për në haxh nuk ka më nevojë që haxhiu të marrë ushqim me vete, sepse, pos në mjetet e udhëtimit ushqimin e gjen të bollshëm e të freskët në çdo vend e skaj të rrugës.

3. Kusht tjetër që kërkohet për kryerjen e haxhit është edhe ai që personi duhet të jetë i moshës së pjekur, që do të thotë se, sabiu-kalamani nuk obligohet ta bëjë haxhin. Mirëpo nëse shkon në haxh bashkë me familjen e vet, ai mund t' i kryej të gjitha ceremonitë, ndërkaq, në këtë rast, haxhi i tij është i vërtetë. Por, kur i njëjti hy në pubertet haxhi i tij më nuk merret parasysht, që do të thotë se ai edhe më tej mbetet i obliguar të shkojë në haxh. Kjo sepse, përderisa ka qenë fëmijë ai nuk ka qenë në gjendje për ta kuptuar përgjegjësinë dhe ka qenë i varur prej prindërve të vet si dhe ka vepruar ashtu siç ka parë. Këtë e konfirmon edhe ky hadith: "Në qoftë se një vogëlush e ka kryer haxhin me prindërit e vet, pastaj (më vonë) hy në pubertet (në moshën e pjekurisë) për të njëjtin kërkohet përsëritja e haxhit." Nëse fëmija nuk ka ihram, për atë tërë barrën e mbanë prindi i tij, për të lutjet si dhe hedhjen e gurëve e bën prindi i tij.

4. Ndërkaq, sa i përket kryerjes së haxhit nga ana e femrës këtu shtrohen edhe disa kushte tjera që u theksuan nga

disa dijetarë islam të cilët thonë se, femra e cila shkon në haxh duhet të jetë e shoqëruar nga bashkëshorti i saj, ose nga një mashkull që është shumë i afërt me të, si p.sh.: djali apo vëllai. Ekziston edhe një mendim tjetër i një grup dijetarësh të cilët theksojnë se femra është e obliguar të shkojë në haxh, pa varësisht se a ka burrë apo të afërm tjetër.

5. Nëse i ndjeri nuk arrin ta kryej haxhin, ndërkaq për këtë ka shprehur dëshirë para se të vdesë, atëherë trashëgimtari i tij duhet të shkojë në vend të tij me pasurinë e vet, apo me pasurinë që e ka lënë i ndjeri, e nëse nuk ka mundësi të shkojë vetë, atëherë kërkohet që ta caktojë një njeri tjetër të cilit do t' ia paguajë të gjitha shpenzimet.

6. Nëse personi ka hyrë në kohën e pleqërisë së rëndë, apo vuan prej ndonjë sëmundje të pashëruar, atëherë prej tij kërkohet që ta caktojë ndonjë njeri i cili do të shkojë në haxh për të. Në këtë rast, personi që shkon bedel është i obliguar që të gjitha ceremonitë dhe lutjet t' i kryejë në emër të atij për të cilin ka shkuar në haxh. Të theksojmë këtë se, në këtë rast ai person që shkon në haxh si bedel, paraprakisht ai duhet ta ketë të kryer këtë kusht, pra të ketë qenë në haxh për vete.

## **KOHA E POSAÇME PËR HAXH DHE UMRE (MIKATET E HAXHIT DHE UMRES)**

Kohët përcaktojnë shumësin e kohës. Ndërsa, koha e posaçme është kohë e caktuar për kryerjen e ndonjë urdhri. Kur është fjala për kohën e caktuar për haxh, atë e përbëjnë kohëzgjatja e qëndrimit në haxh dhe kryerja e ceremonive. Në kohën e posaçme hy momenti i kryerjes së urdhrit dhe vendi në të cilin duhet kryer urdhri. Te haxhi dhe umreja janë të caktuara vendet për ta kryer urdhrin, e po ashtu është e caktuar edhe koha për takimin e haxhilerëve. Për këtë shkak këto përcaktime ndahen në dy lloje:

- përcaktimi i kohës
- përcaktimi i vendit

### **1. PËRCAKTIMI (MIKATI) I KOHËS.**

Kohën e kryerjes së haxhit e përcaktoi dhe e urdhëroi Zoti i

Madhërishtëm dhe, pikërisht Ai e caktoi edhe kohën kur duhet të kryhet haxhi me të gjitha ceremonitë e veta. Lidhur me këtë Kur'ani famëlartë thotë: "Haxhi është në muajt e caktuar..." E këta muaj janë: muaji sheval, dhul-kade dhe dhul-hixhe. Lidhur me këta muaj shumica e dijetarëve islam thonë se, vetëm dhjetë ditët e parë të muajit dhul-hixhe bëjnë pjesë në muajt e haxhit. Kur analizohet urdhri i Allahut: "Haxhi është në muajt e caktuar", mund të konstatohet se, kurrsesi nuk lejohet që haxhi të kryhet as para e as pas këtyre muajve. Pra, nuk lejohet të hymë në haxh para muajve të caktuar. Ndërsa, kur është në pyetje umreja, dihet se për kryerjen e saj nuk ka kohë të caktuar. Umreja mund të kryhet në çdo periudhë kohore, pra edhe gjatë muajit të haxhit, çështje kjo që, esencialisht, e dallon haxhin prej umres. Është e njohur se Pejgamberi a.s. e ka bërë umren në muajin sheval dhe në muajin dhul-kade, dhe, lidhur me këtë ka thënë: "Umreja në muajin ramazan, është i përafërt me haxhin". Duhet theksuar se porosia e këtij hadithi nuk do të thotë se umreja e kryer në muajin ramazan mund ta zëvendësojë haxhin, por do të thotë se, umreja në ramazan ka vleftë të madhe dhe ai që e kryen atë në këtë muaj pret shpërblim të madh nga Allahu Fuqiptotë. Sidoqoftë, edhe po qe se kryhet umreja në muajin ramazan, njeriu që e kryen ka sevape të mëdha, por obligimi i kryerjes së haxhit mbetet domosdoshmëri.

### **2. PËRKUFIZIMI (MIKATI) I VENDEVE.**

Siç theksuam më sipër, koha për kryerjen e haxhit dhe të umres është caktuar prej vetë Allahut xh.sh., i Cili për mysafirët e Mekës, qoftë në haxh apo umre, ka kërkuar që në Shtëpinë e Tij të hynë të pastër në çdo aspekt, të veshur me ihrame që janë simbol i pastërtisë. Edhe vetë veshja e ihramit ka kohën dhe vendin e caktuar, ngase duhet të vishet jashtë Mekes, e me qëllim që ai i cili udhëton për në Qabe ta ndërrojë gjendjen e tij shpirtërore dhe pamjen fizike, të pastrohet nga çdo e keqe dhe ta largojë çdo gjë të mallkuar prej vetes. Vetëm i këtillë mysafiri i Allahut mund ta kryej vizitën e

vendeve të bekuara e të shenjta. Vendet ku vishen haxhilerët në legjislaturën islame njihen si mikate, gjegjësisht, si vendtakime, si vende të përcaktuara apo si vende të nisjes. Rëndësi të posaçme mikateve u dha edhe vetë Pejgamberi a.s. i cili i caktoi në të katër anët e Mekes:

a) Dhul-Halife: përafërsisht gjendet katërqindpesëdhjetë kilometra në veri të Mekës, e vend i nisjes konsiderohet edhe Medina dhe çdo vend tjetër që gjendet në veri të Mekës.

b) El-Xuhafe: është një fshat në veriperëndim të Mekës. Pejgamberi a.s. pat thënë se populli i Shamit e ka këtë vend për vendnisje. Përndryshe, ky vend u pat shkatërruar tërësisht në kohërat kur i takonte tokave të Shamit, kurse sot në atë vend gjendet fshati Rabig që konsiderohet vendtubim i haxhilerëve të Shamit, apo vend prej ku kërkohet që haxhilerët e Shamit, të Egjiptit, të tokave të Turqisë, të shteteve të Ballkanit dhe vendeve të tjera rreth tyre, siç janë Libia, Maroku, Tunisi, Algjeria etj. që haxhilerët e këtyre viseve, vendin e fundit për ta veshur ihramin ta kenë pikërisht këtë vend.

c) Jelmelem: është një kodrinë që shtrihet në jug të Mekes, vend të cilin Pejgamberi a.s. e caktoi për ta veshur ihramin populli i Jemenit. Jelmelemi është vendtakimi i fundit për të gjithë ata që vijnë nga jugu i Mekes.

d) Kurnul Menazil: është mal në lindje të Mekës dhe vendtakimi i haxhilerëve të Nexhdit si dhe të vendeve të tjera që gjenden në lindje të Mekës dhe pas këtij mali.

Të gjitha këta vendtakime apo mikate duhet të respektohen plotësisht, sepse janë pika të fundit ku mund të vishen ihramet, pa marrë parasysht a vijnë haxhilerët nga toka apo deti. Pejgamberi a.s. pat caktuar që nëpër këta vende duhet kaluar medoemos i veshur në ihram. Sa i përket banorëve të cilët jetojnë brenda kufijve të këtyre vendeve, apo midis Mekes dhe këtyre vendtakimeve, ata duhet të vishen me ihram në vendbanimin ku jetojnë, pra të dalin nga shtëpitë e tyre të veshur me ihram. Po qe se ihrami është për umre, atëherë ju lejohet të dalin me veshje normale përderisa t' i afrohen Mekes. Distanca hapësinore ku



këta njerëz duhet t' i veshin ihramet është gjashtëmbëdhjetë kilometra rreth e përqark Mekës. Në kohërat e hershme arabët nga çdo anë vendosnin shenja të bardha për të bërë me dije se ku është caku apo kufiri i fundit për veshjen e ihramit. Ata që jetonin tej shenjave të bardha ose mes shenjave dhe Mekës, shkarkoheshin nga obligimi i veshjes së ihramit.

## FJALËT TË CILAT NË BRENDINË E TYRE KANË KUPTIM TË MADH

Kur flasim për haxhin, gjatë sqarimit të këtij sharti islam hasim në disa fjalë të cilat në brendinë e tyre kanë kuptim të gjerë. Këto fjalë janë të lidhura ngushtë me ceremonitë e këtij obligimi, si p.sh.: El Ihram, El Ifrad, El Kiran dhe Et Temettu. Rreth këtyre fjalëve do të japim vetëm disa sqarime të shkurtra, sepse gjatë shpjegimeve që do t' i bëjmë për konditat e haxhit për to do të flasim pak më tepër.

### 1. EL IHRAM

Në gjuhën arabe kjo fjalë me pak ndryshime në shqiptim merr kuptime të ndryshme, kështu që nëse themi el hurime, kjo fjalë do të thotë se njeriu vetveten e ka ndaluar prej diçkaje. Ndërkaq, kur të njëjtën fjalë e theksojmë me një theks pak më ndryshe, p.sh. el hurume, kjo fjalë tregon se njeriu veten e ka ndaluar prej diçkaje vetëm për një kohë të caktuar. Edhe fjala IHRAM mund ta ketë kuptimin e ndalesës që i bënë njeriu vetvetes edhe në disa gjëra kur, para se të hyjë në zbatimin e një urdhri apo obligimi, ai e bën nijet apo e vendosë që edhe ato gjëra që i ka të lejuara gjatë jetës së përditshme t' ia ndalojë vetes për një kohë të caktuar. Kjo dukuri shprehet sidomos gjatë kohës së haxhit dhe umres. Në fjalorin më të njohur të gjuhës arabe "El Misbahul Munir" fjala ihram do të thotë kur njeriu derisa hy në haxh dhe umre e ndalon epshin e vet për diçka për ç' gjë më parë e ka pasur të lejuar.

### 2. EL IFRAD, EL

## KIRAN, ET TEMETU:

Për t' ia bërë sa më të qartë lexuesit këto fjalë, është mirë që këtu të flitet në përgjithësi për veprimet që duhet të kryhen gjatë haxhit dhe umres. Në këtë vazhdë të flisim këtu për kushtet e umres të cilat janë: Ihrami, Tavafi rreth Qabes, lëvizja prej Safes në Merve dhe anasjelltas, dhe në fund, qethja e flokëve apo shkrutimi i tyre. Me këto veprime edhe përfundon umreja së bashku me ihramin. Ndërkaq kushtet e haxhit janë: Ihrami, Tavafi rreth Qabes, lëvizja mes dy kodrinave Safes dhe Merves, pastaj për dallim prej umres gjatë haxhit kusht është edhe qëndrimi në Arafat që bëhet në ditën e nëntë të muajit dhulhixhe, pastaj Remj-i apo gjuajtja e guralecëve në vendin e caktuar që quhet Akabe e që gjendet në Mine, ndërsa grumbulli i guralecëve quhet "Xhemretul-a' kabe".

Të kthehemi edhe një herë e të flasim për dallimet që ekzistojnë mes umres dhe haxhit. Në këtë aspekt do të kishim mundur të flasim shkurt e të theksojmë se të gjitha veprimet që kryhen gjatë umres kryhen edhe gjatë haxhit, porse, duhet pasur parasysh se gjatë haxhit kryhen edhe disa veprime më tepër se në umre, siç janë: qëndrimi në Arafat dhe disa veprime tjera që pasojnë pas kësaj. Në anën tjetër, umreja pas tavafit, lëvizjes në mes Safes e Merves dhe qethjes së flokëve, merr fund dhe këtu mbaron edhe mbajtja e ihramit. Ndërkaq, siç theksuam më sipër, gjatë haxhit ihrami zhvishet pasi të kryhen edhe veprimet tjera pas qëndrimit në Arafat. Dhe, pas zhveshjes së ihramit haxhiu e fillon atë jetë të rëndomtë duke ia lejuar vetes ato gjëra që ia kishte ndaluar gjatë kryerjes së haxhit. Gjithashtu, siç kemi theksuar më sipër, një ndër dallimet tjera mes haxhit dhe umres është edhe koha. Umreja mund të bëhet në çdo kohë, madje edhe gjatë kryerjes së haxhit, ndërsa haxhi është i caktuar të kryhet në kohë të caktuar e kurrsesi në ndonjë kohë tjetër. Çka duhet bërë gjatë muajve të haxhit - shevalit, dhul-kades dhe gjatë dhjetë ditëve të para të dhul-hixhes? A është e mundur të kryhet haxhi e mos të bëhet umreja, a mund të kryhen edhe haxhi edhe umreja njëkohësisht?

a) Për ta kryher haxhin duhet

medoemos në vendin e caktuar të vishet ihrami, pastaj të bëhet tavafi, të ecet mes Safes e Merves, të qëndrohet i veshur në ihram deri në ditën e tervies në Mine, të qëndrohet në Arafat, e në fund, pasi të kalohet dita e nahrit duhet bërë tavafin që quhet Tavaful ifade. Vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve të haxhit, ai që dëshiron mund ta kryej edhe umren duke i përsëritur kushtet e parapara për umre. Duhet theksuar se, haxhiu i cili e bën nijet kryerjen vetëm të haxhit, pa umre, quhet mufred.

b) Nga ana tjetër, besimtarët të cilët dëshirojnë që nën një ihram ta kryejnë edhe haxhin edhe umren quhen karin, por në veprimet e mufredit dhe karinit nuk ka kurrfarë dallimesh, përveçse në nijet. Sepse, i pari e bën nijetin vetëm për haxh kurse i dyti edhe për haxhin edhe për umren.

c) Mënyra e tretë e nijetit është ajo që bëhet vetëm për umren, pas kryerjes së të cilës personi që e bënë atë vazhdon jetën e rëndomtë, duke i përdorur gjërat që i kishte të ndaluara gjatë kryerjes së umres. Ky lloj i nijetit quhet et-temettu.

## RREGULLAT E HAXHIT DHE TË UMRES

Rregullat dhe veprimet e caktuara që duhet medoemos bërë gjatë haxhit dhe umres janë:

- El Ihram,
  - Telbie,
  - Tavaf,
  - Sa' ji,
  - Qethja e flokëve,
  - Dalja prej ditës së tervies dhe shkuarja në Mine,
  - Qëndrimi në Arafat,
  - Kthimi në Muzdelife dhe qëndrimi në Mesh' ari Haram,
  - Veprimet që duhet bërë ditën e Nahrit (hudhja e guralecëve në Xhumretul Akabe, prerja e kurbanit, qethja e flokëve apo të rruarit e kokës, Tavaful Ifadatu),
  - Kthimi i fundit në Mine dhe hudhja e guralecëve të mbetur
- Çdonjëri prej personave kur e bënë nijet për veshjen e ihramëve, qoftë për haxh a për umre, është e pëlqyeshme që më parë t' i shkurtojë thonjtë, mustaqet, të rruhen të gjitha vendet të cilat zakonisht rruhen apo pastrohen, pastaj të merret abdest ose të lahet i tërë trupi,

dhe në fund, trupi të mbështillet me dy çarçafët e bardhe e të pastër, me ç' rast, me njëren mbulohet pjesa e poshtme e trupit e me tjetrën pjesa e sipërme dhe, me këtë rast, e pëlqyeshme është që sipas mundësive trupi të parfymoset me erëra të mira e të këndshme. Çarçafët të cilat vishen për haxh apo umre quhen IHRAM, ndërsa kjo, do të thotë të bërit nijet apo vendosje për ta bërë haxhin apo umren. Sa i përket çarçafëve, ata mund të jenë të përdorur, por të pastër dhe të ngjyrave të ndryshme, por do të ishte shumë më mirë po të ishin të ri dhe të bardhë. Pas kësaj haxhiu duhet t' i falë dy reqate namaz, e nëse është mufred, pas faljes së namazit duhet të thotë: Allahume inni uridul-haxhxhe fe jessirhu li ve tekabbelhu minni - që në përkthim do të thotë: O Zot, vendosa që ta bëj haxhin, ma lehtëso këtë dhe pranoje prej meje. Ndërsa ai që ka për qëllim që ta bëjë së bashku edhe haxhin edhe umren, gjatë këtij nijeti i shton edhe këto fjalë "vel umrete fe jessirhuma li ve tekabbelhuma minni", dhe, këto fjalë vijnë pas fjalës "uridul-haxhxhe", që do të thotë: O Zot, vendosa që ta bëj edhe haxhin edhe umren, m' i lehtëso dhe m' i prano ato prej meje. Nijeti mund të bëhet edhe në gjuhën amtare, porse këtu me rëndësi është që ai nijet apo qëllim të shprehet pastër, qartë dhe nga thellësia e shpirtit. Posa ta thotë personi telbijen dhe ta bëjë nijetin për haxh ose për umre, konsiderohet se e ka kryer aktin e ihramit dhe është bërë muhram. Pas këtij akti ai duhet të ketë kujdes të posaçëm dhe t' u shmanget marrëdhënieve seksuale, kontakteve intime bashkëshortore, nuk lejohet as të përmendurit e marrëdhënieve seksuale në prani të femrës, duhet të kihet kujdes në mospërdormin e fjalëve të ndyta, t' u shmanget veprave të shëmtuara, grindjeve dhe llomotitjeve, pastaj nuk guxohet të mbyten gjallesat në tokë e as të këshillohet tjetri madje as me shenjë për gjah, duhet të kihet kujdes që të mos mbyten as insektet, të mos parfymoset me livandë e erëra të ndryshme, të ketë kujdes nga të pririt e thonjve, të rruarit dhe nënqethja e flokëve dhe të pjesëve të tjera të trupit. Po ashtu, muhrami nuk guxon ta nënqethë mjekrën, ta mbulojë kokën apo fytyrën, nuk guxon t' i lajë mjekrën apo kokën me sapun që ka aromë të

mirë e të fortë, por vetëm mund të përdorë ndonjë sapun që ka aromë të rëndomtë. Gjithashtu, ai nuk guxon të veshë këmbë dhe as brekë, pallto të gjatë, xhybe, qyrk, herkë, nuk guxon ta veshë sarëkun në kokë e as kapelën, nuk guxon të mbathë meste apo çorape. Pra, muhrimi duhet t'ia ndalojë vetes çdo petk të prerë ose të qepur që shërben për veshjen dhe mbathjen e trupit të njeriut, me përjashtim të nalleve apo papuçeve të cilat lejohen. Nuk duhet të përdoren çarçafë apo ihrame që janë të ngjyrosura e të parfymosura era e të cilave nuk hiqet por ndihet vazhdimisht. Ndërkaq, femra është më e lirë dhe mund ta mbulojë kokën e t'ia mbathë mestet edhe çorapet, mund të veshë rrobe të qepura. Është karakteristike në këtë rast të theksohet se, femrat të cilat gjatë menstruacioneve nuk e kanë të lejuar të falin namazin e as të agjërojnë, në haxh i lejohen këto veprime. Ajo duhet të pastrohet dhe të fillojë t'ia zbatojë të gjitha rregullat e haxhit, me përjashtim të tavafit rreth Qabes, të cilin duhet ta bëjë në fund të haxhit. Muhrimi mund të lahet në banjo ose gjetiu, të përdorë ombrellën (çadrën) ose në ndonjë mënyrë tjetër të mbrohet nga dielli, ka të drejtë ta lidhë qemerin rreth vete, të hyjë në luftë kundër armikut ose kundër atij që sulmon i pari. Pejgamberi a.s. ka dhënë leje që në rastet kur muhrimi i kanoset rreziku nga ndonjë shtazë e egër, siç është luani, tigri, ujku, akrepi etj., ai mund ta mbysë atë në vetëmbrojtje. Përveç këtyre ndalesave, nga muhrimi kërkohet që pas namazit të shqiptojë shumë telbije, t'ia thotë ato kur ngjitet mbi majën e ndonjë bregu apo kur zbret në luginë, kur të takohet me grupe kalorësish apo këmbësorësh, dhe përherë para agimit. Telbijet mund të shqiptohen edhe në autobusë e aeroplanë.

## **PËRMBAJTJA E TELBIJES ËSHTË KJO:**

**LEBEJKELL-LLAHUME LEBBEJK. LEBBEJKE LA SHERIKE LEKE LEBBEJK. INNEL-HAMDE, VENNI'AMETE VEL-MULKE LEKE. LA SHERIKE LEKE!** - që në përkthim do të thotë: "Të përgjigjem o Zot. Të përgjigjem, të përgjigjem. Ti nuk ke shok. Të përgjigjem. Ty të takon çdo lavdërim, mirësi dhe pushtet, në këtë Ti nuk ke shok."

Në këtë mënyrë ka vepruar edhe Pejgamberi a.s., i cili ka thënë: "Më erdhi Xhibrili dhe më tha: "Thuaju shokëve tu që ta ngrisin zërin me telbije, se ajo është pjesë e rregullave të haxhit." Të potencojmë këtu se telbija thuhet prej momentit kur të vishet ihrami e deri sa të hyhet në Mesxhidul-Haram. Kur muhrimi hy në Meke, pas vendosjes së plaçkave që i ka me vete, duhet të shkojë në Mesxhidul-Haram, dhe sapo ta vërejë El-Bejtul-Haramin, duhet ta thotë tekbinin (Allahu Ekber) dhe tehlilin (La ilahe ilall-illah), edhe atë nga tri herë, e po ashtu, duhet të thotë ALL-LLAHUME ENTES-SELAM, VE MINKES-SELAM, FEHAJNA RABENA BIS-SELAM. Tavafin e nis nga Haxherul Esfedi dhe pasi të drejtohet nga ai e thotë tekbinin dhe tehlilin, i ngritë duart lartë sikur kur hy në namaz, e pastaj në shenjë respekti e puth Haxherul Esvedin, nëse mund t'ia afrohet pa vështirësi, e nëse nuk mundet, vetëm do ta prek me shuplakë të dorës (istilam), ose me ndonjë send tjetër të cilën pastaj, në shenjë respekti, duhet ta puthë, ngase atë e ka prekur edhe vetë Pejgamberi a.s. Mirëpo, nëse ndodhë që të mos i afrohet fare Haxherul Esvedit, atëherë vetëm i ngremë duart lartë në drejtim të tij dhe kështu përfundon kjo shenjë respekti. Gjatë tërësorisë kësaj thuhet tekbinet dhe tehlilet, i drejtohen falënderime Allahut të Madhërishëm dhe bashkë me këtë bien edhe salavatet mbi Pejgamberin a.s. Pas këtij akti fillon tavafi, të cilin duhet nisur në të djathtë kah dera (multezem), në atë mënyrë që Qabja të mbetet në anën e majtë, duke e mbajtur ihramin e sipërm nën sjetullën e djathtë dhe duke i hedhur skajet e tij në krahun e majtë. Haxhiu duhet të sillet rreth Qabes shtatë herë, duke pasur kujdes që, gjatë tri tavafeve të para të shpejtohet me hapa të shkurtër duke i luhatur nga pak krahët (reml), kurse gjatë katër tavafeve të fundit duhet ecur qetë. Gjatë kësaj, sa herë që të kalojmë pranë Haxherul Esvedit duhet përsëndetur atë (duhet bërë istilamin) dhe kështu përfundon tavafi. Këtu duhet theksuar se, istilami preferohet edhe sa herë të kalohet pranë El-Ruknul Jemanisë.

Pas kësaj haxhiu duhet t'ia falë dy reqate namaz pranë Mekami Ibrahimit, ose kudo

qoftë tjetër në Mesxhidul Haram dhe, këto dy reqate janë vaxhib që falen pas çdo tavafi, pra, pas shtatë qarqeve që bëhen rreth e rrotull Qabes. Ky është i ashtuquajti Tavaful Kudum, i cili është sunet për çdo haxhi përveç se për banorët e Mekës. Pas këtij veprimi haxhiu duhet të kthehet kah Haxherul Esvedi, dhe pasi ta bëjë istilahin e të pijë ujë nga burimi i Zemzemit, shkon në Safa, ngjitet lartë sa ta shohë Bejtullahun dhe kthehet drejt tij duke kënduar tekbinet, tehlile dhe salavate për Pejgamberin a.s. Më në fund duhet bërë dua duke kërkuar nga Allahu çdo gjë që do. Pas kësaj duhet të nisesh drejt Merves duke ecur ngadalë deri te vendi ku ndodhen shenjat prej ku ecja bëhet me hapa më të shpejta (sai). Kur arrihet në Merve vepron ngjashëm sikur edhe në Safa. Me kaq është kryer vetëm një ecje (shevt). Pra, edhe këtu duhet të kryhen shtatë shevte, duke filluar që nga Safa e deri në Merve. (Nga Safa deri në Merve llogaritet një ecje apo shevt, dhe nga Merva e deri te Safa llogaritet ecja tjetër). Pas kësaj, haxhiu do të qëndrojë në Meke si muhrim, tavafet rreth Bejtullahut mund t'ia bëjë sa herë që të dëshirojë si nafilë. Në ditën e shtatë të Dhul-hixhes imami do të mbajë hutbe në Bejtullah, me ç'rast besimtarët i udhëzon për rregullat e haxhit. Po kështu, imami do të veprojë edhe në ditën kur do të qëndrohet në Arafat. Në këtë ditë e në këtë vend imami do t'ia mbajë dy hutbe si me rastin e xhumasë, dhe me atë rast do t'ia udhëzojë haxhilerët mbi rregullat pasuese të haxhit (mbi qëndrimin në Arafat, në Muzdelife, mbi gjuajtjen e guralecëve në Xhemre, mbi therrjen e kurbanëve, të rruhen dhe tavafuz-zijaretin). Pas hutbes imami bashkë me xhematin do të falë namazin e drekës dhe të ikindisë me një ezan dhe dy ikamete. Pas kësaj fillon vukufi. Ai mund të bëhet hipur në kalë apo në deve, ose duke qëndruar më këmbë gjë që është më e preferueshme, duhet të merret abdes apo të lahet i tërë trupi, sepse kjo është sunet, në afërsi të bregut i cili quhet Xhebelul-rahmeti. Arafati është në përgjithësi vend ku mund të bëhet vukufi, porse duhet pasur kujdes se, në të majtë Arafatit, nga vendi ku bëhet vukufi gjendet një terren që quhet Batnu Ureme e në të cilin

kurrsesi vukufi nuk lejohet të bëhet. Me rastin e vukufit, imami kthehet drejt kibles me krahë të hapur e të ngritur lartë, i falënderohet Allahut Fuqiptotë duke i kënduar tekbinet, tehlile dhe salavate Pejgamberit a.s., me ç'rast i lutet Zotit xh.sh. t'ia ua plotësojë nevojat dhe dëshirat të gjithë myslimanëve, kurse xhemati qëndron pranë tij i drejtuar në drejtim të kibles dhe përcjell fjalët që i thotë ai. Pas përfundimit të diellit, të gjithë haxhilerët kthehen bashkërisht me imamin në Muzdelife ku do të qëndrojnë në afërsi të bregut Kuze ku falet namazi i akshamit dhe i jacisë bashkërisht me një ezan dhe dy ikamete. Në Muzdelife kalohet nata. Sapo të fillojë agimi falet namazi i sabahut e pastaj bëhet vukufi. Imami vendoset në Mesh'ari Haram dhe bashkë me të gjithë haxhilerët vepron sikurse në Arafat, pra, thuhet tekbinet, tehlilet, thuhet, salavatet dhe duaja. Përndryshe Muzdelife është në tërësi vendi ku bëhet vukufi, përveç luginës Vadi Muhasir, që gjendet në të majtë të Muzdelifes. Me të zbardhur të dritës haxhilerët fillojnë rrugën për në Mine ku imami fillon t'ia gjuajë nga shtatë guralecë në Xhemretul-Akabe, të cilët paraprakisht janë mbledhur në Muzdelife edhe atë në madhësi të një lejthie. Me rastin e gjuajtjes së çdo guraleci thuhet tekbinet. Largësia e gjuajtjes nuk duhet të jetë më shumë se tre deri pesë metra. Përndryshe, para hedhjes guraleci vendoset në majën e gishtit të madh dhe atij tregues dhe gjuhet. Kur fillon gjuajtja e guralecëve ndërpritet telbija. Duhet thënë se, në Xhemretul Akabe nuk është i domosdoshëm qëndrimi dhe haxhiu mund të ecë kur të dojë dhe kah të dojë. Pas hedhjes së guralecëve në Xhemretul Akabe, nëse nijeti është bërë për haxhi kiran, ose, nëse është muttemett, në këtë rast duhet të theret kurbanin, e nëse është mufrid kurbanin mund ta therë nëse dëshiron. Pas therjes së kurbanit haxhiu mund të rruhet ose të qethet dhe tani e tutje lirohet prej ndalesave, por akoma nuk ka të drejtë të bëjë marrëdhënie seksuale. Po atë ditë, të nesërmen, ose të pasnesërmen haxhiu shkon në Meke që ta bëjë tavafuz-zijaretin, pa reml dhe pa sa'j, me ç'rast haxhiut i hiqet edhe ndalesa e fundit, pra është i lirë

që të bëjë marrëdhënie seksuale me bashkëshorten. Koha e tavafuz-zijaretit fillon prej dites së parë të Bajramit dhe është mirë që të bëhet po atë ditë. Është mekruh të shtyhet pas ditëve të Bajramit, edhe pse vlen kurdo që të bëhet. Pastaj haxhiu prej Mekes kthehet në Mine dhe, në ditën e dytë të Bajramit, pas dreke, i hedh sërish shtatë guralecët në Xhemret. Me këtë rast duhet filluar nga Xhemreja e cila vjen e para me radhë prej xhamisë që quhet Mesxhidul Haif, dhe gjatë hedhjes së guralecëve duhet shqiptuar tekbinin, e pas hedhjes së çdo guraleci haxhiu qëndron para Xhemres dhe e thotë një dua. Është mustehab që me atë rast të kërkojë nga Allahu xh.sh. falje për vetveten, për prindërit e vet, për farefisin, për miqtë dhe për të gjithë besimtarët myslimanë. Pastaj shkon edhe te dy Xhemret tjera dhe vepron njësoj si në të parën (pra hedhë nga shtatë gurë), me përjashtim se në atë të fundit, pra në Xhemretul Akabe nuk ka nevojë të qëndrojë. Edhe në ditën e tretë të hudhjes së guralecëve vepron po ashtu si në dy ditët e para, dhe pastaj haxhiu nëse dëshiron mund të kthehet në Meke por mund të mbetet edhe në Mine ku edhe gjatë ditës së katërt mund t' i gjuajë gurët si gjatë ditëve të mëparshme. Haxhiu me rastin e kthimit prej Mines në Meke do të pushojë pak në vendin e quajtur El Muhassabe. Haxhiu para se të largohet prej Mekes duhet ta bëjë Tavafis-sadri që quhet edhe Tavaful-veda (Tavafi lamtumirës). Ky tavaf bëhet pa remj dhe pa sa' j dhe është vaxhib për të gjithë haxhinjtë, pos për mekasit. Pastaj haxhiu i afrohet Zemzemit ku do të pijë ujë. Nëse do të ketë mundësi, haxhiu pastaj do të afrohet te dera e Qabes dhe do ta puthë atë dhe derën e saj (në shenjë nderimi), do të mbështetet me faqen e djathtë, me gjoks e me bark për El multezeme, pra për murin e Qabes ne mes të Haxherul Esvedit dhe të derës së saj, pastaj për një çast kapet për mbulesën e Qabes (El istar), dhe, me zemër të penduar i lutet Allahut Fuqiplotë për atë çka dëshiron dhe, më në fund, kthehet duke ecur mbrapa (në shenjë respekti) deri sa të dalë nga Mesxhidul Haremi (Qabja). Duhet theksuar këtu se, ai që së paku për një moment zbret në Arafat ose vetëm kalon andej

prej drekës së Jevmu-Arefes (ditën e nëntë të dhul-hixhes) e deri në agimin e Jevmun-Nehras (ditën e dhjetë), ai haxhi e ka kryer haxhin, madje nëse këtë e bënë rastësisht apo i alivanosur, madje edhe sikur të mos e dijë fare se gjendet në Arafat. Ndërkaq, personi i cili në Arafat nuk qëndron aq sa theksuam më sipër, nuk e ka të kryer haxhin, porse megjithatë do ta bëjë tavafin, sa' jin dhe do ta përfundojë ihramin, pra do të lirohet prej të gjitha ndalesave me kusht që vitin e ardhshëm sërish ta bëjë haxhin kada. Pasi nuk e ka plotësuar haxhin personi i tillë nuk është i obliguar që të therë kurban. Të potencojmë këtu se, gjatë qëndrimit në Arafat është shumë mirë të thuhet lutja, të cilën edhe vetë Pejgamberi a.s. e thoshte gjatë qëndrimit në këtë vend: LA ILAHE ILALL-LLAHU VEHDEHU LA SHERIKE LEH LEHUL-MULKU VE LEHUL HAMDU, BIJEDIHIL-HAJRU, VE HUVE ALA KULI SHEJ' IN K A D H R . Të flasim diç edhe për femrën që merr udhë për në haxh. Edhe gruaja duhet t' i zbatojë të gjitha rregullat dhe ceremonitë që ndërlidhen për haxhin, njëjtë sikurse mashkulli, me përjashtim se gruaja duhet t' u përmbahen edhe këtyre rregullave:

- nuk duhet që ta mbajë kokën të zbuluar, ka të drejtë ta bartë vellon, porse velloja nuk guxon t' ia prekë fytyrën,

- nuk e shqipton me zë telbijen,

- nuk vrapon në mes shenjave të theksuara që gjenden mes Safas dhe Merves,

- nuk e rruan kokën, porse i shkurton flokët pak,

- duhet të veshë rrobe të qepura,


- nuk i afrohet Haxherul Esvedit, kur pranë tij gjenden meshkujt,

- nëse i paraqitet hajzi (menstruacionet) duke qenë në ihram, lahet dhe i kryen të gjitha veprimet dhe rregullat e haxhit, përveç tavafit.

- nëse hajzi i paraqitet pasi ta kryejë Tavafiz-zijaren, Tavafu-sadri nuk i mbetet borxh dhe nuk ka nevojë për shpagim (kurban).

Tavafi-sadri nuk i mbetet borxh as atij që vendosë për të mbetur në Meke.

Ndërkaq ai që vendosë të therë ndonjë kafshë të trashë (deve a lopë) me qëllim për t' u



shpague për thyerjen e ndonjë rregulle të haxhit, me këtë ai konsiderohet se e ka kryer obligimin si duhet.

## VIZITA E XHAMISË SË PEJGAMBERIT A.S.

Pejgamberi a.s ka thënë: "Nuk është forcuar vizita (haxhi apo umreja) përderisa nuk vizitohen tri xhamitë: Mesxhidul Harami, Mesxhidi, apo xhamia ime dhe, Mesxhidul Aksa." Deri këtu theksuam se si të gjitha rregullat dhe ceremonitë e haxhit janë të përqendruara rreth Qabes-Mesxhidul Haremit, porse nga hadithi i Pejgamberit nënkuptojmë se në përforcim të haxhit bënë pjesë edhe vizita e xhamisë së Pejgamberit a.s. që gjendet në Medinetu-munevere. Hyrja dhe të vizituarit e kësaj Shtëpie të Zotit të Madhërisëm mund të bëhet gjatë kalimit pranë saj, gjë që kjo vizitë mund të ndikojë në pastrimin shpirtëror të muslimanit, i cili kur e viziton këtë xhami e përkujton udhëzimin dhe moralin e lartë të Pejgamberit a.s., historinë e tij të ndritshme, e cila është e mbushur përplot rreze udhëzimi për atë se si duhet të organizohet shoqëria myslimane për të ecur në rrugë të drejtë, në rrugën e mbarë, në rrugën e islamit. Gjithashtu, është një moment i veçantë i kënaqësisë kur ke parasysh se po shkel në po atë tokë ku ka shkelur fytyra më e ndritshme e mbarë njerëzimit - Muhamed Mustafaja a.s. Ata që e vizitojnë këtë xhami është mirë që kur të arrijnë në vendin e quajtur Err-rrevda sherife (vendi ku është falur Pejgamberi a.s. dhe ku gjendet varri i tij) dhe përderisa kalon pranë varrit të ndritshëm të Pejgamberit a.s., t' i japë selam atij me zë të ulët duke thënë "Es-selamu alejke ja Resul-Allah. Eshhedu en la ilahe il-lallah, ve eshhedu in-neke abduhu ve resuluhu", që d.m.th: Paqa qoftë mbi ty o i Dërguari i Allahut, dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je rob dhe i dërguar i Tij. Po ashtu, është mirë që të merret një qëndrim paksa në të djathtë dhe t' i jepet selam edhe Ebu Bekrit dhe Ymerit r.a. të cilët që të dy janë të varrosur pranë varrit të Pejgamberit a.s. Të theksojmë se gjatë qëndrimit në Medinen është mirë që namazet të falen në rrevdai sherif.

**Riaseti i BFI në R.M**

# QABEJA, Shtëpia e shenjtë - vështrim historik

Nga Mr. Sc. Fahrudin Ebibi

## KUPTIMI I TERMIT "EL-QA'BETU" DHE "EL-ATIK"

Qabja është në mes të xhamisë së Shenjtë në Mekë. "Qa'be" do të thotë katror. Është quajtur kështu për faktin se konstrukti i saj është në formë katrori. Ndërkaq është quajtur "el-Atik" - e lashtë sepse ajo është ndërtesë e lashtë dhe shumë e hershme. I Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ka thënë: "Ajo (Qabja) është quajtur shtëpi e lirë "el-Bejt el-Atik" për faktin se asaj nuk iu është shfaqur asnjë tiran".

## VLERA E MEKËS

Nga aspekti fetar Meka është vend i shenjtë, është vend më i dashur i Allahut dhe i Dërguarit të Tij. Meka është kibleja e myslimanëve, respektivisht, është drejtimi që i drejtohen muslimanët gjatë lutjeve (namazeve të tyre dhe është vendi në të cilin myslimanët e bëjnë haxhin. Në këtë qytet të bekuar Allahu fuqiplotë caktoi të jetë Shtëpia e Shenjtë - Qabja. Për atë se Qabja gjendet aty Allahu i madhërishtëm bëri që shpërblimi i çdo veprë të jetë më i madh se në çdo vend tjetër të rruzullit tokësorë. Një namaz në Mekë Allahu xh.sh. e shpërblen me njëqindmijë namaze në vende të tjera. **"Kush hyn në të është i sigurt"**. Me rastin kur Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem, ishte detyruar ta lëshoj Mekën, ka thënë: "Po betohem në Allahun se ti je toka më e dobishme, më e mirë e Allahut, tokë më e dashur e Tij, mirëpo, jam i detyruar të dal nga ti, ngase kurrë nuk do të kisha dal".

## KUFINJTË E HAREMIT

Ibrahimi alejhis-selam është i pari i cili i ka venduar kufijtë e Haremit, kuptohet me udhëzimin e Xhebrailit alejhis-selam. Shenjat, përkatësisht,

**“***Qabja është ndërtuar disa herë por pesë ndërtimet e saj shekullore janë më të njohura. Për herë të parë Qaben e kanë ndërtuar engjëjt (melaiket), herën e dytë e ka ndërtuar Ademi alejhis-selam. Sa i përket ndërtimit të tretë të Qabes e ka bërë Ibrahimi alejhis-selam. Në periudhën paraislame kurejshët e kanë bërë ndërtimin e katërt të shtëpisë së Shenjtë. Në këtë ndërtim në moshë 25 vjeçare ka marrë pjesë edhe Muhamedi alejhis-selam. Ndërtimi i pestë i shtëpisë së bekuar ka ndodhur në kohën e Abdullah b. Zubejrit”.*



gurët që tregonin kufijtë e Haremit nuk kishin lëvizur deri në kohën e Muhamedit sal-lall-llahu alejhi vesel-lem. Vitin kur bëhet çlirimi i Mekës, i Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem urdhëroi Temim b. Esed el-Huzaiun që të bëjë renovimin e tyre. Më pas edhe Omeri r.a. i kishte ngarkuar me punë katër persona nga kurejshët që të bëjnë renovimin e atyre shenjave, respektivisht, të atyre gurëve kufitar. Në rrugët kryesore që shpiejnë për në Mekë ka shenja që tregojnë kufijtë e Mekës. Në rrugën e Xhiddes, nga perëndimi, kufiri i Haremit është te vendi i quajtur "Esh-shemis" – el-Hudejbije, 22 km larg Mekës. Në anën jugore në rrugën e Jemenit që vjen nga Tihame-ja kufiri është te vendi "Idaetu Libn" 12 km larg Mekës. Në anën lindore kufiri është te bregu i luginës "Urnetul Garbije" 15 km larg Mekës. Rruga për në Xhi'rane afër fshatit "Sheraiul Muxhahidin" është kufiri në verilindje 6 km larg Mekës. Në veri kufiri i Haremit është vendi i quajtur "Et-ten'im" 6 km larg Mekës.

## EMRAT E MEKËS

Qyteti i shenjtë - Meka ka afërsisht pesëdhjetë emra. Në Kur'anin famëlartë Meka është përmendur me pesë emra. Është përmendur me emrin Meke, Beke, el-Beled, el-Karje dhe Ummel Kura. **"Dhe ai është që pengoi duart e tyre prej jush dhe duart tuaja prej tyre brenda në Mekë"**. **"Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë, e dobishme udhërrëfyese për mbarë njerëzimin"**. **"Allahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë"**. **"Betohem në këtë qytet"**. **"Që t'i tërheqësh vërejtjen nënës së fshatrave (të banorëve mekës)..."**. Meka ka edhe emra të tjerë siç është: En-esase, el-Hatime, el-Harem, Salah, el-Base, Muadh, Er-r's, Beledul Emin etj.

## NDËRTIMI I QABES

Qabja është ndërtuar disa herë por pesë ndërtimet e saj shekullore janë më të njohura. Për herë të parë Qaben e kanë ndërtuar engjëjt (melaket), herën e dytë e ka ndërtuar Ademi alejhis-selam. Sa i përket ndërtimit të tretë të Qabes e ka bërë Ibrahim alejhis-selam. Në periudhën paraislame kurejshët e kanë bërë ndërtimin e katërt të shtëpisë së Shenjtë. Në këtë ndërtim në moshë 25 vjeçare ka marrë pjesë edhe Muhamedi alejhis-selam. Ndërtimi i pestë i shtëpisë së bekuar ka ndodhur në kohën e Abdullah b. Zubejrit.

## NDËRTIMI QABES NË PERIUDHËN E IBRAHIMIT ALEJHIS-SELAM

Me rastin kur Haxhereja e kishte lindur Ismailin alejhis-selam, Sara (bashkëshortja e parë e Ibrahimit alejhis-sela) filloi t'ia ketë zili asaj dhe kishte kërkuar nga Ibrahim ta largoj Haxheren gjetiu. Ibrahim alejhis-selam ishte inspiruar nga Allahu që familjen e tij ta dërgoj në Mekë. Kohë pas kohe Ibrahim e vizitonte familjen (Haxheren dhe Ismailin) dhe gjatë një vizite i tha Ismailit, Allahu xh.sh. më ka obliguar me një punë. Vepro ashtu siç të ka urdhëruar Allahu o prindi im. A do të më ndihmosh pyeti Ibrahim? Po u përgjigj ai. Ibrahim alejhis-selam filloi ndërtimin e Qabes, përkatësisht, filloi t'i vazhdoj themelet ekzistuese të saj. Ndërtimin e tretë të Qabes e ka theksuar edhe Kur'ani famëlart. Në Kur'an theksohet: "Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabes - luteshin): "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!". Derisa thuhet: "Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëz...", e njerëz pati edhe para Ibrahimit, atëherë ky vetëm i ka vazhduar themelet e saj.

## NDËRTIMI I QABES NË KOHËN E KUREJSHITE NË PERIUDHËN PARAISLAME

Pak kohë para se të shpallej Muhamedi alejhis-selam për pejgamber, Qabeja ishte e ndërtuar me gurë, mirëpo nuk ishte e lyer. Lartësia e saj ishte pak mbi një trup (shtat) njeriu. Disa e kishin plaçkitur thesarin e Qabes, në një pus, i cili gjendej brenda saj si rezultat i kësaj kurejshët, vendosën rrënimin e Qabes për të bërë ndërtimin e saj me material tjetër. Në atë kohë ishte fundosur në det, një anie e një tregëtar romak, kurejshët shfrytëzuan rastin duke bërë nxjerrjen e drunjve, të dërrasave dhe Qabes i ndërtuan

çati - tavan. Fillimisht njerëzit frikësoheshin të bënin rrënimin e Qabes por pasi që el-Velid b. el-Mugire filloi i pari të bëj rrënimin e saj dhe pasi që atë nuk e gjeti asgjë atëherë filluan edhe njerëzit e tjerë të bëjnë rrënimin e saj. Familjet kurejshite grumbullonin gurë dhe ndërtuan Qaben por lindi konflikti sepse me rastin e rrënimin të Qabes ishte nxjerr nga vendi guri i zi (haxheru-l-esvedi) kështu që secila familje dëshironte që anëtar i saj të bëj kthimin e gurit të zi në vendin e vetë. Kjo çështje arriti lartë sa që u shkaktua konflikt ndër fisnor. Pas katër ose pesë netë debati më i moshuari nga ata Ebu Umejje Ibn el-Mugire b. Mahzumi propozoi që i pari i cili do të futet nga kjo derë të jetë gjykatës në zgjedhjen e këtij problemi. Nga ajo derë i pari hyri Muhamedi alejhis-selam dhe kur e panë thanë ky është besnik dhe ne pajtohemi me të. Muhamedi alejhis-selam kishte kërkuar një pëlhurë ose një rrobë dhe me duart e tij të bekuara e kishte marrë gurin e zi e kishte venduar në atë pëlhurë dhe kërkoj nga një anëtarë të çdo fisi të kapë nga një skaj të asaj pëlhure dhe kur arriti guri te vendi i duhur me dorën e vetë Muhamedi alejhis-selam e vendoi në vendin e vetë.

## NDËRTIMI I QABES NË PERIUDHËN E ABDULLAH B. ZUBEJRIT

Abdullah b. Zubejri nuk e kishte njohur Jezid b. Muavie për halif, ky i fundit e kishte drejtuar ushtrinë që ta nënshtrojnë. Ibn Zubejri ishte strehuar në Qabe dhe gjatë përlëshjeve disa ditëshe, nga zjarri i çadrave që ishin rreth Qabes zjarri e kishte kapluar edhe Qaben. Pasi që ishte djegur mbulesa dhe çatia të cilën ia kishin vënë kurejshët muret e Qabes ishin dëmtuar seriozisht. Kjo ka ndodhur më 13 Rebiulevvel të vitit 64 hixhri. Pasi që ishte larguar ushtria Ibn Zubejri i konsultoi fisnikët dhe shumica prej tyre u pajtua që të rrënohet Qabja megjithëse një numër i madh njerëzish nuk u pajtuan. Në mesin e atyre që nuk ishte pajtuar, ishte Abdullah b. Abbasi. Megjithatë Ibn Zubejri bëri rrënimin e Qabes dhe e ndërtoj në bazë të themeleve të kohës së Ibrahimit nga fakti se kurejshët me rastin e rindërtimit të saj e kishin lënë mangu. Ibn Zubejri e futi hixhri në Qabe gjë që kurejshët e kishin lënë jashtë saj dhe Qabes i kishte lënë dy dyer në lindje dhe në perëndim.

## TENTIMI PËR TË RRËNUAR QABEN

Mekasit nuk ishin në gjendje të mbronin Qaben nga Ebreheja dhe ushtria e tij me elefantë. Atëherë erdhi në shprehje fuqi

absolute e Allahut të madhërishtëm. Allahu i Madhërishtëm dërgoi shpend me ngjyrë të zezë nga deti për të mbrojtur Qaben ashtu që çdo shpez me vete i bartte nga tri guralecë. Këta shpend e shpartalluan ushtrinë e madhe të Ebrehes. Ebreheja u kthye në Sanea i leckosur, si zog pule dhe atje vdiq. Pasi që Allahu e shpëtoi shtëpinë e shenjtë - Qaben Abdulmutalibit iu ngrit rajtingu ndër arab për mençurinë që kishte treguar ndaj Ebrehes. Ndërkohë kurejshët fituan epitetin "populli i Allahut" Allahu luftoi në vend të tyre dhe Ebrehen dhe ushtrinë e tij e shpartalloi. Kur'ani famëlartë e ka treguar këtë rrëfim në kaptinën el-Filë. Ebreheja desh të bëj rrënimin e Shtëpisë së Allahut-Qabes për shkak se ai kishte ndërtuar një kishë të madhe në Jemen. Atë kishë e kishte quajtur "el-Kul-lejs" duke dëshiruar me këtë të bëj joshjen dhe tërheqjen e vizituesve nga Qabja. Një mekas në shenjë zemërimi e kishte njollosur atë kishë me ndyrësirë dhe kur ishte informuar Ebreheja ishte betuar se do të bëj shkatërrimin e Qabes. Ebrehe kishte urdhëruar ushtrinë me elefantë të rrënonin Qaben por elefanti më i madh i tyre ulej në tokë dhe nuk ecte në drejtim të Qabes. Elefanti maltretohej fizikisht por megjithatë nuk ecte në drejtim të Qabes ndërkaq në drejtime të tjera ecte me vullnet dhe lirshëm.

## ZGJERIMI I HAREMIT TË MEKËS

Njerëzit vinin duke u shtuar dhe interesimi për të vizituar Qaben gjithashtu ishte në rritje e sipër ishte nevojë permanente zgjerimi i Haremit të Mekës që të mund t'i përballoj fluksit të madh të haxhinjëve. Një nevojë e këtillë ishte në periudhën e hulefai rashidinëve, përkatësisht, në kohën e sundimit të Omerit r.a. Deri në këtë kohë Haremi i Mekës - Qabja nuk ishte e rrethuar me murë do të thotë vendi ishte i hapur. Afër Qabes kishte shtëpi të mekasve. Omeri i kishte paguar pronat e mekasve rreth Qabes dhe kishte bërë shembjen e tyre për të zgjeruar Haremin, pastaj e rrethoj Qaben me një murë jo të ngritur shumë nga toka. Më pas shtimi i vizituesve të Shtëpisë së Allahut kishte shkaktuar që edhe në kohën e sundimit të Othmanit r.a. të bëhet zgjerimi i Haremit të Mekës. Kjo ka ndodhur më vitin 26 pas hixhretit. Më vonë ka bërë zgjerimin e Xhamisë së Qabes edhe Abdullah b. Zubejri nga ana lindore që është lartë dhe që e pason atë këndi "Esh-shami". Gjithashtu është zgjeruar xhamia e Qabes edhe nga këndi "el-Jemani". Më pas Mesxhidi Haramin e ka zgjeruar Ebu Xha'fer el-Mensuri, halifi i dytë

i dinastisë abasite. Në kohën e tij është zgjeruar Haremi nga ana e njohur si këndi "Esh-shamij" dhe nga ana perëndimore. Ky zgjerim ka filluar në muajin Muharrem të vitit 137 h. për të përfunduar në muajin Dhulhixhe të vitit 140 pas hixhretit. Mesxhidi Haramin e ka zgjeruar edhe Mehdiu. Në kohën e këtij halifi zgjerimi i Mesxhidi Haramit bëhet dy herë. Zgjerimi i parë ka qenë më vitin 161 h. ndërkaq zgjerimi i dytë më vitin 167. Mehdiu ka harxhuar mjete materiale të mëdha për zgjerimin e Mesxhidi Haramit. Më vitin 802 h. Mesxhidi Haramin e kishte kapluar zjarri. Kjo ka ndodhur në kohën e sundimit të Sulltan Berkukut. Sulltan Berkuku e kishte ndërtuar Xhaminë e Qabes dhe asaj i kishte vënë çati prej druri ashtu siç ishte më parë. Ashtu që çatia iu ishte ndërruar disa herë për shkak se ajo vjetrohej dhe prishej dhe këtë çështje ia paraqitën më vonë Sulltan Selimit, i cili urdhëroi që xhamisë së Qabes – Mesxhidi Haramit t'i hiqej çatia dhe në vend të saj të ndërtoheshin kupolla. Puna kishte filluar më vitin 979 h. për të përfunduar më vitin 984 h. në kohën e sundimit të Sulltan Muradit III. Prej vitit 1069 në kohën e sundimit të Muktedir Bil-lahut e deri në periudhën e Mbretërisë Saudite, Mesxhidi Harami nuk është zgjeruar. Kjo nuk do të thotë që Mesxhidi Harami në këtë periudhë kohore nuk është meremetuar dhe zbkuruar. Me zhvillimin e teknologjisë, zhvillimi i mjeteve të udhëtimit ka shkaktuar rritjen e numrit të vizituesve (të haxhinjëve) për çdo vit. Plotë dhjetë shekuj Mesxhidi Harami nuk ishte zgjeruar asnjë pëllëmbë. Në kohën bashkëkohore, më saktësisht në periudhën e Mbretërisë Saudite ishte nevojë permanente të bëhej zgjerimi i Mesxhidi Haramit. Në kohën e mbretit Abdulaziz, më vitin 1375 h – 1956 m. bëhet meremetimi i Haremit të Mekës. Në kohën e mbretit Seud b. Abdulaziz bëhet zgjerimi i xhamisë së Qabes nga ana e Sa'jit. Më pas janë rënuar shtëpitë afër Qabes nga ana jugore dhe është bërë zgjerimi. Më vonë është zgjeruar Haremi nga ana veriore dhe perëndimore dhe numëri i dyerve të Haremit të Mekës ka arritur në 51 derë. Në këtë periudhë kohore Xhamisë së Qabes iu janë ngritur shtatë minaret në vend të minareve të vjetra, të cilat ishin rënuar me rastin e zgjerimit. Në këtë kohë për 153.000 m<sup>2</sup> ishte zgjeruar Haremi i Mekës ashtu që sipërfaqja e tërësishme e Haremit kishte arritur në 180.850 m<sup>2</sup>, kjo do të thotë që zgjerimi i Haremit është bërë gjashtëfish më tepër se çka qenë më parë. Në kohën e mbretit Fehd b. Abdulaziz (tani më i ndjeri) projekti i Mesxhidi Haramit punohet në dy drejtime;

në zgjerimin e Mesxhidi Haramit dhe në zbkurimin e tij. Në planin e zgjerimit në këtë kohë bëhet zgjerimi në anën perëndimore prej derës së njohur "Babu melik Abdulaziz" deri te "Babul umre". Kështu që Xhamia ngritet në dy katë dhe i ndërtohet podrumi. Gjithashtu janë ndërtuar edhe tre objekte me shkallë elektrike dhe shtesë tjetër është ndërtuar edhe kati i tretë. Gjithashtu Mesxhidi Haramit iu janë ngritur edhe dy minaret të tjera si ato të mëparshmet. Kështu që sipërfaqja totale e zgjerimit në periudhën saudite ka arritur në 76.000 m<sup>2</sup>. Kështu që zgjerimi i Mesxhidi Haramit në periudhën Saudite (zgjerimi i parë dhe i dytë) ka arritur shtatëfish më shumë se çka qenë më parë. Ky zgjerim ka ngërthyer në vete rreth 40.000 m<sup>2</sup> shtesë.

### HIXHRI

Shumë hadithe tregojnë se Hixhri është pjesë e pandashme e Qabes. Hixhri quhet vendi në të cilin Ibrahim ka bërë stacionimin e familjes së tij (Haxheren dhe Ismailin) me rastin kur ai arriti në Mekë. Në atë vend Haxherja kishte vënë tentën e saj. Kurejshët me rastin e ndërtimit të Qabes në mungesë të mjeteve materiale një pjesë të Qabes e kishin ndërtuar në Hixhër. Ndërkaq me rastin kur Ibni Zubejri ndërtoi Qaben pjesën e Hixhrit të cilën kurejshët e kishin lënë jashtë Qabes ia bashkangjiti asaj por më pas Haxhaxhi e ktheu ashtu siç kishin lënë kurejshët vetëm se ia ndërtoi në formë gjysmë harku dhe sot Hixhri qëndron ashtu prej kohës së tij. Kështu që një pjesë e Hixhrit është bërë pjesë e Qabes kurse pjesa tjetër ka mbetur jashtë saj. Shumë historian kanë theksuar se Ismaili është varrosur te Hixhri, varri i nënës së tij Haxheri por vlen të theksohet se të gjitha këto transmetime janë të dobëta. Dëshira e Ajshe ishte që ajo të fal namaz në Qabe dhe siç theksoj ajo i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi vesellem e kishte marr për dore dhe asaj i kishte thënë: "Falu këtu (te Hixhri) sepse kjo është pjesë e Qabes por populli yt këtë e kanë lënë jashtë me rastin kur e kanë ndërtuar Qaben".

### UJI ZEM-ZEM

Historiku i ujit të Zem-zemit ndërlihet me historikun e Haxheres dhe të foshnjës së saj Ismailin alejhis-selam. Me rastin kur ata i kishte lënë Ibrahim alejhis-selam në këtë vend pa bimë dhe ujë dhe pasi që ishte harxhuar uji të cilin ata e kishin rezervë për

t'ia shuajtur eshtjen foshnjës (Ismailit alejhis-selam) Allahu bëri që uji Zem-zem të dal nga toka. Më vonë gjurmët e këtij uji kanë humbur me kalimin e kohës sa që edhe vendi i tij ishte bërë i panjohur deri në kohën e Abdul Mutalibit të cilit në ëndër iu ishte shfaqur që të bëj rishtazi germimin e pusit Zem-zem. Uji Zem-zem ka shumë emra të tjerë. Zem-zem do të thotë shumë. Për shkak se ai ujë ka qenë sasi shumë është quajtur Zem-zem. Nga emrat e tjerë të ujit Zem-zem veçojmë; "Esh-shebbaa", "Burre", "Tibe", "Bushra", "Avne", "Safije", "Sherabul Ebrar" etj.

### MEKAM IBRAHIMI (VENDI I IBRAHIMIT)

Mekam Ibrahim quhet guri mbi të cilin ka qëndruar Ibrahim me rastin e ndërtimit të Qabes. Kjo gjurmë e lashtë ka mbetur për besimtarët monument historik që ata të përkujtojnë historikun e tij. Në kohën e Ibrahimit ky gur ka qenë i ngjitur për Qabe pastaj Omeri e ka larguar atë deri në vendin ku sot qëndron. Ajsheja r.a.h. tregon se Mekam Ibrahim në kohën e Pejgamberit alejhis-selam, të Ebu Bekrit ka qenë i ngjitur për Qabe përderisa më vonë Omeri r.a. bën largimin e tij nga Qabja për shkak se ai i pengonte vizituesit gjatë tavafit dhe ata që aty e falin namazin.

### MULTEZEMI

Multezem quhet vendi në mes këndit dhe derës së Qabes. Në këtë vend lutja është e pranuar prej anës së Allahut xh.sh.

### KODRA "HIRA"

Në këtë kodër është një shpellë e njohur me emrin "Hira". Vlera e saj historike qëndron në atë se aty për herë të parë Muhamedit alejhis-selam i janë shpallur ajetet e para kur'anore.

### KODRA E NJOHUR "THEVR"

Në këtë kodër është një shpellë në të cilën ishte fshehur i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi vesellem dhe shoku i tij Ebu Bekri me rastin e emigrimit. Pasi që idhujtarët përgatitën likuidimin fizik të Pejgamberit alejhis-selam ai me shokun e tij Ebu Bekrin tri ditë kishin qëndruar të fshehur në këtë shpellë. Këtë shpellë e ka theksuar edhe Kur'ani famëlartë: "Kur që të dy ishin në shpellë..." fjala është për shpellën që gjendet në kodrën "Thevr".



# H A X H I



## Ismet BYTYQI

Shtëpinë e parë të Allahut xh.sh., Qaben e rindërtoi Ibrahim a.s. me të birin e tij Ismailin a.s.

Versioni i cili na përshkruan se si u rindërtua Qabeja, na bënë të mësojmë se Ibrahim a.s. me urdhërin e Allahut xh.sh. shkoi në Egjipt për t'i ftuar njerëzit në Islam. Në këtë udhëtim Ibrahim a.s. u martua me Haxheren, me të cilën Allahu xh.sh. i fali një djalë, Ismailin a.s.

Xhelozia e Sarës, gruas së parë të Ibrahimit a.s., e shtyri Ibrahimin a.s. të dërgoj Haxheren për të jetuar me të birin në shkretëtirë, pikërisht në vendin ku sot gjendet Qabeja e bekuar.

Gjatë qëndrimit të Ibrahimit a.s. në Qabe me gruan dhe djalin e tij, u inspirua nga Allahu xh.sh. ta rindërtojë Qaben me të birin e tij Ismailin a.s.

Rindërtimi i Qabes i mori kohë dhe ishte një punë e lodhshme, derisa Qabeja mori formën katrore të lartë 10 metra.

Me përfundimin e punimeve rreth rindërtimit të Qabes, iu rikthye funksionaliteti dhe roli i saj. Institucion fetar, i ngritur për të përmbushur nevojat shpirtërore, kulturore, edukuese të besimtarëve mysliman. Allahu xh. sh. në Kuran, thotë: **"Nuk është tërë e mira ( e kufizuar ) të ktheni fytyrat tuaj kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve dhe pasurinë që e do, ua jep të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që fal namazin, e jep zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në**

**"Shtëpia ( xhamia ) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë ( Meke ), e dobishme udhërfuese për mbarë njerëzimin."** ( Ali Imran: 96 )

**sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit."** ( el-Bekare: 177 )

Nga ky ajet kuptojmë se: Domethënëse është ekzistimi i Qabes, përderisa gjatë faljes së namazit fytyrat e besimtarëve kthehen kah kibleja (drejtimi kah Qabeja), por kjo nuk është primare. Esenciale është besimi i sinqertë që buron nga shpirti. Shpirti i një besimtari i cili drejtohet pesë herë në ditë kah një pikë e quajtur Qabe, nga e cila ndriçon burimi i fuqisë shpirtërore myslimane. Kurse vizita fizikisht e këtij vendi të bekuar përforcon besimin, por jo vetëm kaq, ajo edhe e rifreskon, e ripërtërinë dhe pastron shpirtin.

Ibrahimi a.s. rindërtoi Qaben që të jetë strofllë dhe shpirtit të devotshëm dhe, që në të, të madhërohet Allahu xh.sh.

Islami na mëson se Qabeja është qendër e besimit Islam. Duke marrë parasysh se Qabeja ekziston qysh prej kohës së Adem a.s., ajo u është nënshtruar rrethanave dhe kushteve kohore, me ç'rast ka pasur dhe aso momente kur Qabeja ka qenë e nënshtruar dëmtimeve të pjesërishme apo të shkatërrimit të saj deri në themele. Bile në historinë islame shënohet se Ebreheja ka pasur tentim për shkatërrimin e Qabes me ushtrinë e saj, ku dhe nuk pati sukses. Meqë qëllimi i temës nuk është ky tregim nuk do të thellohem ma tepër në këtë drejtim. Atë çka dua ta cekim është se me ndërhyrjen e Ibrahimit a.s. me punime ndërtimtare për të ngritur Qaben mbi themelet e saja, u rikthye roli i saj në histori Islame, gjegjësisht Qabeja si faktorë dhe burim i vlerave

etike- morale në kohën e injorancës ajo u shndërrua në qendër të idhujtarisë, në brendësin e saj kishte më tepër se 300 idhujë.

Me ardhjen e Muhamedit a.s., ai gjeti Qaben në këtë gjendje të tmerrshme, dhe si e tillë ishte e pamundshme të madhërohet Allahu xh.sh.

Dëshira e Allahut xh.sh. ishte që Qabeja të pastrohet me ndihmën e Allahut xh.sh., nga faktori njeri, pasi që ata të forcohen në besim dhe në numër. Ashtu dhe ndodhi. Muhamedi a.s. vazhdoi aty ku mbaroi Ibrahim a.s. Misioni i Ibrahimit a.s. ishte rindërtimi i saj, dhe thirrja për në haxh gjatë të qëndruarit të tij në Mekke. Këtë vërtetë Allahu xh.sh. në Kuran: **"Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta."** ( El-Haxh: 27 )

Ibrahimi a.s. gjatë të qëndruarit në Qabe, ashtu siç dhe mësohet nga ajeti, bëri thirrje publike me zë të qartë dhe të lartë për të vizituar Qaben. Ibrahim a.s. kishte detyrë të ftoi në haxh, kurse transmetimi i kësaj thirrjeje në haxh mbeti barë e Islamit. Pikërisht kjo thirrje, u transmetua nga gjenerata në gjeneratë dhe arriti me gjuhën e Kuranit tek gjeneratat tona. Shkuarja në haxh është përgjigje e një besimtari që i bëhet urdhërit të Allahut xh.sh., e dalur nga goja e Ibrahimit a.s. Misioni i Ibrahimit a.s. do të ishte i pakuptimtë, nëse ajo nuk do të vazhdohej nga Muhamedi a.s. si peygamber i fundit. Andaj, dhe lutja e Ibrahimit a.s. ishte në këtë drejtim, ashtu siç dhe na mëson Allahu xh.sh. në Kuran: **"Zoti ynë, dërgo**

**ndër ta, nga gjiu i tyre të dërguar që t'u lexojë aryre ajetet Tua, t'u mësoj atyre librin dhe urtësinë, a t'i pastroi ( prej ndyrësitë së idhujtarisë ) ata. S'ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijsmi."** ( El-Bekare: 129 )

Ibrahimi a.s. gjatë rindërtimit të Qabes luti Allahun xh.sh. ti udhëzon në rrugë të drejtë ata dhe pasardhësit e tyre. U lutën që Allahu xh.sh. të dërgon peygamber për ta udhëhequr popullin. Kur erdh Muhamedi a.s. si peygamber, tha: **"Unë jam fryt i lutjes së Ibrahimit a.s.."**

Muhamedi a.s. e kthen ndriçimin dhe rolin e Qabes duke luftuar në mënyrë ma energjike idhujtarinë dhe, në këtë drejtim arriti sukses duke pastruar Qaben nga putat dhe nga duart e pabesimtarëve.

## ÇKA NDODHI NË VITIN E 9-TË HIXHRIJ?

Në kohën kur Muhamdi a.s. ishte tepër i zënë me pranimin e delegacioneve nga mbarë bota, Muhamdi a.s. dërgoi një grup besimtarësh në krye me Ebu Bekrin r.a., që të nisën për në Mekke. Pasi që dhe dëshira e besimtarëve ishte që të vizitohet Qabeja. Ebu Bekri r.a. u zgjodh udhëheqës i këtij grupi besimtarësh pasi që ishte besnik dhe prej të parëve që pranoi Islamit.

Pas nisjes së Ebu Bekrit r.a. për në Meke nga Medina, Muhamedit a.s. i arriti shpallja nga Allahu xh.sh., një sure komplet me fillim dhe mbarin u shpall nëpërmjet Xhibrilit a.s. Krejt kjo ishte normale pasi që nuk ishte hera e parë, madje shpallja e Kuranit ishte në përfundim e sipër. Mirëpo ajo çka të bënë të mendosh dhe është inspiruese është fakti se: Nëse 113 sure tjera janë të shpallura

me bismilah ( në emër të Allahut xh.sh), kjo sure e cila quhet **BERAE**, në vitin e nëntë hixhri u shpall pa bismilah. Do të ishte ktrejt në rregull përderisa shpallja e kësaj sureje do të fillonte, me bismilah.

Suretë **BERAE** përmban 33 ajete, në të qartë tregohet qëndrimi se koha për të vizituar Qaben në mënyrë organizative, është shumë e afërt, dhe besimtarët do të flasin me gjuhë të rreptë ndaj pabesimtarëve dhe uzurpuesve të Qabes.

Muhamedi a.s. u urdhërua nga Allahu xh.sh. që këto 33 ajete t'u përcillen banorëve të Mekkes, idhujtarëve, personalisht apo nëpërmjet ndonjë anëtari të familjes së ngushtë të Muhamedit a.s.

Muhamedi a.s. vendosi ta dërgon Aliun r.a., urgjentisht Aliu r.a. me një grup besimtarësh i hipur në deven e Muhamedit a.s. u nisë në drejtim të Mekes.

Me të arritur para hyrjes në Mekke, Aliu r.a. u takua me Ebu Bekrin r.a. kurse ky i fundit iu nënshtrua udhëheqjes së Aliut r.a.

Pas hyrjes në Mekke, Aliu r.a. banorëve të Mekes në mesin e tyre ishin dhe paria e Mekes, i'u drejtua me këto porosi:

- Nuk do të bënë Tavaff ( rrotullim rreth Qabes ), pas këtij viti asnjë pabesimtarë;

- Tavaffi, nuk do të bëhet lakuriq ( pasi që traditat dhe besimet e idhujtarëve ishin rrotullimi rreth qabers lakuriq);

- Pabesimtarët e kanë të ndaluar hyrjen në xhenet;

- Kush ka marrëveshje me Muhamedin a.s. për armëpushim dhe për paqe le ta dije se ajo është e kufizuar me afat;

Paria e Mekes, i'u përgjigj Aliut r.a.: Ne me Muhamedin përdorim gjuhen e forcës, në mes nesh është shpata, gjuajtja e shigjetave apo e helmit.

Aliu r.a., në këtë provokim u përgjigj me fjalët e Allahut xh.sh.: "**O ju që besuat, vërtet idhujtarët janë të ndyrë, andaj pas këtij viti të mos i afrohen më xhamisë së shenjtë.....**" ( Et- Tevbe: 28 )

Po në këtë vit, u bë obligative haxhi, e cila paraqet

njërin prej pesë shtyllave të Islamit. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: "**..... Për hirë të Allahut, vizita e shtëpisë ( Qabes ) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit te ajo ....**" ( Ali Imran: 97 )

## TIPARET DHE VETITË E HAXHIT

Fizionomia e haxhit ka dy anët e saj:

- a. Shpirtërore
- b. Fizike

**a-** Sipas mësimëve Islame, haxhi esencialisht është burim i forcës shpirtërore, besimit të sigurtë, me anë të së cilave arrihet tek lumturia e kësaj bote. Sistem vlerash shpirtërore, etike- morale të domosdoshme për jetën e njeriut. Sistem i cili shëron sëmundje dhe anomali të ndryshme shoqërore e individuale. Infrastruktura e sistemit Islam është i bërë në atë mënyrë që njeriut të ia lehtëson jetën dhe problemet e tij ti zgjedh në mënyrë të duhur dhe adekuate. Islami kërkon sistem në të cilin të gjithë do të gjejnë veten në të mirë dhe në të keqe, të jenë të barabartë dhe të jenë solidar dhe human në mes veti.

Ky sistem Islam fillon qysh prej baze. Duke filluar në këshillat e xhematëve, bazë e një Myftinie, si organ i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë. Ky organizim në formë të xhematit të cilët pesë herë në ditë tubohen në xhami për faljen e namazeve. Këtu pikërisht fillon demokracia islame ku të gjithë së bashku jetojnë, organizohen dhe i kanë të njëjtat brenga dhe halle, dhe të gjithë së bashku duke u solidarizuar dhe ndihmuar me njëri tjetrin mundohen të eliminojnë problemet e tyre të përditshme. Mandej ky sistem Islam, manifestohet nëpërmjet faljes së xhumasë, si një formë e tubimit të xhematit në masë ma të madhe, takim javor i besimtarëve. Në suaza të këtij konotacioni është falja e namazit të Bajramit, i cili është takim vjetor. Më në fund solidariteti dhe humanizmi dhe vlerat etike e morale e

njerëzore marrin karakter global me rastin e takimit e të gjithë haxhilerëve të botes pa marrë parasysh se nga vinë dhe çfarë nacionaliteti kanë, takohen me një vend të njëjtë në kohe të caktuar.

Me një fjalë, institucioni haxh ka status të veçantë, e cila në vete përmban mësim dhe vlera kulturore, shoqërore, ekonomike dhe politike.

**b-Haxhi** përbehet prej ritualeve të caktuara fetare Islame, në vende të caktuara dhe në kohë të caktuar. Andaj dhe ajeti ku flet për obligimin e haxhit thotë: "**.....është obligim për atë që ka mundësi udhëtimit te ajo ....**" ( Ali Imran: 97 )

Prandaj haxhiu fizikisht duhet të jetë i përgatitur t'i përballojë këto ritualeve, kërkon mund dhe lodhje.

Në vijim do të paraqesim në pika të shkurtër obligimet dhe detyrat që haxhiu duhet ti kryej nëse dëshiron që haxhi i ti të jetë i suksesshëm dhe i pranuar te Allahu xh.sh, siç vijon:

**1- Ihrami-** Teshë ( veshje ) speciale e cila vlen vetëm për haxhiun, përbëhet prej dy pjesëve, pjesa e epërme dhe e sipërme në formë të mbështjellësit. E që më veshjen e saj obligohet haxhiu të ndal veten nga disa ndalesa, në të kundërtën pason dënimi me therje të kurbanit, siç janë: marrëdhëniet seksuale, hidhërimi e përgojimi me vëllanë mysliman, gjuetia, veshja e teshave të qepura me penj, mbulimi i kokës dhe i trupit, të rruarit e fytyrës dhe e trupit, parfymosja e trupit etj.... Kurse për lëshime me karakter ma të vogël jipet sadaka, siç janë: rrotullimi i Qabes (tavaff veda) dhe (tavaffi kudum) pa abdes, mbulimi i kokës për një kohë shumë të shkurtër, të rruarit e kokës apo e fytyrës ma pakë se një e katërta ( ¼ ), nëse e ruan dike tjetër etj.....

Veshja e ihramit është e kushtëzuar me kohe dhe vend. Në katër hyrjet e Mekës, e që quhen kufijtë ( Mikatet ) e Mekkes, ku dhe vishen Ihramet.

**2- Tavaffi Zijaret-** i cili është farzë, kryhet në ditën e parë të Bajramit.

**3- Tavaffi Veda,** i cili është vaxhib. Kryhet para se të lëshon haxhiu Mekken.

**4- Tavaffi Kudum,** i cili është synet. Kryhet pasi që të arrish në Mekke.

Gjitha këto rrotullime ( Tavaffe ), rreth Qabes duhet të jenë 7 herë.

**5- Saj'i,** vrapimi në mes dy brigjeve të Safasë dhe Merves. Duke filluar nga Safa, 7 herë.

Allahu xh.sh., në Kuran thotë: "**Safa dhe Merve, janë nga shenjat (për adhurim) e Allahut, e kush e mësyen shtëpinë për haxh (qaben për haxh) ose për umre (vizitë jashtë krahës së haxhit), nuk është mëkat për te t'i vizitojë ato dyja ( të ecë në ato vende).....**" ( el- Bekare: 158)

Safa dhe Merva, janë dy brigje afër Qabes. Kur Ibrahim a.s. vendosi Haxheren dhe Ismailin a.s. në Meke, atyre iu la një enë me hurma dhe ujë. Pas largimit të tij, Haxhereja luti Ibrahimin a.s. që mos ta lenë te vetme pasi që në atë vend nuk kishte kushte për jetë dhe ishte me foshnjë i cili pinte qumësht nga nëna e tij.

Pas përfundimit të ushqimit dhe qumështit, Ismaili a.s. si foshnjë filloi të qajë nga uria dhe etja. Dashuria e nënës ndaj fëmijës e shtyri Haxheren, të ngjitet në bregun ma të afërt Safa dhe të kërkon ushqim dhe filloj të vrapoj në mes dy brigjeve të Safasë dhe Mervesë, deri në shtatë herë.

**6- Qëndrimi në Arafat,** pjesë përbërëse e haxhit pa të cilën haxhi nuk është i vlefshëm dhe nuk pranohet assesi. Arafati është një tokë e rrafshët shkretëtire, ku mblidhen me miliona njerëz, në kohen e namazit të drekës falet dreka dhe ikindia.

**7- Muzdelifeja,** në rrugën drejt minas, gjendet një vend i quajtur Muzdelife, ku haxhilerët qëndrojnë duke filluar nga perëndimi i diellit e deri në mëngjesin e ditës së parë të bajramit. Në këtë vend falet namazi i akshamit dhe i jacisë së bashku dhe haxhiu tubon nga toka 49 guralecë për të gjuajtur shejtanin.

**8- Mina,** Vend ku gjinden në mënyrë simbolike tre shejtanët të përfytyruar në një formë të një shtylle. Ku hedhen guralecët e tubuar në Muzdelife.

# Haxhi- Sfidues i koekzistencës ndërnjerezore

*Me vizitën dhe qëndrimin në vendet e shenjta besimtari në mënyrë kontinuitive mediton dhe mendon për vuajtjet dhe mundimet e profetëve të cilët sakrifkuan çdo gjë për të vetmin qëllim që në planetin tokë të ngritet lartë fjala e Allahut fuqiptotë dhe shtëpia e shenjtë e cila në një kohë të gjatë ishte e mbushur përplot me idhuj dhe zotëra, të pastrohet dhe të shërbejë si vendë në të cilin njerëzimi në formën më të mirë të shpreh lutje dhe falënderimin ndaj Allahut xh.sh.*

### Skender BUZAKU

Haxhi si një ndër bazamentet mjaft me peshë, në legjislaturën Islame ka një rëndësi dhe pozitë të veçantë. Nga vetë fakti se kemi të bëjmë me një institut i cili është shumë i vjetër dhe i njohur në kultura dhe religjione të ndryshme, i cili manifestohet dhe kryhet në mënyra dhe forma të ndryshme.

Në fenë Islame peligrinazhi ka një histori të vjetër e cila është e përmbushur përplot me fakte, argumente dhe ndodhi të vërteta të cilat zgjuan kërshërinë e komunitetit të asaj kohe po edhe të kohës në të cilën jetojmë tani.

Është me rëndësi të madhe të theksohet se ky obligim ndërlihet me vizitën e vendit të shenjtë- Qaben e bekuar i cili vend për besimtarët shërben si orientues dhe pikë kryesore drejt të cilës çdo besimtar drejtohet dhe manifeston besimin dhe lutjet e veta të përditshme, të cialt janë të dedikuara në mënyrë direkte drejt Krijuesit fuqiptotë.

Njëherit instituti në fjalë për neve si besimtarë shërben edhe si përkujtues dhe dëshmi për të kaluarën sepse ky vend i shenjtë karakterizohet me prezencën dhe punën e palodhshme e cila ishte kryer nga shumë profetë dhe njerëz besimtar e të urtë, të cilët kishin qëllime dhe besime të pastra ndaj Krijuesit, kurse në anën tjetër puna dhe aktiviteti i tyre ishte i drejtuar në themelimin dhe ruajtjen e një vendi të shenjtë dhe të pastër në të cilin do të mund të takoheshin shumica e besimtarëve në mënyrë të shprehjes së mendimeve dhe pikëpamjeve të tyre për rregullimin dhe stabilizimin sa më të mirë të jetës së muslimanëve.

Haxhi si obligim dhe parim Islam është i ndërlihur edhe

me mundësinë sociale dhe materiale për besimtarin i cili dëshiron të vizitojë vendet e shenjta.

Andaj këtu shihet urtësia e madhe e Krijuesit të njerëzimit sepse nuk i obligoi besimtarët në mënyrë të përgjithshme ashtu siç kemi të bëjmë me disa obligime tjera, por njëherit me këtë institucion dhe kusht të besimit janë të obliguar vetëm besimtarët të cilët përveç kushteve tjera të përgjithshme duhet të kenë edhe pasuri.

Përkujtimet e së kaluarës: Me vizitën dhe qëndrimin në vendet e shenjta besimtari në mënyrë kontinuitive mediton dhe mendon për vuajtjet dhe mundimet e profetëve të cilët sakrifkuan çdo gjë për të vetmin qëllim që në planetin tokë të ngritet lartë fjala e Allahut fuqiptotë dhe shtëpia e shenjtë e cila në një kohë të gjatë ishte e mbushur përplot me idhuj dhe zotëra, të pastrohet dhe të shërbejë si vendë në të cilin njerëzimi në formën më të mirë të shpreh lutje dhe falënderimin ndaj Allahut xh.sh.

Vrapimi (sa'ji) drejt kodrinave Safa dhe Merve paraqet një shenjë dhe një realitet i cili simbolizon Haxheren e ndershme e cila e rraskapitur dhe mërzhitur për foshnjën e saj ishte në gjendje jetën e saj të sakrifkujtë në mënyrë që t'i ndihmon djalit të saj të vogël. Kurse në anën tjetër Tavafi, qëndrimi në Arefat, burimi i Zemzemit, guri i zi dhe therja e kurbanëve janë veprime të mjaftueshme të cilat neve na mësojnë se sa pozitë të madhe ka haxhi dhe vizita e Qabes shenjtë.

Për këtë shkak kur Ibrahim dhe Ismaili a.s kryenin punime në rindërtimin e Qabes së Shenjtë ata pandërprerë me besim të pastër dhe bindje të plotë i

luteshin Allahut fuqiptotë që Qabja të shërbejë si vend për lutje, adhurim e në asnjë mënyrë si vend në të cilin do të vendoseshin idhuj dhe statua të ndryshme të cilat nuk prezentonin asgjë konkrete dhe reale.

Takimi mes besimtarëve: Pamëdyshje se Haxhi në vetvete ngërthen edhe aspekte tjera të cilat luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në takimin dhe komunikimin e ndërsjelltë mes besimtarëve.

Për këtë qëllim mund të themi se vizita e Qabes në fenë Islame, ka një rëndësi të veçantë sepse institucioni në fjalë paraqet një konferencë të madhe vjetore sepse besimtarë të vendeve dhe kulturave të ndryshme takohen dhe shprehin mendimet, pikëpamjet dhe opcionet e tyre të përbashkëta për rregullimin dhe përmirësimin e jetës së besimtarëve.

Për këtë arsye vizita e këtyre vendeve duhet të shërbejë si leksion dhe edukatë për besimtarët edhe kur ata të kthehen në vendet e tyre, sepse filozofia e Haxhit është që besimtari të jetë i moralshëm dhe i sjellshëm edhe kur ai nuk gjendet në vendet e shenjta. Duke u bazuar në këto rëndësi dhe fakte të pakontestueshme mund të konkludojmë se besimtarët duhet të jenë krenarë për atë që Allahu i shpërbleu ata për punën dhe kujdesin që tregojnë ndaj shtëpisë së Shentë Qabes.

Prandaj mjaft për neve është sfiduese realiteti dhe fjalët e Profetit, se namazi i cili falet në Qabe apo në Medine sa vlera të mëdha posedon për dallim nga namazet në vendet tjera, fjalë të cila për neve duhet të shërbejnë si stimul, nxitje dhe punë të palodhur në jetën tonë të kësaj bote.

**INTERVISTË ME ABDUL-AZIZ ABDULLAH LA-AMMAR, ZV/MINISTËR I  
MISTRISË PËR ÇËSHTJE FETARE**

# Mos dëmtoni imazhin e Islamit me ekstremizëm

*“Qëllimi tjetër është që ne i japim shumë rëndësi zhvillimit bashkëkohorë të myslimanëve që jetojnë jashtë botës arabe. Kërkojmë nga ana e tyre që të jetojnë si mysliman bashkëkohorë në këto treva dhe në këtë kohë. Edhe daveti jonë është mesatar si në kuptimin e fesë ashtu edhe në jetën e përditshme e jo të bëjnë një jetë ekstreme. Jo mesatarja që ti lesh anësh çështjet islame në asnjë mënyrë kjo, por mesatarja ti kuptosh çështjet islame ashtu siç duhet”*

**Intervistoi: Abaz ISLAMI**

Hëna e Re: Meqë ju jeni një ndër figurat e shquara të botës arabe posaçërisht të Arabisë Saudite kisha dëshirë që në fillim të tregoni se kush është angazhimi juaj në Ministrinë islamike të Arabisë Saudite për lexuesit e revistës “Hëna e Re”?

**La-Ammar:** Fillimisht jam jashtëzakonisht i gëzuar që jam në mesin tuaj sidomos për çështjet islamike. Çdo çështje fetare me karakter ndërkombëtarë është në kompetencat e mia. Ministria Islamike, është ministri speciale që interesohet për çështjet myslimane jashtë territorit të Arabisë Saudite. Edhe qëllimi jonë i vizitës ishte takimi me kryetarit e BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepi, njëherit të takohemi si miq sepse njihemi moti dhe që të intensifikojmë bashkëpunimin si dhe të zgjidhim disa çështje të karakterit fetarë.

**Hëna e Re:** Sa bota islame vepron në drejtim të zhvillimit të kulturës dhe civilizimit islam?

**La-Ammar:** Ne në Arabinë Saudite i japim shumë rëndësi çështjes së davetit dhe mundohemi me çdo kusht ta kemi parim kuranor bashkimin mes myslimanëve dhe mos përzihemi në çështjet e brendshme. Kjo është që të ndihmojmë davetin dhe besimtarët në të gjitha mënyrat si në aspektin kulturorë ashtu edhe në aspektin shkencorë dhe sferat e tjera. Për ne më me rëndësi është që çdo ndihmë e jonë dhe bashkëpunim këtu,



duhet të merret si bashkëpunim e jo përçarje sidomos për sa i përket çështjes së fikut por edhe në aspekt nacional. Qëllimi i bashkëpunimit tonë me botën mysliman që janë jashtë është që të bëhet një unitet kulturorë dhe civilizues në mesin e myslimanëve dhe mundohemi që këtë mesazh të përcjellim tek të gjithë jo vetëm në mesin e myslimanëve. Qëllimi tjetër është që ne i japim shumë rëndësi zhvillimit bashkëkohorë të myslimanëve që jetojnë jashtë botës arabe. Kërkojmë nga ana e tyre që të jetojnë si mysliman bashkëkohorë në këto treva dhe në këtë kohë. Edhe daveti jonë është mesatar si në kuptimin e fesë ashtu edhe në jetën e përditshme e jo të

bëjnë një jetë ekstreme. Jo mesatarja që ti lesh anësh çështjet islame në asnjë mënyrë kjo, por mesatarja ti kuptosh çështjet islame ashtu siç duhet.

Këtë e argumenton edhe ajeti kuranor që flet se ne ju kemi bërë një popull mesatar dhe si fe mesatare në të cilin ka vend për të gjithë.

Arabia Saudite në krye me mbretin Abdullah, shërbyesin e xhamive princin Sulltan dhe bartësin e gjithë kurorës mbretërore princin Aiv ka për qëllim që të çrrënjosë ekstremizmin me qëllim për të treguar se islami është një fe e mesme.

**Hëna e Re:** Ka një çrregullim fetarë që ndodh

brenda islamit sidomos me paraqitjet e shumë fenomene negative. Për këtë edhe shumë dijetarë islam tani po i japin rëndësi çështjes së davës. Kush është mendimi juaj për këtë?

**La-Ammar:** Mos dituria i bijë të gjitha këto. Sikur të kishte dituri të fesë si duhet por me urtësi nuk do të vinte deri tek këto fenomene. Shpërndarja dhe ekstremizmi rritet vetëm nga injoranca që i ushqen ato. Në të gjithë çështjet fetare i drejtojmë tek dituria. Andaj, Allahut i frikësohen të diturit (mendimtarët, shkenctarët).

**Hëna e Re:** Me çfarë kapaciteti mendon se duhet të veprojnë mendimtarët islam për të ngritur vetëdijen fetare tek shoqëria islame?

**La Ammar:** Rritja e vetëdijes është një rol i pakontestueshëm i Ulemave dhe ato duhet të punojmë në këtë drejtim. Duhet shumë punë nga ana e Ulemave që të arrihet rezultat por këtë ata duhet ta bëjnë.

**Hëna e Re:** A mendoni se duhet të merret një rrugë e hapjeve të instituteve apo me çfarë strategjie duhet aprovuar që të ngritin vetëdijen shoqërore, Ulematë?

**La Ammar:** E para është strategjia e bashkimit të myslimanëve dhe jo të bëhet përçarja. E dyta edhe sistemi arsimorë të thirrë këtë gjë dhe e treta është të largohemi prej çdo problemi që paraqitet në shoqëri.

**Hëna e Re:** Me që është koha e Haxhxit dhe i cili luan

# Të shkruash historinë me aversion

Emine A. Vezaj

Në një fushë propagandistike parimi se; "Secili është i pafajshëm përderisa nuk dëshmohet e kundërta" është i pa fuqishëm para formulës së njohur Goebbel's'iane: "Një gënjeshtër e madhe që përsëritet shpesh, në fund besohet si e vërtetë". Si duket historitë përsëriten. Gjithsesi, se kjo ndodhë në dy raste, ose atëherë kur njeriu nuk e shikon të kaluarën detyrohet ta përsëris atë, ose kur ka lakmi nga ajo.

Me katërmbëdhjetë prill 2009, në Hotelin Grand në Prishtinë, kishte filluar Simpoziumi Ndërkombëtar "Kosova dhe Perandoria Osmane në dokumentet arkivore", me moton "Ta shkruash historinë me tolerancë". Ky simpozium ishte organizuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Agjencia Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar "TIKA". Meqenëse Arkivat shumë herë shërbejnë edhe si urë lidhëse për një komunikim miqësor mes dy shteteve, dhe se dokumentet arkivore janë thesare të vetme të memories njerëzore edhe ky Simpozium krijoi një rast të volitshëm madje edhe të mirëseardhur për të nxjerrë në

“Një person i krisur dhe inteligjent mund t'i bëjë gjërat më të dhunshme. Nevojitet një dorë e gjenit dhe shumë guxim për t'i lëvizur gjërat në drejtim të kundërt”.

Ernst Friedrich Schumacher

pah atë "miqësi" që i ka karakterizuar këta dy popuj të cilët për një kohë të gjatë patën "bashkëpunuar" madje më shpesh të acaruar. Në ditën e dytë të këtij simpoziumi historianët patën rastin të shpalosin referimet mbi të dhënat arkivore rreth marrëdhënieve të Perandorisë Osmane me popujt e tjerë të Ballkanit. Njëri ndër referuesit më të spikatur të këtij Simpoziumi ishte edhe Kristaq Prifti, i cili në një far forme solli fakte të "reja" dhe dokumente rreth krijimtarisë dhe aktiviteteve politike të Pashko Vasës: "Vasa i ritit të krishterë asokohe kishte pasur një ndër privilegjet më të larta të sundimit osman dhe gjithnjë sipas Priftit "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët (1879)" për traktatet publicistiko - politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të shkruara nga Pashko Vasa, janë shkrime me një qasje shumë pozitive ndaj administratës dhe diplomacisë

turke të asaj kohe". Duket ka ardhur momenti i duhur që të paraqitet ai realitet i "ri" nga vet kundërshtarët e kësaj Perandorie, ai raport acarues i cili ka ekzistuar prej kohësh mes dy popujve ballkanas; shqiptarëve dhe turqve

Rrjedhimisht, do të dukej shumë i ngjashëm ky titull i imi me moton e këtij Simpoziumi, ose thënë ndryshe tip plagjiati, por thënia latine "Uti, non abuti (përdore, por mos e keqpërdor)!" shpresoj të ma justifikon këtë rast. Ndryshimi i vogël në titull më shumë ad hoc se sa i para menduar prezanton në vijim se historia shqiptare, jo që nuk është shkruar me tolerancë, por ajo është shkruar me aversion dhe përbuzje të tepruar. Si gjithmonë në Ballkan, por në fakt edhe gjetkë, nuk është e vërteta ajo që ka rëndësi, por ajo që njerëzit besojnë se është e vërtetë. Dhe çka njerëzit besojnë, mund të vihet në përdorim të përditshëm. Për ata prej nesh që jetojnë në Kosovë ose në

një rol të veçantë në botën Islame. Sa mendoni se duhet Haxhhi të luaj rolin edhe të organizimit të botës islame?

**La Ammar:** Ajo është një prej fotove që tregon unitetin e myslimanëve. Nuk ka dyshim se Haxhhi ka rolin e vet dhe është shumë me rëndësi për mbarë myslimanët. Ai i drejtohet Haxhxit dhe kjo është në aspektin shpirtërorë por kur shkon në Haxhkh këtë e ndjen me anë të prekjes dhe se uniteti konkretizohet. Haxhhi është një ibadet por frytet e Haxhxit janë bashkimi më i gjërë i myslimanëve dhe vetë drejtimi nga Kibla tregon se ai është një anatër i fesë islame. Dhe ky ibadet është edhe në agjërime. Edhe sikur të jesh shoqëri jo myslimane duhet të mos dalim tek dhe të falësh i vetmuar, por duhet t'i bashkohesh besimtarëve.

**Hëna e Re:** Në të kaluarën dijetarët kanë sqaruar se Haxhhi ka një moment të jashtëzakonshëm sidomos momenti i mbledhjes së dijetarëve. Kur ata janë së bashku në atë vend të shenjtë sa ato kontribuojnë prej aty, për luftimin e dukurive negative dhe ngritjen e islamit në një pozitë më të lartë?


**La Ammar:** Nuk ka dyshim se kjo është arsyeja që Mbreti Abdullah i mbledh në një vend ulematë dhe diskuton për këto çështje.

**Hëna e Re:** Cili është opinionimi i juaj për zhvillimin dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore islame sidomos në vendet sekulare?

**La Ammar:** Arabia ka ndërhyrë te UNESCO dhe disa herë tek vendet konkrete me qëllim të ruajtjes së disa objekteve me karakter islam.

**Hëna e RE:** Cila është porosia e juaj për lexuesit e Hënës së Re?

**La Ammar:** Lexuesve që njëkohësisht janë edhe vëllezërit e mijë do t'i kisha porositur që ta ruajnë personalitetin e vet islam larg nga çdo ekstremizëm dhe t'u bashkëngjiten dijetarëve të tyre të mos mbesin të ndarë. Të interesohet që fëmijët e tyre t'i shkollojnë në një frymë islame sepse kjo do të ndikojë që ato të formojnë personalitetin e tyre islam.



Shqipëri, fakti se kush jetoi apo kush luftoi për mbijetesë në shek. XVI, nuk duhet të ketë ndonjë lidhje me të sotmen.

Në anën tjetër është naive të mendohet se turqit janë armiq të shqiptarëve. Këtë aversion ndaj popullit turk unë e kam mësuar qysh kur fillova të mësoj definicionin e shkencës së historisë, edhe atë në një momente të caktuara kur identiteti im ishte në formësim e sipër dhe unë dhunshëm duhet të pranoja atë që më mësohej nga mësuesi im. Atëherë, ku përpos asaj se dija të thoja; feja ime është feja Islame (mësim nga familja), kombi im është shqiptar dhe “shteti” im është Kosova, mu imponua, gjithnjë në arsimin e asaj kohe se turqit dhe Perandoria Osmane ishin armiq të më të mëdhenj të popullit shqiptar sepse nga prindërit e mi dhe edukata që kisha marrë si fëmijë më ishte ngulitur në shpirt dhe në zemër se populli turk gjithmonë ishte mik i popullit tonë. Me këtë moto vet Mbretëria Serbe nguliti kthetrat e saja dhe sundimin e saj më të ashpër me përmasa gjenocidale kudo ku flitej shqip dhe kishte kulturë islame.

## “INATI” NË PERANDORIN OSMANE - TURQIT

Sa herë flitet për Perandorin Osmane, krijohen paragjyime tmerruese ndaj turqve. Po pse ekziston gjithë ky mllef ndaj kësaj Perandorie, pse të mobilizohemi i madh e i vogël për të bërë propagandë antiturke?

Në shumicën e vendeve ballkanike, botëkuptimi popullor për sundimin osman është pothuajse tërësisht negativ. Osmanët përshkruhen si barbar aziatik, të cilët shkatërruan, në çdo vend që pushtuan... ata kishin imponuar një sistem plotësisht të huaj sundimi; shtypën në mënyrë cinike të gjitha ndjenjat e identitetit kombëtar; kolonizuan vise të mëdha të Ballkanit me banor turq; ata i shndërruan fshatrat e krishterë në një pozitë të bujkrobërisë së plotë... ata ushtruan presion të padurueshëm në kishat krishtere vendëse dhe i detyruan njerëzit që të kalonin në fenë islame; treguan një përkushtim fanatik ndaj parimeve të Sheriatit. Kështu na thuhet. Të gjitha këto pohime apo mëtime janë në rastin më të mirë çoroditëse kurse përndryshe krejtësisht fallso”, sqaron studiuesi Noel Malcolm, duke

vazhduar më tutje Malcolm pohon se: “në vend që të vendoste një sistem plotësisht të huaj, Perandoria Osmane, në të vërtetë, ruajti dhe zhvilloi shumë karakteristika të jetës administrative, shoqërore, ceremoniale etj. – ashtu siç i kishte gjetur në shtetet e krishtere të pushtuara... me këtë, sidoqoftë, nuk duam të themi se Perandoria Osmane ishte veçse një variant më i madh e më i mirë i një shteti të Evropës Perëndimore të periudhës së Rilindjes. S’do mend se kishte disa dallime të thella. Disa nga këto dallime rridhnin nga lidhja osmane me islamin; mirëpo, shumica e karakteristikave fundamentale të Perandorisë Osmane nuk kishin të bënin me fenë, por me luftën.

Do të duhej studiues të huaj dhe objektiv të trajtonin historinë shqiptare. Ndërsa për mungesë të teksteve valide në gjuhën shqipe, të gjitha gjeneratat e reja kanë fituar aversion ndaj Perandorisë Osmane, e që të tillët (studiuesit të huaj me qëllime kamufluere) kohë pas kohe bënë mbindërtimin e një historie krejtësisht fallse, duke sajuar hipoteza të ndryshme, të cilat nuk kanë kurrfarë baze me realitetin. Madje përpos shqiptarëve të cilët konsiderueshëm kanë qenë tendencioz karshi Perandorisë Osmane, edhe të huaj në këtë drejtim kishte mjaft. Do të përmend studiuesin gjerman Peter Bartl. Bartli është i mendimit se “në historiografinë shqiptare sundimi gati pesë shekullor turk gjykohet pothuajse negativisht. Pushtimi i Shqipërisë në pasojat e tij nuk mund të krahasohet me pushtimin e Bullgarisë apo Serbisë; aty turqit rrënuan kulturën të larta mesjetare”. Bartli edhe në këtë pohim hipotetik nuk sjellë fakte veçse mjaftohet të hamendësojë në stilin “thuhet se...ose gati...”

## PSE GJITHË KY INAT?

Po të bëhemi dëshmitar të shtypit ditor, do të vërenim se çdo ditë në ndonjë shtyp vendor mund të hasësh në ndonjë artikull që flet për raportet midis dy vendeve mike, në këtë rast Kosovës dhe Turqisë, dhe sikur të bënim një balancim nga e kaluara, kjo e tashmja thuhetse tregon një antagonizëm karshi të kaluarës sonë tendencioze në raport me popullin mik – Turqinë. Marrë shkas nga kjo të them, se edhe përkundër një

aversioni të tepruar karshi kësaj Perandorie sërish nuk fshehim emocionin e atij momenti kur pikërisht Turqia ishte Shteti i dytë në Botë që njohu sovranitetin dhe Pavarësinë e Kosovës, ishte po ky Shtet që i pari hoqi vizat për shtetasit e Kosovës. Madje me rastin e vizitës së zv/kryetarit e Parlamentit të Turqisë z. Nevzat Pakdilli i cili para pak kohësh bëri një vizitë Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës z. Fatmir Sejdiu, në këtë takim miqësor theksoi se: “Mbështetja e Turqisë është në shumë dimensionë, në shumë fusha, duke filluar nga proceset e hershme, me prezencën e KFOR-it – me investime në fushën e biznesit, në arsim, në shëndetësi etj. Me vizita dhe kontakte, me këmbime përvojash, vetëm se shtojnë edhe më tepër mundësinë e bashkëpunimeve bilaterale edhe në fusha të tjera”. Po të përmendim edhe raporte tjera bilaterale midis këtyre dy vendeve, kam përshtypjen se kjo pjesë do të stërzgajtej, por nuk do të bënte pa u përmendur edhe angazhimi shumë i sinqertë dhe i vazhdueshëm i shtetit Turk për njohjet sa më të shpejta nga Konferenca Islamike në veçanti, po edhe nga shtete tjera.

Në anën tjetër, na gëzon fakti, madje edhe marrë guxim të shprehem, se Turqia çdoherë në raport me shqiptarët ka kontribuar vetëm në kontest pozitiv në rrugë të prosperitetit dhe avancimit të Kosovës në drejtim të shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore. Këtë të fundit mbase e ka treguar qysh në të kaluarën e lashtë. Jo pa qëllim përmenda këtë të fundi sepse edhe vet sistemi devshirmes siç është i njohur tek ne shqiptarët, ka qenë pothuajse i kësaj natyre, aspak aksidental, spontan dhe jo sporadik. Perandoria Osmane, ka praktikuar këtë sistem në mënyrë më të kujdesshme në provincat e mbikëqyrura. Ata edukuan breza të ndryshëm duke përfshirë edhe jomyslimanët, ata edukuan prijës më të dobët pa kurrfarë presioni. Në këtë rast Perandoria Osmane ishte veçse një variant më i mirë i mundshëm për shqiptarët të cilët tashmë kishin pranuar mbikëqyrjen e kësaj Perandorie.

Islamizmi i shqiptarëve dhe i të tjerëve në kohën e Shtetit Osman është bërë me anë të sistemit devshirme dhe në mënyrë vullnetare. Të islamizuarit me anë të

devshirme-së, ishin fëmijët e vegjël meshkuj të krerëve aristokratë vendës, të cilët u morën peng nga Shteti Osman. Qëllimi i marrjes peng të këtyre fëmijëve ishte që të njëjtit të përgatiten për një detyrë të tillë. Dhe kjo është bërë më dëshirën e prindërve të fëmijëve në fjalë. Djem të familjeve feudale vendase u morën dhe u edukuan si “içogllanë” në pallatin e sulltanit ose si “gulamë” pranë bejlerbeut të Rumelisë ose pranë sanxhakbejlerëve, ku, pasi kalonin në fenë islame, ktheheshin në funksione të ndryshme administrative ose ushtarake në vendin e tyre.

Tani, po të krahasojmë atë sistem si “totalitaro-turk” (asnjëherë sipas meje), me mënyrën propagandistike të të huajve “tjerë” të cilët kanë shtrirë pushtetin e tyre në Kosovë me qëllime dhe synime të caktuara në fusha të ndryshme të jetës sociale, politike, shkencore e sportive, nuk shoh se ka ndonjë ndryshim në esencë, vetëm se këta të fundit për dallim nga të parët, veprojnë në formë shumë kamufluere dhe shumë dinake. Ndërsa nëse vetëm pak të vetëdijshëm për aftësimin dhe profesionalizmin e kuadrove të rinj me njohuri të ndryshme nga shtete të fuqishme me më shumë eksperiencë, nëse vetëm për një moment të caktuar do të merrnim ndonjë ofertë studimi ose avancimi profesional, jam më së e bindur se nuk do të kishte asnjë që do t’i thoshte JO kësaj oferte - mbase mund të jetë edhe e pa rezistueshme.

Në analogjinë time sistemi devshirme e që për shqiptarët është hale në sy nga sistemi Osmanë, vazhdon të mbetet i vetmi sistem që shqiptarëve vetëm se i krijoi mundësi se si t’i konsolidojnë radhët e tyre në ushtri, administratë, si të udhëhiqen me politikë të jashtme e me radhë. Realisht, kjo Perandori me veprimet e saj toleruese, kulturës shqiptare dhe elitës në përgjithësi nuk ia mbylli zhvillimin evropian, por mbi të gjitha i la mundësi dhe hapësirë për t’u zhvilluar, madje me një përgatitje dhe eksperiencë të mirë të marrë mbi shtratin e kësaj Perandorie. Zëra të tillë të cilët Perandorin Osmane e paraqesin Perandori me një sistem totalitar, sa janë të pabaza, të ngjashmet edhe janë propagandistike, por gjithsesi se mbeten të padëgjueshme para pikëpamjeve të mbështetura shkencërisht e që konsiderueshëm edhe u paraqitën brenda këtij teksti.

# KUR'ANI- SHKRIMI, GJUHA DHE PËRKTHIMET E PARA

“Me shkrimin arab është shërbyer edhe gjuha turke, perse, indiane, berbere, suahile, indoneziane e të tjera, ndërsa tek ne në Bosnjë dhe Sanxhak njihet sipas emrit “bosancica”, “arabica” ose “mektebica”. (Po i njëjti shkrim është përdorur edhe nga shkrimtarët, gjuhëtarët dhe poetët shqiptarë gjatë periudhës Osmane e deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, anembanë hapësirës etnike shqiptare, dhe ky shkrim shqip me shkronja arabe njihet si letërsia e bejtexhinjve, alhamia da ose arabeska, vërej. e përkth.)”



Prof. Dr. Jusuf Ramiq

## SHKRIMI

Shkrimi arab është zhvilluar nga shkrimi **nabatej**. Nën ndikimin e shkrimit **sinajian** është formuar shkrimi kursiv, ku shumica e shkronjave lidhen njëra me tjetrën. Dy lloj tipash të shkrimit arab janë si kryesorë: shkrimi **kufian** dhe ai **nes'h**.

Shkrimi kufian, emëruar sipas qytetit Kufe i cili gjendet në Irakun jugor, është shkrim monumental dhe këndor. Më

këtë shkrim janë shkruar Mus'hafët për plotë katër shekuj me radhë. Në periudhën abaside u degëzua në më shumë se pesëdhjetë variante, në mesin e të cilëve më të njohur janë: shkrimi **mukarrer**, **mushexh-xher**, **murebbe'a**, **mudevver** dhe **muteddehil**.

Ky shkrim vazhdoi të përdoret deri në shek. e 10 H. / 16 M., pas të cilit u zhduk tërësisht. Në kohën e re, ky shkrim ka filluar që të ringjallet dhe të përdoret në arkitekturë.

Shkrimi **nes'h**, për dallim nga ai kufian, është më kursiv dhe më i rrumbullakët. U

zhvillua në Egjipt, duke qenë larg ndikimit të gjuhës siriane, me ç'rast paraqitet si i vetmi trashëgimtar i shkrimit **nabatejan**. Është përdorur, gjithashtu, për shkrimin e mus'hafëve, dokumenteve zyrtare si dhe në monedha.

Me kombinimin e këtyre dy tipave kryesorë të shkrimit arab, Kutbe Ibn El-Mularrir, aty kah fundi i dinastisë Emevite shpiku një formë të re të shkrimit të quajtur **“xhelil”**. Diversiteti i këtij shkrimi mund të vërehet edhe në shembuj të shumtë të realizuar në mure të xhamive, shkollave dhe

objekteve të tjera në qytetin e Kajros. Pas shkrimit **xhelil**, po i njëjti kaligraf, krijoi edhe shkrimin **“tumar”**, i cili, për nga forma, është më i imët se shkrimi **xhelil**, me anë të të cilit janë shkruar emrat e sulltanëve në fermanë dhe dekrete. Në periudhën abaside, Ibrahim Esh-Shexher, zbuloi shkrimin **“suluf”** - varianti i ri i shkrimit **tumar**, kurse vëllai i tij zbuloi shkrimin **“tevki”** - njëri nga variantet e shkrimit **xhelil**.

Pas këtyre, Ebu Ali Muhamed ibn Mukle, kaligrafisti më i madh në historinë e kaligrafisë arabe,

shkrimet **nes'h**, **xhelil** dhe varianteve të tjera, u dha formën përfundimtare gjeometrike. Dhe kështu, në këtë trajtë dhe formë, që të dy shkrimet, arritën edhe në viset perëndimore arabe (Magreb).

Në Persi dhe Azi është përdorur shkrimi i quajtur **"farisi"**, ndërsa në Turqi shkrimet **rik'a**, **divani**, **ixhaz** dhe **tugra**. Ishte pikërisht kaligrafisti më i njohur turk, Osman Ibn Ali, ai që disa sulltanëve turk ua mësonte kaligrafinë e shkrimit arab. Arabët perëndimor dhe në Andaluzi, kryesisht iu përmbajtën shkrimit **nes'h**, me disa ndryshime dhe plotësime të vogla, dhe kjo ka vazhduar, që nga paraqitja e deri në ditët e sotme.

Arabët perëndimor me lindorët nuk kanë mospajtime vetëm se në radhitjen e shkronjave, porse edhe në vetë përdorimin e numrave dhe shenjave didaktike. Në viset perëndimore përdoren numrat **gabar**, ndërsa në viset lindore ato **indianë**. Kur është fjala te numrat **gabarian**, që depërtuan nga Andaluzia, ato në Evropë njihen edhe si numra arabë.

Me shkrimin arab është shërbyer edhe gjuha turke, perse, indiane, berbere, suahile, indoneziane e të tjera, ndërsa tek ne në Bosnjë dhe Sanxhak njihet sipas emrit "bosancica", "arabica" ose "mektebica". (Po i njëjti shkrim është përdorur edhe nga shkrimtarët, gjuhëtarët dhe poetët shqiptarë gjatë periudhës Osmane e deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, anëmbanë hapësirës etnike shqiptare, dhe ky shkrim shqip me shkronja arabe njihet si letërsia e bejtexhinjve, alhamiada ose arabeska, vërej. e përkth.)

Në shkrimin arab, që nga shekulli i VII, kanë filluar që të përdoren shenja didaktike. Arsytet për këtë janë të shumta, ndërsa njëra prej tyre është edhe leximi i gabuar dhe rregulluar i Kur'anit. P.sh. fjalën "netlu" Hafis ibn Sulejman ibn Mugire e kishte lexuar si "teblu" ndërsa Abdullah ibn Mes'udi si "tetlu". Ajetin kur'anor **"in-nallahe beriun minel mushrikne ve resuluhu"**, dikush në prezencën e El-Esved Ed-Dueliut e lexoi në këtë mënyrë **"in-nallahe beriun minel mushriken ve resulih"** - madje edhe disa

shembuj të tjerë që i shënon Hamza El-Isfahani në veprën **"Et-Tenbihu ala humusi Et-Tashifi"** flasin për nevojën e përdorimit të shenjave didaktike në shkrimin arab. Këtë çështje e realizoi me dëshirën më të madhe, Ebu Esved Ed-Dueli që në shekullin e parë mysliman, gjegjësisht në shekullin e 7 të erës sonë.

## GJUHA

Kur'ani është shpallur në gjuhën e pastër arabe, sipas dialektit të fisit Kurejsh. Stili i Kur'anit është i paarritshëm. Pati shumë prej atyre që u munduan të bëjnë diç të ngjashme si Kur'ani, mirëpo pikërisht këtu e treguan dobësinë e tyre. Disa të tjerë gjurmuan të gjejnë ndonjë proverb apo ndonjë fjalë të urtë arabe dhe atë ta krahasojnë me ndonjë citat të Kur'anit që sipas tyre do të kishte kuptim të njëjtë me të.

Ata gjetën se proverbi arab **"El-katlu enfa lil katli** - "Mbytja më së tepërmi pengon mbytjen" - ka domethënie të njëjtë me ajetin kur'anor: **"Fil kisasi hajatin"**, pra kuptimi është jeta. Megjithatë shumë filozofë kanë nënvizuar mbi njëzet pika ku tregohet superioriteti i ajetit kur'anor ndaj proverbit, p.sh.

**Ajeti është më i shkurtër sepse përbëhet prej tre fjalësh kurse proverba prej katër;**

**Në ajet theksohet jeta kurse te proverbi mbytja;** dhe

**Te proverbi përsëritet fjala mbytje kurse te ajeti kur'anor nuk përsëritet asnjë fjalë, etj.**

Krahas dialektit kurejshit, në Kur'an hasim edhe dialekte të tjera siç është: dialekti i fisit Hudhejl, Ajlan, Xhurhum, Kinan, dhe të fiseve tjera arabe që në atë kohë jetonin në hapësirat e Gadishullit Arabik.

Zemahsheri, Sujuti, dhe komentatorë të tjerë të Kur'anit Fisnik përmendin rreth 45 dialekte të ndryshme lokale të cilët mund hasen në Kur'an. Vetëm dialekti Hudhejl në Kur'an haset në mbi 46 vende.

## PËRKTHIMET

Islami, jo shumë gjatë pas shpalljes së Kur'anit, me një

shpejtësi të madhe u përhap edhe te popujt e tjerë lindorë. Dhe, pasi që ata nuk e njihnin gjuhën arabe, erdhi deri te nevoja e përkthimit të pjesëve të Kur'anit në gjuhën perse dhe gjuhë të tjera të Lindjes. Gjuha perse është gjuha e parë e huaj në të cilën, qysh herët u përkthye Kur'ani.

Serahsi, në veprën e tij **"El-Mebsut"** (fq. 37) shënon që, sipas Ebu Hanifes, ishte sahabiu i njohur Selman Farisiu r.a., ai i cili, pas kërkesës së persianëve, përktheu në gjuhën perse suren **"El-Fatiha"** dhe atë që në të gjallë të Muhammedit s.a.v.s. Persianët përkthimin e kësaj sureje e lexonin në namaz derisa nuk arritën që në të folmen e tyre ta zotërojnë gjuhën arabe. Kurse, i Dërguari i Allahut s.a.v.s., përkthimin e sures **Fatiha** në gjuhën perse, e miratoi heshtas.

Imam Ebu Hanife r.a. dhe juristë të tjerë të kësaj shkolle konsiderojnë që ka mundësi të bëhet leximi i sureve të përkthyer kur'anore në namaz, kurse juristët e shkollës shafite dhe hambelite një gjë të këtillë e refuzojnë në mënyrë kategorike.

Përkthimi vijues i Kur'anit në gjuhën perse është përkthimi të cilin e përmend Xhahizi në veprën e tij **"El-Bejan ve-t-tabjînu"**, i realizuar para vitit 255 H. Nga viti 345 H., hasim përkthimin të cilin e kishte përgatitur ulemaja nga Transoksani, që më pas i është dhuruar udhëheqësit samanidian, Mensur ibn Nuh. Krahas përkthimit, në gjuhën perse i sillat edhe përkthimi i komentimit të Kur'ani të Taberit. Në vitin 1831 H. u botua në dy vëllime përkthimi në gjuhën perse, duke ia bashkangjitur edhe origjinalin në gjuhën arabe.

Brunet tregon edhe për një përkthim tjetër në gjuhën perse në Isfahan.

Shejhut persian, Rafiudinit, po ashtu, i është përkthyer origjinali, në margjinat e të cilit gjenden komentime të Kur'anit në gjuhën perse dhe urdu.

Të parët nga jomuslimanët, të cilët u morën me përkthimin e tekstit kur'anor, janë sirianët. Në Angli, në bibliotekën e Manchesterit, në veprën e titulluar **"Trajtesa"** gjenden ajete kur'anore të përkthyer në gjuhën siriane. Ka shumë që mendojnë, në mesin e të cilëve edhe Manikani, se këtë

përkthim e ka bërë Barselibi, bashkëkohësi i Haxhaxh ibn Jusufit, i cili ka jetuar në shekullin e parë islam.

Një gjuhë tjetër lindore, në të cilën u përkthye Kur'ani, është gjuha hebraike. Sipas Enciklopedisë Hebraike, në bibliotekën e Oxfordit Bodelian në Angli, gjenden pjesë të Kur'anit të përkthyer në gjuhën hebraike të datuara nga viti 1634 të erës sonë. Kur'ani, si përkthim i plotë në gjuhën hebraike, është përkthyer nga latinishtja. Përkthyesi ka qenë Jakub b. Israil Haham Zante. Pas këtij kemi përkthimin e Hermann Reekendorfit, të botuar më 1857 në Lajpcig.

Krahas përkthimeve në gjuhën persiane, siriane dhe hebraike, Kur'ani u përkthye edhe në urdu. Si përkthimi më i vjetër i Kur'anit në këtë gjuhë, konsiderohet të jetë përkthimi i Abdulkadir ibn Shah Velijjullahut. Ky përkthim është botuar më 1790 në Delhi, dhe së bashku me origjinalin në gjuhën arabe, ka përjetuar disa ribotime. Përkthyesi tjetër i Fjalës së Allahut, në gjuhën urdu, ishte Imadudin Amritsar. Përkthimi i tij i Kur'anit u shtyp më 1315 H., në Allahabad të titulluar **"El-Kur'anul-kerim"**, me përkthim në gjuhën perse dhe urde.

Në gjuhën indoneziane, Kur'ani u përkthye, së bashku me Komentin e Bejdaviut, më 1913. Përkthyesi veten e konsideronte si një shërbyes të sulltanit turk. Ndërsa në gjuhën bengale, Kur'ani në tërësi u përkthye më 1908., dhe përkthyesi ishte një evropian, i cili quhej Vilijam Glud Sak.

Me përkthimin e Kur'anit në gjuhën turke takohemi qysh në fillim të shekullit XX. Sulltan Abdylhamidi i II ishte kundër përkthimit të Kur'anit në gjuhën turke. Përkthim i parë në këtë gjuhë doli pas Revolucionit të Xhonturqve më 1908. Përkthyesi ishte Ibrahim Hilmi. Pas këtij, përkthimin e Kur'anit në gjuhën turke e filloi Selim Sabit, që dilte në revistën **"Islam-mexhmuasi"**.

Marrë nga "Preporod - 30 godina"

(izbor testova 1970 - 2000),  
El-Kalem, Sarajevë, 1421  
H. / 2000.

**Përktheu:  
Mehas Alija**

# DEPRESIONI DHE FEJA

Meral JAHJA

Depresioni, stresi si shkak-tare e depresionit, dëshira për vetvrasje si pasojë e depresionit janë sëmundje të botës bashkëkohore. Konkluzë e përbashkët e sociologëve bashkëkohorë është se asnjëherë njerëzimi nuk ka poseduar kaq zhvillim të në teknologji, lehtësim komfor, në të njejtën kohë edhe kaq mjedise të shkatruara dhe devijim psikologjik. D.m.th të mirat materiale nuk sigurojnë lumturi njerëzimit nëse anashkalo-het ana e tij shpirtërore. Në këtë kontekst do të përmendim një analizë të botuar para një kohe në revistat botërore prestigjioze ku Suedia prezento-heshte si shtet më i ngritur me standart më të lartë ekonomik e social, ashtu që qytetaret e saj gëzojnë çdo të drejtë, sigurim dhe kujdes social, por në të njejtën kohë Suedia radhiteshte e para në listën e shteteve ku më

së tepërmi ndodhin vetvrasje. Atëherë mund të themi lirisht që shkak i devijimeve psikologjike nuk është ekonomik. Ne mund të hyjmë në rrethe të varfëra ku anëtarët e saj i gjejmë edhe pse në skam-je por të lumtur dhe në har-moni me njeri-tjetrin. Humanitetin dhe ndih-men e ndërsjelltë e gjejmë si element mbizotërues të jetës së tyre.

-Problemi për rrethet tona nuk është shumë i njohur por në përfundim hasim në shumë studime analiza të botuara në këtë temë. Sipas këtyre studimeve një nga arsyet krye-sore të paraqitjes së këtyre dukurive negative është **har-resa, largimi dhe ndeër-prerja e marrëdhënieve ndërmjet njeriut dhe kri-juesit të tij.**

-Garry J.Kennedy ligjerues pranë kolegjit medicinal ALBERT EINSTEIN në NEW YORK në vitet e 80-ta publikon

një punim, analizë kjo ku përf-shihen dhjetëra studentë të rinjë dhe arrihet në përfundim që nga devijimet e këtilla psikologjike më së tepërmi preken ata që janë më larg jetës fetare.

-Për nevojën e edukimit shpirtëror na flet edhe psikijatri i mirënjohur turk AYHAN SONGAR, në vepren e tij ku studion zhvillimin psiko-social të njeriut të ndarë në katër etapa dhe atë;

- a)periudha e fëmijëris;
- b)periudha e pubertetit-adoleshencës;
- c)periudha e pjekurisë dhe
- d)psikopatologjia e ple-qerisë.

Na flet për reagimet psikologjike të njeriut gjatë adaptimit shoqëror në të katër etapat. Sipas këtij dijetari bal-lafaqimi me këto vështirësi është i domosdoshëm për çdo individ por për tejkalimin e tyre në mënyrë më të lehtë duke mos u lënduar shpreh domos-

“

*“Garry J.Kennedy lig-  
jerues pranë kolegjit  
medicinal ALBERT  
EINSTEIN në NEW  
YORK në vitet e 80-ta  
publikon një punim,  
,analizë kjo ku përfshi-  
hen dhjetëra studentë  
të rinjë dhe arrihet në  
përfundim që nga  
devijimet e këtilla  
psikologjike më së  
tepërmi preken ata që  
janë më larg jetës  
fetare”.*



doshmërinë e edukimit shpirtëror dhe fetar. Kjo tezë na e përkujtonë ajetin kuranor ku Allahu xh. sh. thotë: “*Kush ia kthen shpinën udhëzimit tim, ai do të çojë jetë të rëndë.*” (Taha :124)

-Shëndeti mendor është i rëndësishëm për një shoqëri të shëndoshë. Vetëm me njerëz mentalisht të shëndoshë mund të arrihen suksese dhe përparime në fusha të ndryshme të jetës. Mangësia fizike nuk është shkak që njeriu të jetë i padobishëm për shoqërinë. Por për mangësinë psikike nuk mund të themi të njejtën gjë. Trazirat psikike ndikojnë në pasivizimin e individit si pasojë e së cilës personi shndërohet në objekt të padobishëm për shoqërinë. Bile nuk janë të pakta rastet kur edhe bëjnë dëm rrethit ku jetojnë. Shpesh ndëgjojmë lajmet për persona me shqetësime psikike, të cilët me armë në dorë sulmojnë dhjetëra njerëz të pafajshëm nëpër shkolla ose mjedise ku jetojnë njerëz.

Pra interesi i përbashkët është që për një shoqëri më të shëndoshë dhe për një ardhmëri më të lumtur të kemi njerëz psikikisht të shëndoshë.

## QËNDRIMI I FESË ISLAME NDAJ KËTYRE DUKURIVE

Feja Islame si shpallje e fundit hyjore ka karakter universal dhe gjithëpërfshirës. Prandaj edhe për këto dukuri edhe pse janë prodhime të botës bashkëkohore në zgjidhjet e gjëjmë tek mësimet hyjnore. Kjo është krejtësisht e logjikshme pasi askush nuk mund të njohë një krijesë më mirë se krijuesi i tij. Në lidhje me këtë Allahu xh.sh. në kur'anin famëlartë thotë: “*Njeriun ne e krijuam dhe me se miri e dijme se çfare e brengos ate. Ne jemi me i afert me te se damari i qafes.*” (Kaf:16)

Qëndrimi i mësimetve hyjnore në lidhje me problemet shoqërore është që vazhdimisht shkon në çrrënjosjen e tyre duke i ndërprerë të gjitha rrugët që do të kontribuonin në paraqitjen e një problemi të këstillë.

Për formim të një karakteri të shëndoshë dijetarët potencuan domosdoshmërinë e edukimit shpirtëror të individit.

Islami edukimit individual i

kushton rëndësi të veçantë dhe këtë detyrë fillimisht e le në përgjegjësi të prindërve. E drejta e çdo fëmije është një edukatë e denjë gjë për të cilën prinderit do të përgjigjen para Allahut xh. sh. Sepse në duart e tyre u është besuar edukimi i krijesës më të lartë të cilën Allahu xh. sh në Kuran e emërtonte si HALIFE që do të thotë zëvendës i tij në tokë. Në një ajet thotë: “*O ju besimtarë ruajeni veten dhe familjet e juaja nga zjarri lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurrët.*” (Tahrim: 6)

Në një hadith Muhammedi a.s.thotë: “*Të gjithë ju jeni barij dhe çdonjëri prej jush është përgjegjës për kopenë e tij. Dhe pastaj vazhdon t'i sqarojë obligimet sipas pozitës që gëzojmë në shoqëri.*”

Në një hadith tjetër na mëson që edukimi i fëmijës fillon para njëzet viteve, d.m.th. për të edukuar fëmijën duhet së pari të edukojmë vetën që të mos i bartim veset negative tek gjeneratat e ardhëshme. Sepse sipas studimeve depresioni shkaktohet nga faktorët jetësor por mund të jetë edhe trashëgimi familjare. Në një rast tjetër shokëve ua tërheq vërejtjen për kriteret e duhura gjatë zgjedhjes së bashkëshortes sepse vetëm në atë mënyrë mund të jenë të lumtur.

Sot mësojmë që gjendja psikike e nënës gjatë shtatëzanisë ndikon në formimin e karakterit të fëmijës në barkun e nënës. Përderisa gjinekologët rekomandojnë qetësim me sedative të ndryshëm ekspertet na këshillojnë për joga dhe aerobik, feja kërkon një angazhim të shtuar të dhikrit dhe namazit deri në momentet e fundit të shtatëzanisë. Në këtë mënyrë përparimi i diturisë na ndihmonë që më së miri të kuptohen qëllimet hyjnore.

Në një konkluzë tjetër psikiatrik thuhet që: **mungesa e përvojave pozitive siç është dashuria dhe përkrahja emocionale ndërmjet njerëzve rezultojnë në paraqitjen e depresionit.**

Jeta e besimtarit organizohet në atë mënyrë që në asnjë moment nuk e ndjenë mungesën e dashurisë. Është fjala për dashurinë ndaj Allahut xh.sh. e cila është një dashuri e ndërsjellë ku motiv aktivizues i kësaj dashurie është përsëri vetë njeriu. Në një ajet kuranor

Allahu xh.sh. thotë: “*O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (I bën dëm vetes) s'ka dyshim se Allahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin)...*” (el Maide: 54)

Në një hadith që transmetohet nga ebu Dherr r.a. thuhet: Vepra më e mirë është të duash për Allah dhe të urresh për Allah”-Ahmed dhe Ebu Davud.

Dashuria ndaj Allahut xh. sh vendoset në qendër të jetës së njeriut dhe pastaj të gjithë dashuritë tjera ndërliken dhe ushqehen nga kjo dashuri finale. Ashtu që besimtari pejgamberin e tij, prinderit e tij bashkëshorten fëmijët i dashuron për hirë të Allahut xh.sh. Dashuria ndaj prindërve është urdhër nga Allahu xh. sh. dhe ne nuk kemi zgjidhje pavarësisht nga ajo se a na pëlqejnë ose nuk na pëlqejnë, detyrë e kemi t'i duam. Atyre nuk kemi të drejt as morale e as fetare që sintagmën “uf” t'ua shprehim (themi). Në një hadith Muhammedi a.s. thotë: “*Në rast se do të dishë a është i kënaqur Allahu xh.sh. nga ti, shiqo në fytyrën e prindërve të tu, nëse ata janë të kënaqur dije se edhe Allahu është i kënaqur prej teje.*”

Në lidhjet bashkëshortore kërkohet dashuri, respekt dhe kujdes i ndërsjelle. Në një ajet Allahu xh.sh. thotë: “*Ju jeni mbulesa e atyre, ata janë mbulesa e juaj. Përderisa gruas nuk i lejohet të bëjë sjellje që nuk do t'i pëlqenin bashkëshortit të saj, burrit i sqarohet që luan rol të rëndësishëm në shëndetin mendor të familjes. Sipas statistikave gratë dyfish më tepër se burrat bien në depresion. Duke marrë parasysh natyrën delikate të gruas dhe kushtet biologjike veçanërisht gjatë shtatëzanisë lindjes dhe menopauses, burrit i këshillohet që me një sjellje korrekte mund të ndihmojë shumë në zbutjen dhe largimin e këtyre çrregullimeve dhe shqetësimeve psikologjike.*”

## SIMPOMET E DEPRESIONIT

Krahas dashurisë fëmijërore që mbjellë në zemrën e prindit nëse ndodhë ndonjëherë të lodhemi ose shqetësohemi menjëherë na vjen në ndihmë hadithi i Muhammedit a.s. ku thuhet që çdo angazhim i prindit për familjen e tij lloga-

ritet vepër e mirë sikur me dhënë sadaka (lëmoshë). Besimtari kudo që të jetë është burim i qetësisë dhe kënaqësisë. Prandaj, jeta e vetmuar dhe pa dashuri nuk është e mundur për besimtarin.

Pas gjithë kësaj përgaditje të thellë shpirtërore sistemi hyjnor kujdeset që edhe në përditshmëri të mos zë vend simptomat depressive. Simptomat depressive janë:

**-Personi largohet nga njerëzit dhe preferon vetminë:** Xhemati në këtë kontest i ndihmon shume besimtarit pasi peëe herë në ditë takohet me to;

**-Dembelizmi:** namazi është balancues i rëndësishëm i jetës së besimtarit. Përderisa dembelin e vë në lëvizje nga ana tjetër edhe atë që është tepër i dhënë pas kësaj jete e qetëson.

**-Jeta i duket e pakup-timtë-** Për besimtarin jeta është e vlefshme pasi me këtë jetë ai e fiton ahiretin. Pa marrë parasysh çfare jete kemi. Ne nuk mund t'i zgjedhim çfare roli do të kemi por se si do të luajmë atë rol është në duart tona.

**-Fatkeqsite:** Nuk e dësh-projnë besimtarin por ai ata i sheh si një vërejtje nga Allahu xh. sh., shlyres i mëkateve ose rast për ngritje shpirtërore. Nëse ndodh të humb një të afërm është i bindur që ai është në mbrojtje të HAJRUL HAFIDHIN dhe ERHAMUR-RAHIMIN dhe në jetën e ahiretit përgjithmonë do të jenë së bashku.

**-Ballafaqim me gjëra të reja dhe friga nga mossuksesit:** Këto nuk janë gjëra që e shtyjnë besimtarin në pashpresë sepse çdo rast i ri është zbulues dhe zgjerues i aftësive të njeriut poashtu besimi në kada dhe kaderin e Allahut xh. sh. në mëson që Allahu nuk i shiqon rezultatet e arritura por ndjek mënyren e punës dhe sinqeritetin tonë. Në një hadith Muhammedi a.s thotë: “*Ska dyshim që punët e juaja vlersohen sipas nijetit që keni.*” Për besimtarin është përgëzimi që thotë Allahu xh.sh.”*Për to ska frigë e as pse të brengosen.*”

E gjithë kjo që thamë na jep të kuptojmë që përsë trazirat e botës moderne nuk marrin pjesë në jetën e besimtarit dhe se shmangia e gjeneratave të reja nga devijimet e këtilla është e mundur vetëm me edukim të drejtë fetar.

# Tokën ua morën, tani ua nxjerrin organet...

Mirnes Kovaç

Megjithatë i vetmi që bëri diçka për këtë është Homeini, i shumë urryeri i Perëndimit, gjyshi plak me mjekër të bardhë dhe me vështrim të ngrysur! Pas më shumë se 30 vjet okupimi dhe 20 vjet nga okupimi i plotë i Jerusalemit, Al-Kudsit - siç e quajnë arabët këtë qytet, në muajin gusht të vitit 1979, Homeini u bëri thirrje muslimanëve të mbarë botës që xhumaja e fundit e muajit Ramazan t'i dedikohet Kudsit. Xhumaja e fundit e Ramazanit njihet si **"Dita e Kudsit"** (sot këtë ditë e shënojnë edhe jomuslimanët, por edhe disa grupe çifute anti-sioniste), dhe të solidarizohen me të drejtat legjitime të muslimanëve palestinezë të cilët i janë ekspozuar një terrori dhe padrejtësie të fuqive të mëdha ku Izraeli është eksponenti dhe ekzekutori kryesor. Sot, edhe pas 30 viteve, e gjithë bota, madje edhe muslimanët të lodhur, çdo ditë në vazhdimësi edhe më tej vërejnë dhe janë në pritje se a thua kur qenia njerëzore do ta ndërpres krimin dhe padrejtësinë ndaj popullit të përvuajtur palestinez?

Fjalimi i fundit historik i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Barack Obama mbajtur këtë verë në Kajro, përgjithësisht është përshëndetur në mbarë botën arabe. Ajo çka arabët nuk e pëlqyen nga ky fjalim, ishte barazimi i fajtorëve dhe përgjegjësve për luftën izraelito-arabe. Por insistimi i tij për zgjidhjen e këtij burimi të mosbesimit dhe konfliktit në botë i sfidoi arabët e ndjeshëm, sa që tone të qeta erdhën edhe nga kundërshtarët më të mëdhenj të procesit paqësor arabo-izraelit.

Shumica akoma

“

***“Qartë shihet se në Palestinë në esencë po bëhen krime sikur askund tjetër në botë, ashtu që, sikur përveç kësaj, është unike edhe natyra e okupimit të kësaj toke në mbarë historinë njerëzore.”***  
(Dr. Jusuf Kardavi).

shpresojnë në realizimin e premtimit të Obamës për një angazhim më të intensiv në sanimin e plagëve në raportin mes Lindjes dhe Perëndimit. Megjithatë, ajo çka po ngjet në terren paralajmëron se agonia palestineze, nëse vazhdon me këtë tempo dhe me këtë sjellje nga ana e Izraelit, do të zgjas së paku edhe për tri dhjetë vite të tjera! Sot konflikti është komplikuar edhe më tepër me përleshjet mes grupeve rivale palestineze. Ndërsa për varfërinë, lodhjen, shkatërrimin dhe shfarosjen e infrastrukturës është e tepër të flitet! Duke parë sjelljen e disa liderëve arab dhe në përgjithësi të muslimanëve, duket sikur edhe ata janë lodhur nga “problemi palestinez”. Krahas gjithë fatkeqësive dhe presionit që palestinezët e kanë nga regjimi okupator-kolonialist izraelit: siç është ndërtimi i vendbanimeve të reja të kolonëve çifut në Bregun Perëndimorë (edhe përkundër kundërshtimit nga ana e SHBA-ve) lufta mediatike mes

Suedisë dhe Izraelit edhe më shumë i hedh kripë plagës së quajtur “Palestinë”...

Për çka në të vërtetë është fjala? Luftë e vërtetë shpërtheu mes gazetave (mediemeve, portaleve) izraelite dhe atyre suedeze kur gazeta më e madhe suedeze “Aftonbladet” më 26 gusht të këtij viti, botoi një tekst ku gazetari Donald Bostrom shkruante dhe bënte thirrje për një hetim për skandalin ndërkombëtarë të tregtisë me organe dhe ku organet janë gjetur nga ana e IDF-së (Forcat Mbrojtëse Izraelite). Vini re!? Lexoni me kujdes: Organet janë nxjerrë nga djemtë dhe vajzat palestineze qoftë para apo pas vrasjes nga ana e IDF-së (në protesta, përleshje, etj.) Viktimat e rinj, pas likuidimit sipas procedurës dërgohen në spital për shkak të gjoja obduksionit, ndërsa më vonë i kthehen familjes “anëmbanë të qepur” Dyshimet për vjedhjen e organeve, respektivisht vrasjes për shkak të nxjerrjes së organeve (çfarë është ndërtimi i vendbanimeve në krahasim me këtë krim?) janë shfaqur për herë të parë qysh në vitin 1995.

“Mund të më quani si “shkues” (matchmaker) - ka thënë Levy Ishak Rosenbaum, nga Brooklini, SHBA, në një bisedë të incizuar me agentin e FBI-së për të cilin kishte besuar se është klient. Dhjetë ditë më vonë, nga fundi i korrikut të këtij viti Rosenbaum është arrestuar në New Jersey pas një afere me pastrim të parave dhe të tregtisë me njerëz: rabinë, politikanë, zyrtarë të besueshëm civil janë të inkuadruar në pastrim të parave dhe në tregtinë ilegale me organe.

“Mblesëria e Rosenbaumit nuk kishte asnjë lidhje me



romancën. E tërë puna e tij ishte e lidhur me shitjen dhe blerjen e veshkave nga Izraeli në tregun e zi.“ - shkruan Bastrom në median suedeze “Aftonbladet.“ Ai përmend se në fillim të viteve 90- ta deri sa Ehud Olmert ishte Ministër i Shëndetësisë, filloi fushata e regjistrimit të donatorëve të organeve me qëllim të ngritjes së vetëdijes për dhurimin e organeve. Ç’është e vërteta, fushata në fillim dha rezultate të caktuara, por dallimi mes kërkimit dhe dhurimit të organeve edhe më tej do të mbetet i pandryshuar. Dhe, çka në të vërtetë pasoi?!

Nëse Izraeli do ti kishte të gjitha zgjidhjet nuk do të duhej të pritet kaq shumë. Është e nevojshme vetëm të hidhet një sy në memoaret e viktimave të holokaustit dhe të lexoj tregimet mbi vuajtjet e hebrenjve që u nënshtruan nga ana e nazistëve. Pra, llamba nuk duheshë që aq shumë të shkëlqej - që mendja e prishur të ndjej atë që Bastrom e zbuloi dhe ia botoi publikut të gjerë.

### ZHDUKJA E PALESTINEZËVE TË RINJ

“Dhe deri sa fushata kalonte, nga fshatrat e Bregut Perëndimorë filluan të zhduken të rinjtë palestinez. Pas pesë ditëve ushtarët izraelit i kthenin të vdekur, me trupa të prerë dhe më pas të qepur. Tregimi për këta trupa i tmerroi banorët e territoreve të okupuara. U përhapën fjalë për një numër dramatik të të zhdukurve, gjë e cila bëri që të ndiqen varrimi i trupave të bërë gjoja autopsi natën.” - shkruan Bastrom. “Në atë kohë”- shton gazetari suedez, “ isha në rajon duke e punuar librin, dhe në disa raste më afrohej një numër i caktuar i njerëzve nga OKB-ja, të cilët tregonin brengën e tyre për zhvillimin e ngjarjes. Personat që më kanë kontaktuar treguan se ka pasur vjedhje të organeve, dhe se atyre u është ndaluar të ndërmarrin diçka në lidhje me këtë. Me detyrë të një Radio-Televizioni kam udhëtuar gjithandej duke intervistuar një numër të madh të familjeve palestineze në Bregun Perëndimorë dhe në Gazë; duke u takuar me prindërit të cilët thoshin se djemve të tyre u janë marrë organet para se të vriten.” Bastrom si shembull tregon edhe fotot e Bilal Ahmed Ghani, një palestinez i ri i cili duke hedhur gurë ndaj forcave izraelite në një protestë, u vra në pritë dhe të cili më pas i merret trupi, kurse kur i është kthyer familjes, trupi i tij kishte qenë i prerë dhe i qepur deri në fyt.

Me afëra të tilla, si marrja e organeve, vrasja për qëllime të tilla, paralajmërimet për ndërtimin e vendbanimeve të reja dhe prishja e premtimeve të Këshillit të Sigurimit nga ana e Izraelit, krijimi i kushteve për procesin paqësorë duket naiv. “Qartë shihet se në Palestinë në esencë po bëhen krime sikur askund tjetër në botë, ashtu që, sikur përveç kësaj, është unike edhe natyra e okupimit të kësaj toke në mbarë historinë njerëzore.” - është shprehur në mënyrë të shkëlqyer kohë më parë në një intervistë dijetari i njohur Dr. Jusuf Kardavi.

“Të gjithë muslimanët në botë janë të obliguar të japin kontributin e tyre për çlirimin e Palestinës... Dëshiroj t’ua tërheq vëmendjen të gjithë njerëzve se okupimi dhe kolonizimi i Palestinës nga ana e Izraelit është diçka shumë e ndryshme nga ajo që shohim në të gjithë botën!” - deklaroi më tej Dr. Kardavi, duke sqaruar, se për dallim nga okupimet dhe kolonizimet tjera që janë të përkohshme, okupimi dhe kolonizimi që e ka bërë Izraeli është me të vetmin qëllim: Qëndrimin e gjatë pa marrë parasysh koston e çmimit!

Dhe nga këtu muslimanëve të sotëm u qoftë për hajr edhe 30 (apo 300 ) vjet luftë për Kuds, duke shpresuar në një sukses të madh!

**Nga boshnjakishtja:  
Arsim Dauti**

burimi: [www.preporod.com](http://www.preporod.com)

## QASJE

# E PO, KU SHKOJMË?!...

“Zoti nuk e ndërron gjendjen e një populli, përderisa ai popull nuk e ndërron gjendjen e vet...” (Er-Rrad, 13).

Ahmed R. Ramadani

Sot, në kohën e rrjedhjes dinamike të gjërave, në kohën e kalimit të çështjeve, dukurive, gjendjeve, trendëve apo kaheve nga një skajshmëri në skajshmërinë tjetër, përkatësisht nga një ekstrem në ekstrem tjetër, në mjedisin tonë ndodhin gjëra, dukuri a fenomene (në kuptimin negativ të fjalës) të cilat fare pak apo thënë më mirë hiç nuk na e tërheqin vëmendjen, po bile për disa as që çajmë kokën, thuaja se ato nuk ndodhin apo ekzistojnë, d.m.th. gjërat, dukuritë posa nxjerrin krye menjëherë marrin “vizë” pa problem në shoqërinë tonë, bëhet si të thuash një “ambientim” me to dhe më pas ato vërshojnë në segmentet e çdo pore të shoqërisë dhe përhapen me të madhe e mbijnë tamam si kërpudhat pas shiut, dhe më pas nuk ngurrojmë të japim “një mijë e një” argumente se “kjo” po bile edhe “kjo” është “traditë” e moçme kaherë e jona, por ja që okupimi (sic!) e ka bërë të veten dhe ne tani po e “zbulojmë” - d.m.th. po i kthehemi rrënjëve tona “autentike”... Ç’e do që “argumentet” (i thënçim argumente) nuk pinë ujë dhe janë ndër më anakroniket dhe më të palogjikshmet bërë ndonjëherë.

Në mijëvjeçarin e tretë që veç më ka vite që e kemi shkelur, ne siç duket vazhdojmë të jetojmë me bagazhin e mykur, assesi t’i hapim sytë dhe të shohim se ja veç më kanë filluar krimbat ta gërryejnë substancën tonë, të cilën vetëm një Zot e di se kur dhe ku e kanë mbarimin...

Kuptohet dhe është krejtësisht e qartë se okupimi një shekullor sllav dhe luftërat e fundit në këto hapësira e kanë



bërë të veten dhe kanë lënë gjurmë apo trauma të pashërueshme dhe plagë të thella të cilat akoma vazhdojnë të kullojnë gjak... Por, kjo është nga i huaji, që qartë nënkupton se i huaji përveç gjakut, vdekjes, vajit dhe lotëve asnjë peshqesh tjetër nuk mund të të sjelli...

Mirëpo, kahe në urtësinë filozofike të popullit është thënë: **“Atë që ia bën vetvetes-askush nuk mund të ta bëjë”** - nga ku sheshazi duket se fillon rruga e tatëpjetës sonë, që mjerisht kemi filluar ta marrim, druaj se pa kthim...

Ideologjitë e ndryshme e të mugëta, trendët dhe kahe të cilat me të madhe po vërshojnë mbarë globin e po përhapen dita-ditës në çdo rajon të botës, kuptohet që nuk kanë lënë pa e përshkuar edhe nën-qiellin tonë...

Sot, në kohën e sfidave nga më të ndryshmet, ne, si të thuash jemi bërë gati fenomen në vete. Kemi filluar të rrugëtojmë një rrugë që fare s'e dimë ku e ka zanafillën e m'o Zot më keq - aq më tepër se ku mbarimin, apo cili në të vërtetë është stacioni ynë i fundit...

T'ia nisim nga shtylla kryesore e një populli: MORALI.

**“Moral i është themeli i kombeve”** - thotë një fjalë e urtë. Derisa në të kaluarën ne shquheshim për virtyte dhe moral të lartë e të shëndoshë, realiteti jetësor i sotshëm, mjerisht na jep një tablo rrëqethëse: Ajka e kombit, shtylla kryesore që e mban gjallë një popull MORALI - ka fituar erozion dhe lëkundje të rëndë sa që vetë themelet e ekzistencës sonë fort janë tronditur. Në mjedisin tonë shfaqen gjëra apo dukuri që kurrë nuk kanë qenë traditë e jona e as që stërgjyshërit tanë kanë pasur njohuri për to...

Vërtet për çfarë bëhet fjalë? Fjala është për dukuri të errëta që nga dita në ditë si lumi po vërshojnë mes nesh.

Këto ditë të kësaj vere që lamë pas, ishim dëshmitarë të zhvillimit me të madhe të manifestimeve të ndryshme gazmore, s'do mend se plotësisht është e natyrshme që pjesëmarrësit t'i gëzohen

dhe këndojnë gazmendit të tyre, mirëpo ajo që fatkeqësisht bie në sy dhe tërheq vëmendjen është mënyra se si po manifestohen tërë këto.

Harxhimet e pavend në këtë kohë krize globale e skamjeje, defilimet e tyre rrugëve të qytetit si të çoroditur, lakuriq e të zhveshur... Janë dukuri këto, që për një çast duhet të na stopojnë, të mendojmë thellë një çikëz dhe të pyetemi në ndërjegjen tonë: Vallë a ka qenë traditë e jonë që vajza shqiptare-myslimane ta ekspozoj trupin lakuriq në mes të rrugës para një turme të tërë njerëzish?

O Zot, o Zot! Brenda natës po na rrënohen vlerat për të cilat dikur mburrehim para botës dhe të tjerët na merrnin si model të paprekshmërisë familjare.

Shundi, kiçi, pseudo-vlera, mediokriteti, ideja e shijimit dhe konsumimit të gjithçkaje, mania e hapjes para çdo të huaji, janë gjëra këto që po marrin hov me të madhe në mjedisin tonë. Lakmia për gjithçka sa vjen e shtohet, harrojmë se: **“Lakmia është një pus pa fund, që e ezauron personin, në përpjekjen e parreshtur për të kënaqur nevojën pa e arritur kurrë kënaqjen.”** (Erich Fromm).

Ndjekja e epshit, për të cilin Platoni thoshte: **“Valuptas omnium maxime vanilaqua.”** (“S'ka gjë më boshe se epshi.”) - është në kulminacion. Në mjediset tona urbane e veçanërisht në ato rurale (fshatrat tonë) me popullatë puro shqiptaromyslimane, rendin një pas një (thua se garojnë kush më shumë) caffè-baret e natës me “bukuroshet” shqiptare, sllave, aziatike e djalli ta dijë se çfarë-të cilat u ofrojnë klientëve të vet (të rinjve tanë) “mish të bardhë” duke denigruar kështu tërësisht çdo normë, moral apo vlerë jo vetëm kombëtare e fetare, po madje edhe etike njerëzore... Nuk ka kurrfarë dyshimi se tërë kjo është idiotizëm, çmenduri, destruktivitet dhe dukuri e shëmtuar, do të thosha *sui generis*.

Dhe, gjërat vazhdojnë të ecin me monotoninë e zakonit: Pra defilimi lakuriq i vashave rrugëve të qytetit dhe më gjerë, caffè-baret e natës me striptize në mes të fshatit - janë “virtyte” tona apo çka? E po, ku jeni burra, ku? **“Pra ku jeni, kah shkoni?!”** (El-Enfalë, 26).

Pra, themeli i popullit: MORALI - thellë është lëkundur. Mirëpo, ja që të gjithë heshtim, thua se këto që i përmenda më lartë po ndodhin diku larg nesh, e jo aty te rruga, lagjja, te pragu ynë. Heshtim, siç duket harrojmë postulatit: **“Heshtja është pajtim (miratim).”**

Heshtin intelektualët, “truri i kombit” është i “zënë me punë madhore”; lëviz siç duket një hap para e dy prapambase është tepër i “zënë” me “fatet e mëmëdheut” dhe rrah ujë në havan duke debatuar për “shansin a momentin historik të kthimit te rrënjët, gjegjësisht konvertimin në të krishterë, fenë e të parëve tanë” (sic!!) apo diskutojnë “tragjedinë që i ndodhi popullit tonë që nga dita kur pranoi Islamin-këtë incident tragjik” dhe hedhja gurë e drurë në adresë të Islamit, thua se ai na qenka fajtori kryesor për dështimet tona të një pas njëshme.

Turp i pashembullt që një çetë “intelektualësh” komplet të vihet në krye të një fushate denigruese, përcmuese e të egër anti-islame, d.m.th. “elita” e popullit ta shajë, fyejë e përbuz fenë e vet, ta mohoj identitetin shpirtëror e kulturor të vetin, pra ta sulmosh fenë tënde d.m.th. ta mohosh vetveten tënde dhe të dalësh jashtë lëkurës tënde (siç duket ne edhe në këtë aspekt nuk hezitojmë të japim fenomenin e më të çuditshmëve në botë...)

Nga ana tjetër heshtin edhe pedagogët, këta të fundit të cilët do të duhej të ishin kuruesit e shpirtit, heshtin... Heshtin sepse edhe këta merren me “çështje madhore intelektuale” dhe i ka kapluar mania e të qenit në poste (dekanë, rektorë, a kushedi se çka), heshtin se mjerisht i ka trullësuar materializmi (paraja), mbase kishte të

drejtë bejtexhiu ynë Hasan Zyko Kamberi i cili para dy shekuj e gjysmë fort bukur i shprehi vargjet:

**Dhe pashallarë, bejlerë  
Edhe avamë të tjerë  
Për para apënë krerë  
Ja di kimenë parasë**

Heshtin, heshtin dhe assesi të luajnë rolin për të cilin edhe janë zotuar se do ta kryejnë: Kahëzimin e drejte të popullatës... heshtje pas heshtjeje, dështim pas dështimi, zhgënjim pas zhgënjimi...

E, retë e zeza vazhdojnë edhe më tej ta mbushin qiellin tonë sipas asaj: Pas stuhisë...përsëri re të zeza...

Ne, mjerisht nga dita në ditë po zhbëhemi, po tretemi dhe rrokullisemi në greminë, thjesht kemi arritur gjer atje sa që nuk mund ta ndajmë shapin nga sheqeri, gjegjësisht të keqen nga e mira. Punët siç venë, druaj se do të dal për të mbarë, asnjë lëmi nuk ka mbetur immune nga sindromi i përçarjes, meskitetit apo pseudovlerës, thjesht është ngatërruar lëmshi dhe assesi të zgjidhet...

Me te drejtë lind pyetja: Çka më tej? Kuptohet së pari duhet bërë një **spiritual catharsis** dhe kthim në vetvete, përndryshe e nesërmja do të vije gjithqysh, por ndofta ne gjithçka tjetër do të jemi, por vetëm vetvetja jonë jo... **“Zoti nuk ne ndërton gjendjen e një populli, përderisa ai popull nuk e ndërton gjendjen e vet...”** (Er-Rrad, 11).

Ky shkrim imi modest nuk pretendon për t'i thënë të gjitha, përkundrazi... Është vetëm një ofshamë, por ofshama e së sotmes, megjithatë është paralajmërim i gjëmimit të së nesërme.

**“Ndryshoje veten - të ndryshohet historia; Ndryshoni vetveten tuaj - ta ndryshojë Zoti gjendjen tuaj!”** (Jusuf Kardavi).

Ndaj, pas gjithë kësaj, me të drejtë shtrohet pyetja: **E po, ku shkojmë, ku?!...**

# Format e muzikës fetare (1)

Mr. Abas Jahja

Që nga kohërat e lashta muzika ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën e njeriut. Gjatë ritualeve fetare muzicentët luanin rol shumë të rëndësishëm në ngacmimin e ndjenjave shpirtërore. Format muzikore mund të klasifikohen në disa lloje: vokale, instrumentale, fetare, jofetare, klasike, folklorike, etj. Nëse analizohen të gjitha këto forma për secilën formë mund të shkruhet artikull i veçant, por neve këtu më së tepërmi na intereson muzika fetare dhe format e saj.

Format e muzikës fetare ndahen në tre grupe:

- a- format muzikore të xhamisë;
- b- format muzikore të teqesë dhe
- c- format e përbashkëta që përdoren edhe në xhami edhe nëpër teqe.

## FRYMË MISTIKE DHE MEDITUESE

Para se të flasim për format muzikore të xhamisë shkurtimisht t'i themi disa fjalë në lidhje me muzikën e teqesë. Lloji i muzikës që ekzekutohet nëpër teqe me qëllim të ngritjes shpirtërore e quajm muuzikë mistike (tasavuf). Sipas sufijve muzika luan rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes së njeriut dhe shërben si urë për afrimin e njeriut me Krijuesin.

Në këto forma muzikore zotëron një ritëm dhe harmoni e lartë shpirtërore. Po ashtu edhe në tekstet e këtyre formave ka një frymë mistike dhe medituese. Në zikret ose me fjalë tjera, në ritualet e disa tarikateve këto forma prezentohen pa vegla muzikore ndërsa në disa tarikate hasim edhe përdorimin e veglave muzikore. Muzikën e tasaavufit (mistike) në mënyrë më profesionale dhe artistike e kanë interpretuar rendi i tarikatit MEVLEVÎ.

Format e këtyre komponenteve muzikore quhen

“**Mevludi:** Ditëlindja e Pejgamberit a.s, ka motivuar myslimanët që të përkujtojnë të dërguarin e Allahut xh.sh. dhe kjo me kalimin e kohës është bërë shkak që myslimanët të bëjnë manifestime për hirë të kësaj dite. Manifestimi i parë në historinë Islame ka ndodhur në Egjipt në vitin 1207-1208 në kohën e Muzafferuddin Gokbori. Në këtë manifestim ka marrë pjesë edhe dijatri i mirënjohur nga Spanja në lëminë e hadithit Ibni Dihje dhe e ka lexuar mevludin e parë në histori “Kitabu Tenvir fi mevlidis- siraxhil munir”.

“Mevlevij Ajini”( rrotullimet e Mevlevijëve). Këto forma muzikore janë format më artistike dhe më madhështore të muzikës mistike. Këto rituale njëkohësisht quhen edhe SEMÂ.

Tekstet e këtyre komponenteve janë marrë nga veprat e mistikut të madhë Mevlana Xhelaludin Rumi në mesin e të cilëve janë: Mesnevi dhe Divani Kebiri, të cilat i ka shkruar në gjuhën Persishte.

Më lartë tham se këto rituale karakterizohen edhe me emra tjerë si Sema, Mukabele dhe Ajini Sherif të gjitha këto sintagma kanë domethënie të rrotullimit të Mevlevijve gjatë shfaqjes së ritualeve.

Semaja përbëhet prej katër pjesëve dhe secila pjesë emërtohet më emrin SELÂM.

Brenda katër selameve përdoren ritme dhe mekame të ndryshme muzikore.

## FORMAT MUZIKORE TË XHAMISË

Format muzikore të xhamisë me këtë nënkuptojmë se një musliman i cili hynë në xhami për ta adhuruar Allahun xh.sh, padyshim se dëgjon një zë nga imami dhe muezini e kjo është muzikë (vokale) që ekzekutohet nga ana e Imamit dhe muezinit.

Sipas kësaj që thamë deri më tani muzika e xhamisë përbëhet nga Ezani, Ikameti, Leximi i Kuranit (Tilaveti), leximi i Ihlasi sherifit, Tesbihatet, Duaja dhe leximi i Ashereve.

Por, duhet të dijmë se sipas nevojës dhe rasteve të

ndryshme dallojmë edhe forma që vijojnë: Salati, Mevludi, Tesbihi, Tevshih, temxhid, Na't, Tekbiri, Ilahi, Shugël dhe Mi'raxhije. Në lidhje me këto forma do të flasim në artikujt që vijojnë.

Në disa raste dhe vende kemi lexim të më tepër se një muezini që në terminologjinë e muzikës fetare quhet **Xhumhur** (muezinllëk i përbashkët), por kohëve të fundit kjo formë e muezinllëkut nuk praktikohet në trevat tona.

Karakteristika e muzikës në xhami qëndron në atë se për bazë merret zëri i njeriut dhe se brenda në xhami nuk përdoren veglat muzikore.

Shkaku kryesorë për nevojën e lindjes së muzikës fetare është vetë jeta fetare. Prej lindjes e deri në vdekje muzika është prezent në jetën e njeriut. Ne jemi dëshmitarë se kur lind njeriu gjatë ceremonies së emërtimit të tij i lexohet ezani, pastaj kur e vëndojmë në gjumë foshjën përsëri i këndojmë këngë djepi për ta zënë gjumi më lehtë foshnjën. Më pas vjen synetimi, martesja dhe më në fund kur vdes njeriu përsëri lexohet salati, realizohet falja e namazit të xhenazës dhe në fund lexohet telkini.

Duhet të cekim në veçanti se në kalendarin tonë hixhrij ekzistojnë ditët dhe netët e caktuara ku muslimanët me rastin e këtyre ditëve dhe netëve organizojnë manifestime edhe tubime të ndryshme fetare.

Prej këtyre veçojmë:

-**Dita e Ashures**, ky muaj është muaji i parë i kalendarit hixhri, në ditën e 10 të këtij

muaji kë rënë shehid (dëshmorë) hazreti Huseini r.a., në këtë ditë është pranuar pendim i hazreti Ademit, ka shpëtuar anija e Nuhut a.s., shpëtoi hazreti Ibrahim nga zjarri i Nemrudit, hazreti Jakupi është takuar me të birin e tij Jusufin pasi që kishte humbur gjatë kohës, në mes tjerash hazreti Aisheja dhe Abbasi r.a. transmetojnë se në këtë ditë ka agjëruar i dërguari i Allahut xh.sh dhe ka preferuar që të agjërohet kjo ditë.

**Mevludi:** Ditëlindja e Pejgamberit a.s, ka motivuar myslimanët që të përkujtojnë të dërguarin e Allahut xh.sh. dhe kjo me kalimin e kohës është bërë shkak që myslimanët të bëjnë manifestime për hirë të kësaj dite.

Manifestimi i parë në historinë Islame ka ndodhur në Egjipt në vitin 1207-1208 në kohën e Muzafferuddin Gokbori. Në këtë manifestim ka marrë pjesë edhe dijatri i mirënjohur nga Spanja në lëminë e hadithit Ibni Dihje dhe e ka lexuar mevludin e parë në histori “Kitabu Tenvir fi mevlidis- siraxhil munir”.

**Miraxhi:** Nata e 27 e muajit Rexheb, ngritja e Muhamedit a.s në sferat qiellore, ngjarje e cila ka qenë arsye që myslimanët të përkujtojnë edhe ta festojnë këtë natë madhështore. Më vonë edhe kompozitori i madhë Naji Osman Dede do të kompozojë një formë të veçantë muzikore që e përshkruan ngritjen e Muhamedit a.s. Kjo formë muzikore është një ndër format më të gjata të muzikës fetare.

**Ramazani:** Është muaji i nëntë hixhrij i cili muaj zë një vend të posaçëm në jetën e myslimanit. Në këtë muaj xhamitë mbushen përplot me besimtarë dhe padyshim aktivitetet e besimtarëve janë të gjallëruar. Posaçërisht leximi i Kuranit, falja e namazit të Teravisë, leximi i Ilahive të ndryshme, leximi i Temxhideve, Munâxhateve dhe forma tjera të muzikës fetare.

# Mungesa e vullnetit politik, pengesë për denacionalizim

*“Vendimi politik për të implementuar procesin e denacionalizimit ishte një motivacion se do të përmirësohet padrejtësia që iu shkaktua qytetarëve dhe bashkësive fetare nga një sistem totalitar. Mirëpo pas 10 vjetësh proces denacionalizimi të gjithë ndjehemi të tradhtuar”.*

**Driton Dikena**

Procesi i denacionalizimit në Maqedoni, zvarritet në mënyrë të padrejtë, gjë e cila

e konfirmon përshtypjen e përgjithshme se shteti nuk ka qëllime të mirëfillta për ta zbatuar tërësisht procesin e denacionalizimit brenda afatit të paraparë, periudhë

kohore e cila tanimë ka skaduar, ndërkohë që nuk janë zgjidhur as gjysma e lëndëve. Kjo ishte konkluzja e debatit në Shkup në temën “Denacionalizimi- e drejtë pronësore” e cila u organizua nga Instituti për të drejtat e njeriut në bashkëpunim me zyrën e Bashkimit Evropian në Shkup dhe Ambasadës së Hollandës.

Sipas debutuesve, vendimi politik për të implementuar procesin e denacionalizimit ishte një motivacion se do të përmirësohet padrejtësia që iu shkaktua qytetarëve dhe bashkësive fetare nga një sistem totalitar. Mirëpo pas 10 vjetësh

proces denacionalizimi të gjithë ndjehemi të tradhtuar, sepse zbatimi i procesit të denacionalizimit, me një temp të këtille të punës mbetet të realizohet në një periudhë

plotësuese, ngaqë në mënyrë permanente dhe në rrethana të pashpjegueshme, pa arsye nuk përfillen normat me karakter imperative.

Fidanço Stojçev, profesor universitar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Shkupit nuk shprehet i habitur për vonesën e sjelljes së vendimeve për sa i përket denacionalizimit.

“Ligji i miratuar që në fillim ishte shumë kontrovers dhe solli shumë kundërshti. Vetë miratimi i tij në një periudhë kohore prej tre vitesh të jep përshtypjen se diçka pas shpine po zinte”, thekson Stojçev i cili shton se shteti asnjëherë në qëndroi në krye të detyrës që tu kthej pronarëve legjitim të shpronësuar në forma të ndryshme.

Ai shton se vonesa e ligjit mbi

tre vjet deri në miratim dëshmoi se qëllimi kryesorë i shtetit ishte që Ligjin për denacionalizim ta fusë nën hijen e Ligjit për privatizimin e pronave shtetërore.

## PRIVATIZIMI FUTI NËN HIJE DENACIONALIZIMIN

Stojçev tha se me Ligjin për privatizim e pronës shtetërore, shteti bëri edhe një nacionalizim klasik duke e shitur pronën e huaj tek personat fizik më pas la vetëm një pjesë të vogël të pronës që tu kthehet pronarëve legjitim.

Profesori universitar tha se edhe vetë Ligji i denacionalizimit të pronave brenda për brenda ka shumë kundërshti dhe kufizon të drejtën e qytetarëve dhe bashkësive fetare të kërkojnë pronën e tyre.

“Problemi i parë është procedural. Një subjekt fizik apo juridik që të kërkojnë pronën e tij duhet të posedojë tapinë apo

dokument që do të tregonte pronësinë, Aktin e marrjes së pronës dhe shtetësinë. Dhe mu këtu qëndron problemi. Me të madhe mungojnë Aktet e marrjes së pronës sepse pjesa më e madhe e pronës është marrë pa bazë juridike në fakt është uzurpuar dhe duke munguar ky Akt subjekti fizik dhe juridik nuk ka se sit a dëshmojë se ajo pronë i është marrë atij”, interpreton Ligjin për denacionalizim Stojçev.

Më pas shton si, në bazë të vetë ligjit kthehet vetëm prona jo ndërtimore dhe kjo kthehet vetëm nëse deri në sjelljen e Ligjit për denacionalizim ajo pronë nuk ka kaluar deri tek personat fizik ose juridik.

“Ky është problemi i dytë sepse me vetë Ligjin për privatizim pjesa më e madhe e pronës shtetërore kaloi në pronësi të personave fizik dhe tani pronarëve të vërtet u është marrë e drejta që të kërkojnë pronën e tyre”, potencoi Stojçev.

Ai kritikoi disponimim politik



të shtetit i cili asnjëherë nuk është treguar i bindur që të kthej pronën.

“Dhe nëse me të vërtetë ndonjëherë ka ekzistuar vullneti politik atëherë pa dyshim se fajin duhet ta kenë Komisionet për denacionalizim në kuadër të Ministrisë së Financave sepse ato pengojnë ato. Dhe nëse komisionet do të tentonin të shfaqësinin veten atëherë duhet Ministria e Financave të bëjë një analizë se ku çalon procesi i denacionalizimit i cili edhe pas dhjetë vitesh është në pikën zero”, përfundoi Stojçev.

### KOMISIONET MË SHUMË BUXHET SE PRONARËT LEGJITIM

Në anën tjetër Vanja Mihajlova, ekspert i pavarur për antikorruption, sqaroi për aspektin ekonomik të vetë procesit të denacionalizimit.

Ajo kritikoi Ministrinë e Financave dhe Komisionet për denacionalizim që janë treguar të shurdhër në kërkesën e asaj për sa i përket se sa buxheti i shtetit është i rënduar për 10 vjet proces të denacionalizimit.

“Nëse të gjithë anëtarët e komisionit marrin një paushall prej 8 mijë denarësh dhe për çdo vendim secili anëtarë merr nga 400 denarë plus atëherë shtrohet pyetja se shteti ku harxhon më shumë buxhet tek prona që duhet të kthehet apo tek anëtarët e komisioneve. Sipas një matematikë kam frikë se shteti më shumë harxhon për komisionet sesa për kthimin e pronave tek pronarët e vërtetë”, theksoi Mihajlova e cila shtoi se krahas asaj procedura zvarritet pa arsye, organi për denacionalizim vazhdon t'i shmanget obligimit për ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e aktvendimeve të plotfuqishme për denacionalizim dhe dorëzimin e pronës së kthyer në zotërim të drejtpërdrejtë të pronarëve të mëparshëm, përkatësisht trashëgimtarëve të tyre juridikë.

Edhe Avokati i popullit Ixhet Memeti, kritikoi shtetin i cili është treguar i shurdhër për përfundimit e procesit të denacionalizimit. “Edhe pas 10 vitesh karakteristike e procedurës së denacionalizimit janë joefektiviteti, joracionaliteti, jofunksionaliteti dhe moskryerje me kohë e punëve,

me tendencë të theksuar për pengimin e realizimit të të drejtave dhe interesave të drejtpërdrejta ligjore të palëve në procedure. Vazhdon të ketë avashllëk, burokraci e theksuar dhe shkallë e lartë e subjektivitetit gjatë procesit të procedurës administrative. Ka sjellje jokoperative dhe joprofesionale ndaj subjekteve të përfshira në procedurë që shkakton pasoja të dëmshme për qytetarët – palë në procedure, vazhdon të mbizotërojë zbatim jo i barabartë i rregullave dhe ngjashëm”, thekson Memeti.

Sipas tij procedurën dukshëm e ndërlikojnë dhe zvarrisin edhe vetë komisionet brenda Ministrisë së Financave, të formuara me qëllim të dhënies së këshillave për çështje të caktuara, por që nuk kanë karakter vendimmarrës sipas kërkesave për denacionalizim, të cilët vetë vlerësojnë për vendimmarrje ligjore të lëndëve. Gjithashtu sipas tij, zvarritjen e bëjnë edhe organet e organizatat e tjera të shtetit që kanë autorizime publike dhe që janë të përfshira në procedurën e denacionalizimit.

“Në të vërtetë, të gjitha vendimet në formë të projektvendimeve ose konkluzioneve për shkak të miratimit të tyre, së pari detyrimisht duhet të dërgohen deri te i ashtuquajtur Komision për kontroll, i cili vërejtjet e tij i jep pa kurrfarë forme dhe përmbajtje. Ai këtë e bën në një letër të rëndomtë, në të shumtën e rasteve me tekst të shkruar me dorë. Nuk janë të rralla rastet kur nga disa herë, vite me radhë ky komision sugjeron që kërkesat për denacionalizim të refuzohen si të pabaza ndonëse është më se e qartë se një vendim i tillë do të ishte rezultat i zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dispozitive që parashikohen me Ligjin për denacionalizim, me çka vërtetohen interpretimet juridike të paraqitura nga organi i shkallës së dytë ose nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, e që jepen në kontekst të vendimeve të marra sipas ankesave ta paraqitura ose padive për konteste administrative për lëndët me gjendje të njëjtë ose të ngjashme faktike dhe juridike të punëve”, thekson Memeti.

## QASJE

# INDIFERENTIZMI INTELEKTUAL RREZIK I MADHË SHOQËROR

Shaqir Fetahu

sipërfaqen tokësore.

### FEJA DHE SHKENCA

Njeriu në makro dhe mikroplan paraqet qendrën rreth të cilës rrotullohet gjithçka. Ai është i vetmi në gjendje ta vështrojë botën, ta kuptojë atë dhe ta ndryshojë në aspekt pozitiv apo negativ. E bënë këtë për arsye se tek ai janë të qëndisura dy botëra; spiritualja dhe materialja. Kjo e vërtetë, pra jep sinjal për aftësinë e njeriut për të reflektuar rreth e përçark botës dhe ta ndryshojë atë varësisht nga qasja e tij dhe qëndrimi i tij.

Për këtë Kur'ani Famëlartë – Fjala e Zotit në qendër të vëmendjes ka njeriun, formimin e tij për të vepruar në botë. Kjo ndodh mu për shkak të mundësive të njeriut për të ndikuar në rrjedhat e botës në përgjithësi. Ai ka mundësi të madhe konstruktive, falë aftësisë për të menduar dhe kuptuar dhe për ta ndryshuar botën kah e mira, duke i dhënë asaj kuptim të vërtetë. Ky pozicion është hyjnorja tek njeriu, kulminantja tek ai, që e arrin definimin hyjnor të njeriut halifetull-llahu fil erdi – mëkëmbës i All-llahut në tokë.(II:30). Ky pozicion i lartë është edhe qëllim kryesor i krijimit të njeriut si qenie më e dalluar në mikro dhe makroplan, që do të thotë, pozicion për t'i dhënë vendin e vet të vërtetët çdo sendi, krijese, individ, fenomeni, etj. Aq është i rëndësishëm ky fenomen, sa që në këtë është i lidhur ngushtë dëshira, vullneti i Krijuesit, i Cili duke i folur në mënyrë permanente njeriut, pandërprerë është në kujdesin e njeriut, nën mbikëqyrjen e veprimit të tij, në kontakt të fuqishëm me të dhe në bisedë të përhershme me të. Ky intervenim i hyjnorës nëpërmes Fjalës së Tij të zbritur prej njeriut dhe pejgamberit të parë Ademit a.s. e deri tek pejgamberi i fundit Muhamedi a.s. e ndoqi njeriun dhe njerëzimin prej momenti të parë të shfaqjes së tij në

Kjo ndodhë, nga shkakut se njeriu, megjithatë është krijesë e harresës, e keqbërjes, rrëshqitjes, egoizmit, mëkatit, destruktives, etj. nga shkakut se tek njeriu ndodhë që materialja ta robërojë atë duke e dërguar në rrugë që nuk i takon atij dhe që nuk është qëllimi krijimit të tij. Njeriut, përveç që i besohet pozicioni i lartë nga All-llahu i plotfuqishëm, ai vendoset edhe në procesin e fuqishëm të edukimit hyjnor, nga projektuesi hyjnor All-llahu i Fuqplotë, edhe atë edukim universal i të gjitha natyrave që e përshkojnë njeriun, atë intelektual, filozofik, psikologjik, artistikë etj. Edukim ky që është i patjetërsueshëm në skenën njerëzore. Pa këtë edukim nuk ka mundësi të lëviz njeriu në krijimin e jetës së begatshme, të lumtur dhe humane. Jo vetëm librat e shenjta, por edhe vet historia, tregon për sakrificat e njerëzimit në luftën e paparë për të zbukuruar, edukuar, ndryshuar botën në të gjitha sferat e jetës. Librat e shenjta përmendin të dërguarit e All-llahu të cilët kanë sakrifikuar gjithçka për kultivimin e të mirës në botë, pa kërkuar asfare shpërblimi në këtë jetë, ata karakterizohen me skamje e varfëri, vështirësi dhe pengesa të vështira në jetë, dhe përfundim të mundimshëm, dhe të paparë, por krenar në jetë dhe të vetëdijshëm se i kontribuuan zhvillimit të rrjedhave pozitive në botë.

Feja, si sistem edukativ hyjnor, jep rrugën kryesore për formimin e njeriut i cili do të trasoi rrugën e edukimit të njerëzimit në përgjithësi.(XVII:9) Ajo, këtë tip të njeriut e sheh nëpërmes të vlerës së njohjes, dijes, ngritjes intelektuale, i cili duhet ta njohë dhe kuptojë botën për ta ndryshuar atë. Feja, pra, kërkon njeriun, i cili para së gjithash

*“Feja, pra, kërkon njeriun, i cili para së gjithash duhet të realizojë në jetë parimin leximit dhe studimit (ikre’) të patjetërsueshëm dhe shënimit shkrimit (uktub). Që të dy këto parime sjellin deri tek njohja e vërtetë që quhet Ilm – shkencë. Pa këtë fenomen vjen dështimi i njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi. Vet termi halifetuull-llahi fil erdi – mëkëmbës i Zotit në tokë, nënkupton qenie me dije dhe vetëdije të lartë, kujdes të veçantë, përgjegjësi të nivelit të lartë, udhëheqësit të vërtetë për rrjedhat e kohës dhe vendit në të gjitha sferat”.*

duhet të realizojë në jetë parimin leximit dhe studimit (ikre’) të patjetërsueshëm dhe shënimit shkrimit (**uktub**). Që të dy këto parime sjellin deri tek njohja e vërtetë që quhet Ilm – shkencë. Pa këtë fenomen vjen dështimi i njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi. Vet termi **halifetuull-llahi fil erdi** – mëkëmbës i Zotit në tokë, nënkupton qenie me dije dhe vetëdije të lartë, kujdes të veçantë, përgjegjësi të nivelit të lartë, udhëheqësit të vërtetë për rrjedhat e kohës dhe vendit në të gjitha sferat. Të këtillë e krijoi Zoti, në formën më të bukur fiziko-shpirtërore(XCV:4). Vet krijimi i këtillë jep kohen e përgjegjësise njerëzore për të kultivuar të mirën, konstruktiven dhe humanen në botë. Kur’ani përkujton Nuhin a.s. dhe shqetësimin e madh për moszhvillimin e misionit të tij ashtu siç e paramendonte ai në rezonimin e kufijve njerëzor të tij edhe pse e thërriste natë e ditë, ata shumë pak i afroreshin misionit të tij (LXXI:5-6) Lutin a.s. me luftën e tij kundër amoralitetit, Ibrahimin a.s. kundër politeizmit dhe padijes, Musaun a.s. dhe luftën e tij pakompromis kundër Faraonit të Egjiptit, përndryshe mbretit destruktiv të botës, Isaut a.s. kundër perandorisë famëkeqe romake, Muhamedit a.s. kundër të gjithë faktorëve destruktiv që pengonin revolucionin e tij hyjnor për t’i dhënë botës kahe të vërtetë në të gjitha sferat e zhvillimit njerëzor. Vërtetë, këto dhe si të këtillët mbajtën botën gjallë dhe drejtuan atë drejt zhvillimit të vërtetë dhe u bënë shembull se si duhet të jetuar, vepruar dhe më në fund si duhet vdekur.

E gjithë kjo luftë e njeriut konstruktiv, mëkëmbësit të Zotit, për ta ndryshuar botën drejt hyjnore dhe humanes, i përngjan anijes e cila noton në oqeanin e tërbuar dhe të egër, i cili ngrit dallgët e tij dhe që përplasen në të për ta shkatërruar atë dhe për ta paaftësuar drejt rrugës për në bregun e tij.

Njeriu shpesh herë harron pozicionin e tij duke qenë i shurdhër për të dëgjuar zërin e arsyes, logjikës, të kuptuarit, hyjnoren dhe bëhet fuqi e karakterit tjetër destruktiv – satanik. Ai në këtë harresë i jep hapësirë botës materiale, destruktives e cila robëron atë duke ia ngushtuar hapësirën e vetëdijes, shpirtërores, hyjnore. Kjo, prej subjektit dhe udhëheqësit, e shndërron atë në objekt dhe të udhëhequr, në

ndjekës të verbër të urdhrit të epshit dhe materiales, dhe pavetëdije bëhet udhëheqës i trasimit të rrugës satanike, destruktive, të errët, dhe luftëtarë i pakompromis i kultivimit të së keqes, negatives. shkatërrueses. Kjo luftë, në mungesë të forcave konstruktive, formon hapësirë të zhvillimit të veseve negative(XXV:43;XXVIII:50). Jo vetëm kaq, formohen edhe mekanizmat e trasimit të së keqes dhe shkatërrimit të asaj që quhet e mirë. M’u për këtë, njeriu i tipit të këtillë kultivon kushte për zhvillimin dhe rritjen e anomalive shoqërore si alkoolizmi, narkomania, homoseksualizmi, lezbeizmi, prostitucioni, pornografia, biseksualizmi, etj, saqë e gjithë kjo arsyetohet edhe nga faktorët udhëheqës të politikës dhe shtetit. Sot, p.sh. fatkeqësisht, arsyetohet homoseksualizmi, dhe është shumë aktual në rrjedhat botërore, saqë kanë arritur ta “legjitimojnë” të drejtën e tyre për të qenë të tillë, po bile kërkojnë të kyçen në sistemin e pluralizmit politik, dhe nuk do të habitemi kur ata nesër do të vijnë edhe në pushtet dhe do të organizojnë shtetin në bazat e filozofisë së tyre homoseksualiste. Dikush mund të thotë se kjo nuk është e mundur. Po. Ka qenë e pamundur martesat e dy burrave, por kjo tashmë po ndodhë me ligj në shumë vende të botës. Ndodhi edhe martesat e femrës perëndimore me kafshën – qenin. Ndodh edhe martesat femër me femër. Ndodh incesti – marrëdhënie në mes nënës e djalit, babait dhe vajzës, etj. Kjo është kahja më ekstreme e destruktives, që paraqet sinjalin shumë të qartë të rrezikut të njerëzores, humanes, konstruktives. Nuk është e tepruar alarmi i shumë kulturologëve europian për njeriun e sëmurë bashkëkohor, i cili tashmë nuk mund të jetojë pa drogë e alkool, pa prostitucion, etj. Ata alarmojnë faktin e lëvizjes së shoqërive në kahen e njëanshme të materiales, duke asgjësuar shpirtëroren, të vetëdijshëm se çdo prishje e ekuilibrit në mes shpirtërores dhe materiales është njëanshmëri që dërgon drejt shkatërrimit të njerëzimit. Kjo është ajo që përshkruhet në Kur’anin Famëlartë, mbi pejgamberët e Zotit dhe shoqëritë në të cilat kanë vepruar ata. Kur’ani përmend civilizimin e lartë material në kohën e Salihut a.s., por asgjësimi

total i moralit, pasojë dënimi i Zotit - shkatërrimi, populli i Nuhit a.s. u dënua me përmytje dhe tufan, populli i Lutit a.s. dhe paraqitja e homoseksualizmit nxiti dënimi me zjarr nga qielli, etj. që nxjerr në shesh ligjin sociologjik, se çdo shoqëri e cila zhvillohet tej mase në sferën tekniko materiale, ndërsa asgjëson atë spirituale, është e dënuar në zhdukje dhe shkatërrim.

### EDUKIMI NEVOJË PERMANENTE

Është një fenomen që shton frikën dhe rrezikun dhe që ndikon fuqishëm në zhvillimin e destruktives, e që sjellë pasojat trishtuese. Ky rrezik vjen nga indiferentizmi i faktorit njeri apo edhe nga përkrahja e fenomeneve amorale, nga të ashtuquajturat dijetarë e kulturolog, politikan e shtetar, të cilët jo vetëm kaq, po bile bëjnë luftë pakompromis për legjitimimin juridik të tyre duke mos menduar shëndoshë për pasojat që mund t’i sjellin njerëzimit. Politikan, artist, filozof, shekularist, letrar, shkencëtarë, etj. sot me të madhe mbrojnë të drejtat e amoralistëve, në veçanti të homoseksualistëve, nën parullën e të drejtave njerëzore. Harrojnë se historia vërtetoi se e keqja më e madhe i ndodhi njerëzimit, kur me vetëdije apo pa vetëdije kokat e ashtuquajtura të mëdha shkencore të kohës përkrahën ideologët e mëdhenj të ideologjive të ndryshme që i sollën njerëzimit katastrofën më të madhe. Filozofi Niçe inspiroi ideologjinë naziste të Hitlerit, ndërsa filozofi i madh Martin Hajdegeri, mbështeti fuqishëm Hitlerin dhe ideologjia naziste e Hitlerit solli gjenocidin e paparë kundër njerëzimit, duke zhdukur në mënyrën më mizore me dhjetëra milionë njerëz të pafajshëm. Zhan Pol Sartri një adhurues i madh i ateizmit dhe komunizmit, adhurroi Stalinin, me çka i dha përkrahje totalitarizmit komunisto - ateist, që gjithashtu zhduki miliona njerëz të pafajshëm. Ndërkaq, në Ballkan dhe në Europë, akademika serbe në krye me akademikun Dobrica Cosiq, përkrahu dhe inkurajoi politikën nacionaliste të Millosheviqit me çka u zhdukën me qindra mijë njerëz, fëmijë, e gra, e kështu me radhë.

Mu për këtë, në sferën edukimit të njeriut dhe shoqërisë është i patjetërsueshëm feja dhe besimi. Këtë si duket gjithë më

tepër po e kupton Perëndimi, duke e futur atë ngadalë në të gjitha sferat e jetës shoqërore, duke i edukuar fenomenet dhe duke ndikuar në humanizmin e jetës në përgjithësi. Tek ne ekzistojnë qarqe që edhe më tej nuk arrijnë ta kuptojnë fenë si një fenomen të çiltër hyjnor që është tek njeriu dhe për njeriun, që pastron ndjenjat dhe vë në kontroll fuqitë destruktive tek njeriut, që e bënë të matur atë duke ia ngulitur njeriut në mendjen e tij se Zoti është ai që e kontrollon njeriun dhe se ekziston bota tjetër ku do të përgjigjet për veprimet e tij. P.sh. disa, si Maks Velo dhe Fatos Lubonja, u pengojnë minaret vetëm pse njeriun e thërrasin tek Zoti për ta inspiruar dhe treguar se njeriu është i krijuar nga Zoti për të qenë në shërbim të kultivimit të së mirës dhe humanes. Pse ju pengon feja, minaret, xhamitë? Pse gjithë ky aversion ndaj Islamit? Pse gjithë ky sulm ndaj fesë e cila kërkon bindje të thellë në Zot, largim nga veprat e këqija, alkoolizmi, prostitucioni, narkomania, bixhozi, amoraliteti, formim të familjes së shëndoshë, marrëdhënie të mira me prind, me njerëz e shoqëri, etj. Me siguri, njerëzit që ndiejnë aversion dëshirojnë të jenë të lirë nga Zoti dhe besimi, për t’u shfrenuar, për t’u kënaq në kënaqësitë pakufi të botës, në liri absolute të një anarkie amorale, për t’u bërë rob i së keqes, për të vepruar keq, për të mbytur, shkatërruar, vjedhur e plaçkitur, masakruar, e kriminalizuar, për të qenë i lirë në robërinë ndaj shejtanit dhe epshit.

Por, ekziston një e vërtetë, përgjegjës për këtë janë ata që dinë, dijetarët, të cilët kanë obligim të kultivojnë të mirën duke iu kundërvënë të keqes asaj satanike. Ekziston legjenda e shpendit i cili, në momentin kur politeistët hodhën në zjarr Ibrahimin a.s. për ta djegur pse ai shkatërronte idhujt e tyre dhe i udhëzonte në rrugë të drejtë, ai me sqepin e vet mendohej të mbante ujë për të shuar zjarrin, dhe kur ju tha se çka mund të bëjëshë ti me këtë pikë uji? Ai ju përgjigjet se është e vërtetë se nuk mund të bëjë asgjë, por unë së paku jap mundin tim në shuarjen e zjarrit (shkatërrimin e të keqes) dhe largojë përgjegjësinë para Zotit për kontributin që duhet të jap kundër të keqes.

*Autori është Myfti i Myftinisë së BFI- Gostivarë*

RRETH CIVATEVE TË DOKTRINËS SË TRINITETIT

# Triniteti dhe vërtetësia e tij (3)

Senad Maku - Ulqin

## BIRI I VETËMLINDUR. (GJONI 1:14/ 3:16,18)

Bibla e quan Jezusin “Birin e vetëmlindur” të Perëndisë. (Gjoni 1:14/ 3:16,18) Trinitarët thonë se pasi Perëndia është i përjetshëm, po ashtu edhe i biri i Perëndisë është i përjetshëm. Mirëpo, si është e mundur që një person të jetë bir, e ndërkohë të ketë të njëjtën moshë me të Atin?

Trinitarët pohojnë se në rastin e Jezusit “i vetëmlindur” do të thotë që Jezusi vetë u lind, që vetë Zoti është i vetëmlindur! Përse atëherë Bibla e përdor të njëjtën fjalë greke, për fjalën “i vetëmlindur” për të përshkruar marrëdhënien e Isakut me Abrahamin? Sipas Biblës-shkrimeve të shenjta te libri i Hebrenjve 11:17 tregon për Isakun si bir “i vetëmlindur” i Abrahamit. A mund të themi edhe për Isakun se është Zot, pasi që e njëjta fjalë si te Jezusi, ashtu edhe tek Isaku është fjala greke, për fjalën “i vetëmlindur”. Fjala greke bazë e përkthyer “i vetëmlindur” e përdorur në rastin e Jezusit dhe të Isakut, është MO-NO-GE-NES. Kështu monogenes përcaktohet si: “I vetëmlindur” që d.m.th. “bir i vetëm”. (A Greek and English Lexicon of the New Testament, nga E. Robinson)

## JEZUSI NUK ËSHTË PREJ KËSAJ BOTE. (GJONI 8:23)

Në ungjillin e Gjonit 8:23 thuhet se Jezusi ka pohuar: Dhe ai u tha atyre:

*“Ju jeni nga këtu poshtë, kurse unë jam nga atje lart; ju jeni prej kësaj bote, unë nuk jam prej kësaj bote”.*

Kjo thënie është në kundërshtim me realitetin; sepse Isai a. s. (Jezusi) ishte nga

kjo botë, por ata e komentuan në atë mënyrë që ta argumentojnë hyjninë e tij, e ky komentim është i pavend në dy aspekte:

a) Sepse është në kundërshtim me argumentet logjike dhe me tekstet definitive.

b) Sepse Jezusi i tha këto fjalë edhe për nxënësit e tij, por askush nuk tha se ata ishin zota.

Shih te Gjoni 17:14-16, ku të njëjtat fjalë që i ceku në citatin e mësipërm, i cek edhe për nxënësit e tij:

*“Unë ua kam dhënë atyre fjalën tënde dhe bota i ka urryer, sepse nuk janë prej botës, ashtu si edhe unë nuk jam prej botës. Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota, por që ti t'i mbrosh nga i ligu. Ata nuk janë nga bota, sikurse unë nuk jam nga bota”.*

## EMANUEL – ZOTI ME NE. (ISAIA 7:14 / MATEU 1:23)

Po ashtu është edhe një citat tjetër biblik ku të krishterët mundohen që ta argumentojnë hyjninë e Jezusit, me fjalët e një profeti të quajtur Isaia, i cili në librin e tij në Dhiatën e Vjetër bëri një profeci, në të cilën, mes tjerash, tha: “Prandaj vetë Zoti do t'ju japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel.” (Isaia 7:14)

Lidhur me këtë citat shumë teologë të krishterë, pas analizimit, kanë dhënë mendimet e tyre për domethënien e këtij pasazhi biblik, duke e komentuar në bazë të origjinalitetit të këtij citati. Autorët e Dhiatës së Re kanë cituar shpesh pasazhe nga Dhiata e Vjetër, të cilat, sipas tyre, janë profeci të përmbushura në personin e Jezu Krishtit. Numri i këtyre pjesëve të cituara është vërtet i madh. Ndërmjet ungjillorëve, Mateu është ai që e ka bërë këtë dukuri karakteristike të ungjillit



*“Para se ky fëmijë ta arrinte pjekurinë, mbretërit që e terrorizonin popullin e Ahazit, do të shkatërronin rosheshin. Pra, mbretërit që frikësonin Ahazin u shkatërruan shumë shekuj para lindjes së Jezusit. Informacioni sipas të cilit ky fëmijë do të hajë ajkë dhe mjaltë derisa të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe ta zgjedhë të mirën, është një tjetër element, i cili e identifikon këtë fëmijë me situatën aktuale që po e kalonte Judah në atë kohë, ku ajka dhe qumështi për një popull agrar, formonte përbënin ushqimin bazë të tij.”*

të tij.

Kjo profeci e Isaia aludohet në ngjarjen që ka ndodhur me mbretin arameas Rezin nga Damasku (Siria) dhe mbretin Pekah të Izraelit (Efraim: mbretëria e veriut) që organizuan një revoltë ndaj superfuqisë së asaj kohe, Asirisë. Mbreti Ahaz refuzoi të bashkohej me ta dhe për këtë arsye ata u kthyen kundër tij, e rrethuan Jerusalemin dhe u përpoqën ta rrëzonin nga froni e ta vendosnin një vasal në fronin

e Judah. Mbreti Ahaz, për ta shpëtuar veten, mendoi t'i kërkonte ndihmë mbretit Tiglath-Pileser nga Asiria. Në këtë moment Isaia ia ndaloi mbretit ta bënte këtë gjë, sepse e dinte mirë se pasi që mbreti asirian t'i shkatërronte armiqët e ata gjithashtu do ta shndërronin Judenë në një shtet vasal. Mbreti veproi në këtë mënyrë, por rreziku i shkatërrimit nga armiqët e tij ishte ende shumë i madh. E gjithë kjo ndodhte rreth viteve 735-734 p.e.s., kurse mbreti Ahaz dhe populli i tij ishin shumë të frikësuar. Atëherë Zoti ia dërgoi Isaian për t'i siguruar për atë se ata “**dy mbretër**” nuk do të mund ta çonin deri në fund pushtimin e tyre. Pjesa më e rëndësishme e këtij rrëfimi, të paktën për ne, vjen kur Zoti dëshiron ta japë një “**shenjë**” për ta qetësuar mbretin Ahaz. Mirëpo, Ahazi nuk dëshiron ta tundonte Perëndinë dhe në këtë mënyrë ai refuzoi t'ia kërkonte Zotit një shenjë. Zoti vetë këmbënguli, duke e bërë Isaian që të thotë: “Prandaj vetë Zoti do t'ju japë një SHENJË: “Ja, një GRUA E RE do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë, të cilin do ta quajë Emanuel. Ai do të hajë ajkë dhe mjaltë derisa të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe të zgjedhë të mirën. Por para se fëmija të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe të zgjedhë të mirën, vendi që ti i druhash për shkak të dy mbretërve të tij, do të braktiset”. (Isaia 7:14-16)

Siç shihet, kjo profeci është plotësuar gjatë jetës së Ahazit dhe jo disa shekuj më vonë, siç dëshiron të na bëjë të besojmë Mateu, sepse shenja e dhënë kishte si qëllim të qetësonte mbretin Ahaz dhe popullin e tij nga frika prej armiqve. Pasi Perëndia i tha Ahazit që ta kërkonte një shenjë për t'i treguar se ai ishte me të dhe popullin e tij dhe pas refuzimit të këtij të fundit për ta tunduar Perëndinë, atëherë vetë Zoti e

mori iniciativën dhe i tregoi Ahazit për Emanuelin.

Para se ky fëmijë ta arrinte pjekurinë, mbretërit që e terrorizonin popullin e Ahazit, do të shkatërroheshin. Pra, mbretërit që frikësonin Ahazin u shkatërruan shumë shekuj para lindjes së Jezusit. Informacioni sipas të cilit ky fëmijë do të hajë ajkë dhe mjalte derisa të mësojë të hedhë poshtë të keqen dhe ta zgjedhë të mirën, është një tjetër element, i cili e identifikon këtë fëmijë me situatën aktuale që po e kalonte Judah në atë kohë, ku ajka dhe qumështi për një popull agrar, formonte përbënin ushqimin bazë të tij. Këto trajta njerëzore e vendosin fëmijën në kohën kur kjo profeci është kryer. “Zbatuar ndaj Mesisë, ajo duket e papërshtatshme dhe e tepërt”.

Kjo do të thotë që profecia u plotësua shumë kohë para lindjes së Jezusit (krahaso 2 Mbretërve 15: 27-29; 16: 1 e më poshtë; 2 Kronikave 28:1 e më poshtë). Pra, në këtë profeci nuk ka vend për Jezusin dhe nënën e tij të ndershme.

Nëse bëhet një krahasim tjetër ndërmjet teksteve biblike, lidhur me lindjen e Jezusit dhe emrin e tij, mund t'i referohemi po ashtu Mateut 1:20, ku tregon se si një engjëll iu shfaq në ëndërr Jozefit dhe urdhëronte Jozefin që ta merrte për grua Marinë dhe djali që do të lindte është një ngjizje prej frymës së shenjtë, ndërsa fëmija do të quhej Jezus: “Por, ndërsa bluante me vete këto çështje, ja që iu shfaq në ëndërr një engjëll i Zotit dhe i tha: “Jozef, bir i Davidit, mos ki frikë ta marrësh me vete Marinë si gruan tënde, sepse ç’është ngjizur në të është vepër e Frymës së Shenjtë”, dhe “por ai nuk e njohu, derisa ajo lindi djalin e saj të parëlindur, të cilit ia vuri emrin Jezus”. (Mateu 1:25) Ndërsa në citatat e ungjillit të Llukës, shohim se Engjëlli iu shfaq Marisë dhe e lajmëroi se do të mbetej shtatzënë dhe se do ta lindte një djalë që do t’ia vinte emrin Jezus: “Dhe engjëlli i tha: “Mos ki frikë, Mari, sepse ke gjetur hir para Perëndisë.

*Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t’ia vesh emrin Jezus”.* (Luka 1:30-31)

Nga citatat shihet qartazi se emri i tij ishte Jezus, e jo Emanuel siç tregohet te Mateu 1:23, ndërsa autori i këtij ungjilli e ka huazuar këtë citat nga Isaia 7:14. Gjithashtu, te citatat e ungjillit të Mateut dhe të Llukës vërejmë një kontradiktë ndërmjet dy emrave: Jezus apo Emanuel (Mateu 1:25; Luka 1:31 me Mateu 1:23). Mirëpo, s’duhet harruar një gjë, sepse Jezusi asnjëherë nuk tha dhe as që deklaroi para të tjerëve se emri i tij është Emanuel.

Si përfundim mund të themi se teksti i Isaia nuk bën fjalë për asnjë lloj profecie të ndonjë lindje virgjërore e cila do të ndodhte shekuj me vonë. Mateu duke e shkëputur në mënyre arbitrare dhe të sforcuar pasazhin e Isaia nga konteksti i tij fillestar, si edhe duke e përkthyer keq tekstin e pasazhit në fjalë, është përpjekur të përfitojë një profeci për lindjen virgjërore të Marisë dhe hyznizimin e Jezusit.

### ZOTI IM DHE PERËNDIA IM. (GJONI 20:27-28)

Në ungjillin e Gjonit thuhet se kur Thomai e pa Jezusin që ishte ringjallur filloi të mos besonte se ishte Jezusi ai që po e shihte përballë dhe kur vërtetoi se ishte ai, atëherë Thomai i tha: Zoti im dhe Perëndia im: “Pastaj i tha Thomait: “Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; shtrije edhe dorën dhe vëre në brinjën time; dhe mos ji mosbesues, por besues! Atëherë Thomai u përgjigj dhe i tha: “Zoti im dhe Perëndia im!” (Gjoni 20:27-28)


Sipas citatit të lartpërmendur të krishterët mundohen që me fjalët e Thomasit thënë Jezusit “Zoti im dhe Perëndia im”, të arsyetojnë se Jezusi është me të vërtetë Perëndia dhe Zoti i tyre. Nëse i krahasojmë dhe i analizojmë citatat e tjera të Biblës dhe thënien e Thomasit që i drejtohet Jezusit, kjo na tregon se Thomasi nuk ka

pasur për qëllim që ta ngrrejë në shkallën e hyznisë, apo nuk ka menduar në Zotin e Plotfuqishëm, ngase shprehja me të cilën është përgjigjur “Zoti im dhe Perëndia im” gjendet në shumë vende në Bibël, me ç’rast iu drejtohet edhe profetëve të tjerë, njerëzve të thjeshtë, engjëjve bile edhe djallit, por ne nuk mund të themi që edhe këta janë zota.

Në radhë të parë, sipas Biblës, Zotin nuk mund ta shohë askush dhe as që e ka parë ndonjëri. Kështu, Jezusi i drejtohet masës, duke i thënë: “Askush s’e pa Perëndinë kurrë” (Gjoni 1:18) “Askush s’e ka parë ndonjëherë Perëndinë”. (1 Gjoni 4:12) Përsëri te Gjoni 5: 37 Jezusi thoshte: “Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij”, etj.

Së dyti, në Bibël tregohet se Manoahu, duke vëzhguar engjëllin e Zotit në qiell, ai i tha bashkëshortes së vet: e pamë Perëndinë, ose siç tregohet: “Ashtu si flaka ngjitej nga altari në qiell, Engjëlli i Zotit u ngjit me flakën e altarit. Duke parë këtë, Manoahu bashkë me gruan e tij ranë përmbys për tokë. Engjëlli i Zotit nuk iu shfaq më as Manoahut, as bashkëshortes së tij. Atëherë Manoahu kuptoi se ai ishte Engjëlli i Zotit. Manoahu i tha pastaj bashkëshortes së tij: “Ne me siguri do të vdesim, sepse pamë Perëndinë”. (Gjyqtarët 13: 20-22) Gjithashtu, Bibla u referohet engjëjve si “ata që ngjajnë me Perëndinë” (Psalmi 8:5; Hebrejve 2:7)

Po ashtu në Bibël hebrejtë konsiderohen Perëndi: “Unë kam thënë: “Ju jeni perëndi, jeni të gjithë bijtë e Shumë të Lartit”. (Psalmet 82:6) Bibla, Perëndi i quan edhe ata, të cilëve u qe drejtuar fjala e Perëndisë (shih: Gjoni 10:34, 35; Psalmi 82:1-6). Madje, edhe satanai në 2 Korintasve 4:4, quhet “perëndia i kësaj bote”. Gjithashtu, me termin Zoti im, apo Zot, Perëndia im etj. janë quajtur edhe profetët e Zotit, si: Abrahami, Jozefi, Davidi, Esau, etj. (shih: Zanafilla 18:12; Zanafilla 44:20; 1 Samueli 25:24; Zanafilla 32:4)



Po fjalën Zot e përdor edhe Maria Magdalena kur shkon te varri i Jezusit dhe nuk e gjen brenda, e duke menduar se i afrohet kopshtari ajo e thërret ZOT: “Jezusi i tha: “O grua, pse po qan? Kë kërkon?”. Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha: “Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr”. (Gjoni 20:15) Gjithashtu priftërinjtë dhe farisenjtë e quajtën Pilatin ZOT, shiko: “Dhe të nesërmen, që ishte mbas ditës së Përgatitjes, krerët e priftërinjve dhe farisenjtë u mbloodhën te Pilati, duke thënë: “Zot, na ra në mend se ai mashtruesi...”. (Mateu 27:62-63)

Gjithë kjo çka u tha me termat Zot, Zoti im (Imzot), Perëndi, apo Perëndia im, mund të shtrohet pyetja nëse mund të themi edhe për këta se janë Perëndi? Nëse po, atëherë të gjithë njerëzit qenkan perëndi!!

## SHËMBËLLIMI I PERËNDISË. (2 KORINTASVE 4:4)

Te 2 Korintasve 4:4 thuhet: “... Lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë”. Nëse Jezusi është Zot, sepse është shëmbëlltira apo imazhi i Perëndisë, siç e cek ky citat, atëherë çka mund të themi për atë se njerëzit në përgjithësi janë shëmbëlltira e Perëndisë, siç tregon Bibla te Zanafilla 1:26,27, ku thuhet:

“Perëndia tha: Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne ...Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë: Ai krijoi mashkullin dhe femrën”. Sipas këtij citati, atëherë a mund të themi se të gjithë njerëzit janë zota, pasi që të gjithë ne jemi shëmbëlltira e Perëndisë?!

Habitemi kur në disa nga veprat e njohura teologjike i gjejmë këto fjalë: “Në Dhiatën e Re nuk ekziston një pohim eksplisit i doktrinës së trinitetit” “Teologët janë të pajtimt se në Dhiatën e Re nuk përmbahet ndonjë doktrinë e qartë mbi trinitetin”.

Duke pasur parasysh se citatat që përmendëm lidhur me trinitetin, ishin kryesisht nga Ungjilli i Gjonit, ku shkencëtari dhe profesori i Universitetit të Parisit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës, dr.

Maurice Bucaille, thotë se ky ungjill na dërgon në besimin se këtë ungjill e kanë shkruar disa nxënës mbas të cilit qëndron Pali.

Bart D. Ehrman thotë: “Ç’dobi ka të thuash se tekstet origjinale të Biblës janë të frymëzuara? Ne nuk i zotërojmë tekstet origjinale, por kemi vetëm një kopje të mbushura me gabime dhe shumica e këtyre dorëshkrimeve janë prodhuar shekuj më vonë se origjinalët”. “Ishte e qartë se kishte një problem në pohimin se Bibla ishte verbalisht e frymëzuar në çdo fjalë të saj. Siç mësuam në një nga kurset e para të ndjekura në institut, ne nuk i zotërojmë dorëshkrimet origjinale të Dhiatës së Re. Ajo që ne kemi përbëhet nga kopje të këtyre shkrimeve, të bëra vite më vonë. Mbi të gjitha, asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është krejtësisht e saktë, duke qenë se skribët që i kanë prodhuar ato, pa dashje ose qëllimisht, i kanë ndryshuar në vende të ndryshme. Të gjithë skribët e kanë bërë këtë. Kështu, në vend që të kemi fjalët e frymëzuara të autorëve (d.m.th. origjinalet) të Biblës, ajo çka kemi janë vetëm kopje të shkruara në gabime të shumëfishimeve”.

Këto ishin disa nga citatat me të cilat të krishterët argumentojnë në mbrojtje të tezës së tyre se Jezusi është Zot. Por deri tani vërejtëm se citatat kanë gabime, si në aspektin e përkthimit, ndryshimit, shtimit së disa citateve në Bibël, vetëm e vetëm për t’ia arritur qëllimit të tyre për ta argumentuar hyjninë e Jezusit.

Duke i parë këto gjëra, Shën Fausti, një peshkop i shekullit V, i shkruan Shën Augustinit me një zemërim, duke thënë: “Shumë gjëra u shtuan nga paraardhësit tanë në shkrimet e Zotërisë sonë, të cilat, edhe pse mbajnë emrin e tij, nuk pajtohen me mësimet e tij. Kjo nuk është befasuese, pasi që ne shpesh kemi vërtetuar se këto gjëra nuk janë shkruar nga Ai vetë e as nga apostujt e tij, por me të madhe janë të bazuara në përralla sipas raporteve të gjysmëhebrenjve, me mospajtime të shumta edhe ndërmjet tyre dhe duke i vënë emrat e apostujve në shkrimet e tyre ua atribuonin atyre gabimet dhe gënjeshttrat e veta”.

# Kurbani-Sakrifica

Rexhep ZIBERI

## HISTORIKU I KURBANIT

Sakrifica si institucion pothuajse është e njohur te të gjithë popujt e lashtë. Ajo ishte dukuri e cila e ndoqi njeriun që nga ditët e para të paraqitjes së tij në rruzullin tokësor. Nese i kthehemi historisë së lashtë do të shohim se sakrificën do ta hasim te shumë popuj të vjetër siç ishin Asirasit, Fenikasit, Grekët, Egjiptasit, Persianët dhe Kinezët etj. Pasi që të gjithë këta popuj ishin ateistë edhe sakrificat e tyre ua kushtonin perëndive të tyre. Në globalitet të gjithë këta popuj afronin sakrifica në prag të pranverës me qëllim që prodhimet bujqësore t’i kenë më të begatshme, sakrificat para luftrave që duhej zhvilluar, sakrifica e vajzës te Persianët etj.

Ky llojë sakrifikimi ishte i njohur edhe në kohën e injorancës, kur arabët para Kur’anor sakrificat e tyre ua kushtonin idhujve të tyre. është i njohur rasti me arabin i cili pasi i dërgoi qumështin idhullit të vet në shkretëtirë u strehua dhe tha në vete: “Jam kureshtar ta shoh se si e pinë qumështin Zoti im”, pas disa çastesh erdhi dhelpira e shkretëtirës e cila ia piju qumështin dhe urinoi mbi idhullin e tij! Kur e pa arabi se ç’ndodhi me idhullin e tij tha: “Pas sodit ky arabi (flet për vetëveten) kurrë më nuk do ti afron ushqim një zoti që urinojnë dhelpirat e shkretëtirës mbi të dhe që nuk është në gjendje ta ruaj ushqimin e tij! Jehudët sakrificat e tyre i

bëjnë me djegjen e mishit të kafshëve për vet sakrifikesin, ndërsa të krishterët këtë e bëjnë me ndezjen e qirinjëve.

Në Islamit kurbani është i njohur që prej bijëve të Ademit a.s. Habilit dhe Kabilit i cili dëshironte të martohej me Vedijen, vajzën me të cilën ishin të një barku, ndërsa sipas Kabilit një vendim i këtillë ishte gabim dhe duhej të martohej me Damijen, vajzën që nuk ishin të të njejtit barkë. Këtë rastë ata ia prezentuan babait i cili i urdhëroi që të dy të flijojnë nga një kurban dhe kurbanin e atij që do t’ia pranonte Allahu i lartësuar ai do të ishte në të drejtë. Habili kishte flijuar një dele kurse kabili një enë me grurë. Papritmas ishte ndezur një zjarrë dhe kurbanin e Habilit e kishte gëlltitur, ndërsa grurin e Kabilit as që e kishte prekur. Kabili pas kësaj që ndodhi u hidhërua aq shumë sa që vendosi ta mbyste të vëllanë. Më në fund edhe kështu veproi. Këtë ngjarje e potencoi Kur’ani famëlartë në suren El-Maide duke filluar prej ajetit 27 deri në ajetin 32.

## SAKRIFICA E ABDULMUTALIBIT

Abdulmutalibi është gjyshi i Pejgamberit a.s, në faqet e historisë Islame njihet për nga zemërgjërësia mëshira ndihma dhe drejtësia të cilën e posedonte. Ai në jetën e tij kishte një brengë të madhe edhe atë se si të arrinte të gjente vendin në të cilin dikur kishte qenë burimi i zemzemit të cilit më parë gjatë luftrave të ndryshme armiqët ia kishin humbur shenjat e burimit duke e mbuluar me armë dhe me gurë dhe kishte kaluar aq kohë e gjatë sa që të gjithë



*“Para se gjithash duhet ta kemi të qartë se kurban është adhurim i cili në mënyrë direkte e lidhë besimtarin me Allahun e lartësuar. Me therjen e Kurbanit besimtari i shpreh falënderim Allahut të lartësuar për pasurinë që Ai nga mëshira e tij e paku-fishme ia fali atij, me të cilën pasuri ky arriti që të therë Kurban. Kurban në vete bartë edhe kuptimin humanitar sepse vjenë në shprehje ndihma reciproke e besimtarëve në ditët e gëzimit të përbashkë”.*

kurejshitet ia kishin harruar vendin e saktë të burimit.

Një ditë duke pushuar nën hijen e Qabes e kaploi një kotje dhe papritmas i erdhi një zë duke i thënë : “Çohu dhe gropoe zemzemin sepse gropimi nuk do të jetë i kotë...” Abdulmutalibi u ngrit në këmbë shikoi rreth e rrotull por nuk pa njeri! Në vete mendoi,

a thua vall ky ke zëri djallit të mallkuar ose mos vall ishte zëri i melekut të mëshirëplotit! Ditën e nesërme porderisa pushonte në të njejtin vend i erdhi në gjum i njejtë zë me të njejtat fjalë. Ky ishte zëri i cili do ta shpiente deri në vendin e burimit të zemzemit. Edhe ditën e tretë dëgjoi në gjum po të njejtat fjalë duke i thënë: “Do ta gjeshë Zemzemin në vendin ku do të lëshohet një korb i zi, me këmbë të kuqe, sqep të kuq dhe me pend të bardhë në krah.” Ai u gëzua pa masë sepse ky zë i dha shenjë të drejtëpërdrejtë për vendin e burimit të zemzemit dhe lindi shpresa për realizimin e qëllimit që e kishte marrë mbi supet e veta se do të gjentë ujë për vetë vendasit, kalimtarët e

rastit dhe haxhilerët.

Dhe me të vërtetë ndodhi ashtu siç iu paralajmërua në ëndërr. Ai në këtë kohë kishte vetëm një djalë edhe atë Harithin, të cilin e obligoi që të sjell mjetet e gropimit dhe në të njejtin vend ku kishte zbritur korbi filluan gropimin. Me të parë këtë kurejshitet shkuan që ta pyesin për shkakun e gropimit, ai ua tregoi qëllimin e gropimit, mirëpo ata i thane: Ne nuk do të lejojmë që vetë ta groposh burimin e zemzemit, që me të të krenohesh vetëm ti, kur dihet se pasuria yte është shumë më e vogël se e jona dhe ti ke vetëm një djalë kurse në mesin tonë ka nga ata që kanë mbi dhjetë fëmijë, dhe ia ndaluan gropimin. Abdulmutalibi në këtë rast i tha të birit: “O Harith! këta fuqia e fëmijëve i bënë më të fuqishëm se ne, e unë betohem në Allahun se nëse më falë disa djemë unë njërin prej tyre do ta therr kurban për Allahun!” Kurejshitet dëgjuan për këtë betim të madh të Abdulmutalibit dhe panë se gabuan ndaj tij andaj edhe kërkuan nga ai që ta vazhdonte gropimin e tij.

Ai vazhdoi të groponte dhe pas një pune të gjatë shpërtheu uji duke e rikthyer përsëri zemzemin në jetën tonë.

Kaluan shumë vjetë dhe Allahu f.p Abdulmutalibit i fali gjashtëmbëdhjetë fëmijë, dhjetë djem dhe gjashtë vajza. Djalin më të dashur dhe më të ri e emërtoi me emrin Abdullah. Pasiqë Abdullahu mbushi tetëmbëdhjetë vjetë Abdul mutalibi vendosi që ta realizonte premtimin e therjes së njërit prej djemve. Në atë kohë ishte zakon që të nxirret shortë dhe djallit që do t'i binte shorti ai duhej të therrej. Ai i tuboi kurejshitet në Qabe, me vete mori djemt dhe një sopatë të mprehtë, dhe me hedhjen e shortit herën e parë shorti i ra Abdullahut. Nga dashuria që kishte ai dhe kurejshitet ndaj Abdullahut shortin e përsëriti tre here, mirëpo në të tre rastet ai i ra Abdullahut, dhe më në fund vendosi që të realizonte premtimin e dhënë. Kurejshitet nga dashuria që kishin ndaj Abdullahut kërkuan nga Abdulmutalibi që një herë të konsullohej me një fallxhore nga Hajberi dhe të vepronte sipas propozimeve të saja. Të gjithë së bashku shkuan dhe e pyetën për rastin

ndërsa ajo u tha: Nëse njëri prej jush mbytet një njeri, familjes së të mbyturit duhet t'ia paguaj gjakun në vlerë prej dhjetë devesh (pagesa e gjakut në kohën parakuranore). Edhe ju llogaritni dhjetë deve dhe në mes tyre dhe Abdullahut hudhni short, nëse shorti u bie deveve therni ato e nëse i bie Abdullahut dyfishonie numrin deri sa shorti nuk bie mbi devet. Mandej me mishin e tyre ushqeni të varfërit e qytetit tuaj. Në hudhjen e parë shorti i ra Abdullahut, Abdulmutalibi e rriti numrin e deveve në njëzetë, por ai përsëri i ra Abdullahut, shorti nuk u ndal gjersa numri i deveve nuk arriti deri në njëqindë dhe shorti ra mbi devet, për tu siguruar Abdulmutalibi këtë e përsëriti tre here, por shorti sërish ra mbi devet, atëherë Abdulmutalibi tha tash me siguri shpëtoi Abdullahu. Therni devet ushqeni të varfërit e qytetit si dhe bishat e egra nëpër kodra. E mori Abdullahun për dore dhe bëri tavaf rreth Qabes, falënderoi Allahun f.p i cili ia shpëtoi birin më të dashur ashtu siç ia shpëtoi stërgjyshin e tij Ismailin a.s duke e zëvendësuar atë me një dash të cilin ia solli xhibrili a.s.

## SAKRIFICA E IBRAHIMIT A.S

Kur'ani fisnik gjithashtu e potencon edhe rastin e Ibrahimit a.s i cili ishte urdhëruar në ëndërr për ta flijuar të birin trembëdhjetë vjeçarë Ismailin a.s.

Sipas disa transmetimeve Ibrahimit a.s pasi që i ishte përsëritur disa herë ëndërra, ai kërkoi prej Haxheres që t'ia pastronte dhe t'ia vishte djalin me rrobat më të bukura që ai kishte, sepse do të shkonin për të vizituar një mik të vetin. Kështu që ata u nisën në drejtim të Mines së sodit për të arritur në fushën e arafatit ku edhe do të ekzekutonte vendimin. Pas pak kohe shkoi djalli te Haxherja dhe i tha asaj: “Ibrahimi e mori djalin për ta therur” ajo nuk i besoi dhe i tha djallit: “Kjo nuk është e mundur sepse Ibrahimi e donë të birin e tij Ismailin” djalli tha: “është e vërtetë se e donë, mirëpo kështu është urdhëruar nga Zoti”

atëherë Haxherja ia ktheu: “Po që se është i urdhëruar nga Zoti atëherë gjithcka është në rregull sepse ne i dorëzohemi Atij. Djalli kur pa se nuk arriti gjë me Haxheren shkoi te Isamili i vogël të cilit i tha: “Babai ytë nuk të mori për në vizitë por të mori për të të therur, sepse ai mendon se kështu është i obliguar nga Zoti” Ismaili në atë rast i tha: “Po që se e ka urdhëruar Zoti unë me gjithë dëshirë do ta zbatoj urdhërin e tij”. Djalli kur pa se në asnjë mënyrë nuk mundi që ta hamendë djalin, më në fund shkoi te Ibrahim a.s duke i thënë: “Ku e çon djalin? Mos i zbato ato ëndërra sepse janë ëndërra djallëzore” Ibrahim a.s iu kërcnua duke i thënë: “Largohu menjëherë prej këtu se ti je djall” dhe mori në të dy duart nga shtatë gurë dhe e goditi djallin në tri vende. Kështu që goditja e djallit do të vazhdoj si një nga pjesët përbërese te Haxhit deri në ditën e kijametit.

Më në fund Ibrahim a.s i tregoi Ismailit për ëndërrën dhe vendimin që kishte marrë, këtë bisedë na e vërteton edhe Kur'ani fisnik: **“Kur djali u rritë që të dilte dhe të punonte së bashku me babanë Ibrahim i tha atij : “Unë kam parë në ëndërr sikur po të bëj ty kurban ç’thua për këtë?” përgjigja e Ismailit a.s ishte : “ O babai im vepra ashtu siç je i urdhëruar e nëse don Allahu do të më gjeshë prej durimtarëve” Saffat 103.**

Para se Ibrahim a.s të realizonte vendimin e marë Ismaili a.s ia bëri disa kërkesa Ibrahimit a.s, kërkesa që bëjnë të qajë guri dhe druri, ai tha o babai im:

1. Mi lidhë duartë dhe këmbët që të mos fërfëllitem;
2. Ke kujdes që të mos i zhyejsh rrobat me gjakun tim;
3. Shiko te jetë thika e mprehtë që sa më shpejtë të më delë shpirti;
4. Gjatë therjes mos më shiqo në sy sepse kam frikë se ndjenë dhimbje për mua dhe nuk e zbaton urdhërin e zotit;
5. Pasi ta kryejsh punën me mua këmishën time të përgjakur dërgoja nënës në mënyrë që ajo të ngushëllohet me te.

Pas gjithë kësaj Ibrahim a.s tha :”O Zoti im më jep durim dhe më mëshiro mua dhe posa e mori thikën në dorë

për ta realizuar besën që ia kishte dhënë Allahut të lartësuar, mu në atë moment Allahu i lartësuar dërgoi Xhibrilin me një dash në dorë e duke thënë : “**Allahu Ekber Allahu Ekber**” (Allahu është më i madhi), Ibrahim i a.s nga gëzimi i madhë e vazhdoi tekbinin duke thënë : “**La Ilaha Ilallahu Vallahu Ekber**” (Ska Zot tjetër pos Allahut, Allahu është më i madhi), ndërsa Ismaili a.s e përfundoi tekbinin duke thënë : “**Allahu Ekber Ve Lilahil Hamd**” (Allahu është më i madhi, Atij i takon falënderimi). Ky tekbin vazhdon te praktikohet edhe sot e kësaj dite prej sabahut të ditës së parë të Arifes dhe vazhdon deri ne namazin e iqindisë të ditës së katërt të Bajramit.

## URTËSITË E THERJES SË KURBANIT:

Para se gjithash duhet ta kemi të qartë se kurbanit është adhurim i cili në mënyrë direkte e lidhë besimtarin me Allahun e lartësuar. Me therjen e Kurbanit besimtari i shpreh falënderim Allahut të lartësuar për pasurinë që Ai nga mëshira e tij e pakufishme ia fali atij, me të cilën pasuri ky arriti që të therë Kurban. Kurbanit në vete bartë edhe kuptimin humanitar sepse vjenë në shprehje ndihma reciproke e besimtarëve në ditët e gëzimit të përbashkët. Besimtari dashurinë dhe kujdesin që ka ndaj vëllezërve të vetë në ditët e bajramit e dëshmon me vepër, ai në asnjë mënyrë nuk lejon që sofrat e tij në ditën e bajramit të jetë e mbushur përplotë, ndërsa sofrat e vëllaut të jetë e shprazur. Këto janë meritat e islamit i cili i mësoi muslimanët se “ushqimi i njërit në islam është i mjetueshëm për dy”, Islami këtë e dëshmoi edhe me therjen e kurbanit dhe me ndarjen e mishit të tij në mënyrë të barabartë. Duke u nisur nga ajo se një pjesë e mishit të kurbanit mund që ti ndahet edhe fqiu jo musliman, këtu zbulojmë edhe një urtësi të Kurbanit që ndërlihet me mardhëniet ndërnjerzore don të thotë se kurbanit është ai i cili bënë afrimin e njerëzve të konfesioneve të ndryshme. Kurbanit është ai i cili e bënë njeriun që të jetë punëtor sepse e shtyn që edhe ai të përfiton si të tjerët e ta kryej këtë ibadet të madhë.

## DOMETHËNIA E FJALËS KURBAN DHE OBLIGUESHMËRIA E TIJ

Fjala kurban buron nga folja e gjuhës arabe Karebe që në etimologjinë e gjuhës shqipe donë të thotë Afrim, sepse me kryerjen e këtij ibadeti të madh besimtarët i afrohen Allahut të lartësuar.

Në gjuhën arabe kurbanit i thonë **Udhijeh** që është e marur nga fjala **duha** që nenkupton kohën pas namazit të sabahut deri para faljes së namazit të drakes, don të thotë se Ud-hijeh është kafsha e cila theret brenda kësaj kohe.

Definicioni kurbanit në

Jurisprudencen islame është ky: “**Therja e kafshëve të caktuara, në ditë të caktuara me qëllim afrimi tek Allahu i lartësuar**”.

Therja e kurbanit sipas drejtimit tonë juridik Hanefi është Vaxhib, don të thotë obligim i domosdoshëm për atë i cili i plotëson kushtet vijuese:

1. Të jetë i lirë d.m.th të mos jetë rob ose i burgosur.

2. Të jetë i pasur d.m.th gjatë ditëve të kurban bajramit të posedon sasinë e caktuar të pasurisë të cilës duhet dhënë Zeqat. Nga kjo nënkuptojmë se të varfërit nuk janë të obliguar me therjen e kurbanit dhe janë të lirë që të mos vuajnë nga komplekset se pse të tjerët therrin ndërsa ata nuk mundë që ta bëjnë këtë.

3. Të jetë në shtëpi. Kjo nënkuptonë se ai i cili gjatë ditëve të kurban bajramit nuk gjendet në shtëpi nuk është i obliguar me therjen e tij edhe nese ai është i pasur.

4. Nikoqiri i shtëpis është i obliguar që të therë kurban për vetveten si dhe për fëmijët e tij qofshin ata të vegjël ose të mëdhenjë, për secilin prej tyre nga një dele.

Sipas dijetarëve të medh-hebit tonë Hanefij kushti fundit vlenë për njerëzit të cilët perfitimet vjetore i kanë të mëdha.

## GRUPI I KAFSHËVE QË LEJOHEN DHE QË NUK LEJOHEN PËR KURBAN:

Sipas Sheriatit Islam grupet e kafshëve absolute që lejohen të therrin për kurban janë:

1. Devja, që është e vetmja e kësaj familje . Kushtëzohet që ti ketë mbushur pesë vjet.

2. Lopa dhe kafshët tjera që bëjnë pjesë në këtë familje siç janë: Kau, mëzati, bulli dhe bullica. Ky grup kafshëve kushtëzohet që ti kenë mbushur dy vjetë dhe lejohet që në njërin prej këtyre kafshëve të jenë pjesëmarës shtatë persona edhe atë duke u bazuar në transmetimin e Xhabir ibni Abdullahut i cili thotë: “Atë vitë kur ndodhi lufta e Hudejbisë therëm kurban së bashku me Muhamedin a.s edhe atë deve dhe lopë për shtatë persona”

3. Delja dhe kafshët tjera që bëjnë pjesë në këtë familje siç janë: dashi, dhia dhe cjapi, me kushtë që ti kenë mbushur një vjetë. Këtu përjashtohet kafsha e vogël e cila ka mbushur gjashtë muaj e cila nëse përzihet me kopenë e kafshëve tjera të vogla, për nga madhësia nuk do të dallohet prej tyre.

Sipas Fukahave të Medhhebit Hanefi nga tre grupet kafshëve që lejohen të therrin për kurban ekzistojnë disa kafshë të cilat nuk i plotësojnë kushtet e kurbanit dhe që s’lejohet të therrin për kurban. Bëhet fjalë për ata kafshë të cilat janë me të meta të pjesërishtme fizike, në mesin e tyre dallohen këto kafshë:

1. Kafsha e cila është e verbër qoftë në njërin sy ose në të dytë;

2. Kafsha e cila është e gjymtë, në

përjashtim të asaj e cila me këmbët e veta shkon deri te vendi i therjes;

3. Kafsha e cila është aq e dobët fizikisht sa që nuk mundë të shkon deri te vendi therjes;

4. Kafsha e cila e ka të prerë veshin ose bishtin e sajë mbi gjysmë;

5. Kafshës të cilës i mungojnë gjysma e dhëmbëve ose më shumë.

## MISHI LËKURA DHE KOHA E THERJES SË KURBANIT

Për dallim nga sadakat fakultative që u ndahen vetëm të varfërve mishi i kurbanit në mënyrë të barabartë aq sa u ndahet të varfërve u ndahet edhe të pasurve. Ky është i vetmi llojë i adhurimeve në islam që nuk bënë dallim në mes të varfërve dhe të pasurve.


Sipas jurisprudencës islame lejohet ngrënia e mishit të kurbanit, madje ai i cili therë kurban ka të drejtë që 1/3 e tij ta ndaj për veten e tij, mirëpo faktikisht kurbanit theret për tu shpërndarë, sepse në një rast kur pejgamberi a.s. ishte kthyer në shtëpi e kishte pyetur Aishen r.a: “Ç’u bë me delen e therur?” Ajo ishte pergjigjur: “E kemi shpërndarë krejt pos shpatullës”, Pejgamberi a.s.ia ktheu: “Jo, po na paska mbetur krejt pos shpatullës”.

Kur jemi duke biseduar për mishin e kurbanit patjetër duhet potencuar edhe atë se ai i cili therë kurban nëse nuk është në gjendje ta therë vet ai personalisht, së paku është mirë që të prezenton në therjen e kurbanit të vetë sepse Aishes r.a. i tha pejgamberi a.s.: “Dil te kurbanit ytë se me rënien e pikës së parë të gjakut në tokë të fshihen gjunahet”

Lëkura e kurbanit është pjesë e vetë kurbanit dhe prej saj njerëzit kanë dy dobi të cilat dobi janë veshja dhe mbathja. Lëkura e kurbanit jepet sadakë, nuk guxojmë që ate ta ndalim për vetveten tonë. Nëse duam ti shohim dobit e lëkurës së kurbanit në shtëpinë tonë atëherë jemi të obliguar që të japim sadakë vlerën e saj.

Në ato vende ku falet namazi i bajramit koha e therjes së kurbanit fillon menjëherë pas faljes së namazit të bajramit dhe zgjatë deri në namazin e iqindisë të ditës së tretë të bajramit. Në ato vende ku nuk falet namazi bajramit siç janë fshatrat në thellësi të larta malore, kurbanit theret menjëherë pas namazit të sabahut. Kurbanit i cili theret para faljes së namazit të bajramit ai nuk është kurban. Vlera e therjes së kurbanit në ditën e parë është më e madhe se sa vlera e therjes në ditën e dytë dhe të tretë të bajramit.

Në fund duhet të kemi kujdes me sjelljet dhe konsideratat tona ndaj kurbanit tonë. kurbanit duhet të jetë i dalluar, atij duhet kushtuar rrespekt të veçantë, dashuria e familjes në ato ditë duhet të jetë e kthyer kah kurbanit, sepse kurbanit është ai i cili në mënyrë të drjetë për së drejtë e lidhë besimtarin me Allahun e lartësuar.



*Nxënësit e Medresës Isa Beu felenderojnë dhe lusin Allahun Fuqipotë t'i shpërblen të gjithë ata që përmes Sadekatul-fitrit, Zeqatit, kurbanëve, lëkurave të kurbanëve dhe ndihmave të tjera vullnetare, ndihmuan dhe inshallah do të ndihmojnë në kultivimin dhe zhvillimin e jetës fetare islame, respektivisht; mirëmbajtjen e institucioneve arsimore-islame në vendin tonë, pra SHMI 'Medreseja Isa Beu' dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup.*

*Allahu xh.sh,  
ua pranofte  
ibadetet*



*Me fat Kurban  
Bajrami*

